



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E
BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027**

Shtator, 2022

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Lista e figurave.....	3
Hyrje	4
1. Qasja strategjike për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative	5
1.1. Qëllimet.....	6
1.2. Parimet.....	7
1.3. Prioritetet.....	8
1.4. Elementet	8
1.5. Metodologjia e përgjithshme për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative.....	10
2. <i>EX ANTE & EX POST</i> : parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative	12
2.1. Proceset	12
2.2. Mjetet	13
2.2.1. Modeli i kostimit standard	13
2.2.2. Vlerësimi i ndikimit rregullator.....	13
2.2.3. Vlerësimi <i>ex post</i> i legjislacionit	14
2.2.4. Memorandumi shpjegues	14
3. Digjitalizimi dhe zvogëlimi i barrës administrative	16
4. Ngritja e kapaciteteve	17
5. Konsultimi dhe komunikimi	19
5.1. Konsultimi i fokusuar	19
5.2. Komunikimi.....	20
6. Koordinimi i Qeverisë me Kuvendin dhe Komunitat	22
7. Zbatimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi	23
7.1. Koordinimi politik	23
7.2. Koordinimi profesional.....	23
7.3. Koordinimi me partnerët zhvillimorë.....	26
7.4. Ndikimi buxhetor i zbatimit të Programit.....	26
7.5. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi	28
PLANI I VEPRIMIT 2022-2024.....	30
Shtojca 1: Analiza Juridike për Thjeshtimin, Bashkimin ose Eliminimin e Lejeve dhe Licencave të lëshuara në kuadër të MBPZHR dhe MMPHI (pjesa e mjedisit)	44

Shtojca 2: Analiza Juridike për Thjeshtimin, Bashkimin ose Eliminimin e Lejeve dhe Licencave të lëshuara në kuadër të MSH, MPB dhe MMPHI (pjesa e infrastrukturës)	44
Shtojca 3: Analiza për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative të përzgjedhura duke u bazuar në ngjarje reale.....	44
Shtojca 4: Pyetjet orientuese për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative.....	44
Shtojca 5 - Pasaporta e Treguesve.....	44
Shtojca 6 - Vlerësimi i rrezikut të zbatimit të PPZBA 2022-2027	44

Lista e shkurtesave

ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
DIEKP	Departamenti për integritet evropian dhe koordinim të politikave
KE	Komisioni Evropian
KKEI	Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime
KMPS	Korniza për Menaxhim dhe Planifikim Strategjik
KPS	Komisioni për Planifikim Strategjik
LPPA	Ligji për procedurën e përgjithme administrative
MKS	Modeli i kostimit standard
MSh	Memorandum shpjegues
RrPQ	Rregullorja e punës së Qeverisë
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SRAP	Strategjia për Reformën e Administratës Publike
SQE	Strategjia për Qeverisje Elektronike
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZL	Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

Lista e figurave

Figura 1: Harta e qëllimeve e ndërlidhur me kornizën strategjike dhe tipet e treguesve.....	6
Figura 2: Qarkorja rregullatore e politikëbërjes në Kosovë.....	12
Figura 3: Komponentat e trajnimit dhe ndërlidhja me njëra tjetrën.....	18

Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit efektiv të politikave publike. Një nga temat kryesore që ndërlidhet me kontaktin ndërmjet administratës, qytetarëve dhe bizneseve, është barra administrative e panevojshme, e cila shkakton shpenzime të panevojshme, merr kohë, shkakton irritim dhe motivon korrupsionin. Disa prej efekteve që shkakton barra administrative janë mjedisi jo i mirë i të bërit biznes, shkalla më e ulët e regjistrimit dhe formalizimit të biznesit, niveli i ulët i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga administrata publike, shpenzimet më të mëdha nga ndryshimet e shpeshta të legjislacionit, etj. Këto efekte krijohen nga procedurat e panevojshme, legjislacioni kontradiktor, zbatimi jo i duhur i legjislacionit, dyfishimi i obligimeve ligjore, informacionet e paqarta, kapacitetet e mangëta për ofrim cilësor të shërbimeve, digjitalizimi i pamjaftueshëm, përkthimi i dobët i legjislacionit, mungesa e zbatimit të parimeve të përgjithshme administrative, etj.¹

Duke u bazuar në shkaqet dhe efektet që shkakton barra administrative, synimi i Programit për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, është largimi i barrës administrative të panevojshme nga legjislacioni, pa ia rrezikuar qëllimin thelbësor. Duke e arritur këtë qëllim, do të rriten kursimet e qytetarëve dhe bizneseve, të cilat mund të orientohen në veprimtari të tjera përkatëse, do të përmirësohen kushtet për të bërë biznes, do të zvogëlohet ekonomia joformale, do të rritet efektiviteti i administratës publike dhe Qeverisë në tërësi, e kjo do të rezultojë me rritjen e kënaqshmërisë dhe besimit të qytetarëve dhe bizneseve në administratë dhe Qeveri.

Përgatitja dhe hartimi i Programit është bërë nga grupi punues i krijuar për këtë qëllim, i shoqëruar me analizat dhe raportet e hartuara nga Zyra për Planifikim Strategjik, konsultimet me ministritë e linjës, shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, komunitetin e biznesit, partnerët zhvillimorë dhe organizatat ndërkombëtare kredibile për administratën publike, sikurse SIGMA.² Përveç aspekteve të karakterit strategjik, Programi përmban udhëzime, në disa raste edhe të hollësishme, për lehtësimin e punës së zyrtarëve publikë për zbatimin e reformës. Prandaj, përveç një dokument strategjik, Programi shërben si udhëzues për administratën se si të parandalohet dhe të zvogëlohet barra administrative, deri në zhvillimin e moduleve dhe udhëzuesve përkatës.

Programi është dokument fleksibil, që i integron dhe u përshtatet rrethanave dhe proceseve aktuale për reformimin e administratës publike, që kombinohet me dokumentet tjera strategjike, me synime e rezultate të qarta dhe veprime konkrete, që prodhojnë efekte sinergjike.

¹ Për më tepër përmbledhje, analiza, studime dhe krahasime për procesin e barrës administrative shih *Koncept dokumentin për zvogëlimin e barrës administrative*, të miratuar me Vendimin nr. 03/05 të datës 06.03.2020.

² Me qëllim të përgatitjes së këtij Programi, me mbështetjen e GIZ dhe Zyrës së BE-së në Kosovë, Zyra për Planifikim Strategjik ka zhvilluar analiza dhe raporte të veçanta të bazuara në evidencë për koncept dokumente, memorandume shpjeguese, modelin e kostimit standard, ofrimin e shërbimeve në Kosovë, trajnimet që ndërlidhen me barrën administrative, si dhe ka konsultuar SIGMA gjatë përgatitjes së këtij Programi, si dhe ka konsultuar në mënyrë të hollësishme raportet ndërkombëtare si *Raporti i Monitorimit 2021*, i SIGMAs.

1. Qasja strategjike për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative

Qasja strategjike për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative është pjesë e **hartës strategjike për zhvillimin e vendit**. Në këtë drejtim, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 (tash e tutje SKZH) është dokumenti kryesor strategjik, që përcakton orientimet për zhvillimin e vendit, bazën për vendosjen e hierarkisë së objektivave dhe treguesve, si dhe definimin e kufijve të sektorëve, duke e mundësuar kështu një lidhje më të qëndrueshme me planifikimin buxhetor, monitorimin dhe raportimin e saj. Për këtë qëllim, është instaluar metoda e zberthimit, me anë të së cilës, qëllimet dhe objektivat e nivelit të lartë, të vendosura në SKZH, do të detajohen më tej në dokumentet strategjike të nivelit më të ulët: **strategjitë sektoriale dhe programet**.³

Strategjitë sektoriale përcaktojnë objektivat dhe caqet afatmesme për një sektor përkatës. Në këtë kontekst, Strategjia për Reformën e Administratës Publike (tash e tutje SRAP) përcakton objektivat dhe caqet afatmesme për fuqizimin dhe modernizimin e administratës publike, arritja e të cilave rezulton në rritjen e efikasitetit, efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies. SRAP përmban objektivat dhe veprimet për rritjen e cilësisë së ofrimit dhe shërbimeve, të cilat ndikojnë shumë fusha ekonomike dhe sociale, si dhe rrisin besimin dhe komunikimin qytetar me Qeverinë dhe administratën publike.⁴ Po ashtu, Strategjia për Qeverisje Elektronike (tash e tutje SQE) përcakton objektivat dhe caqet për digjitalizimin në administratën publike, ku përfshihet ndërveprueshmëria e lartë dhe e sigurtë ndërmjet sistemeve dhe zgjerimi i platformës E-Kosova në funksion të digjitalizimit të shërbimeve administrative. Ndër të tjera, dokumentet strategjike për vetëqeverisje lokale do të përmbajnë synimet mbi thjeshtimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të ofruara në nivelin lokal.

Zvogëlimi i barrës administrative për qytetarë, biznese dhe administratë përbën temë të gjerë, që ndërlidhet me shumë elemente dhe procese të administratës publike, si dhe me **funksionimin organik** të saj si tërësi. Në këtë kontekst, në zvogëlimin e barrës administrative kontribuojnë (1) **thjeshtimi organik apo strukturor në administratën publike**, sikurse racionalizimi i agjencive, racionalizimi i inspektiveve, etj., (2) **thjeshtimi administrativ**, apo pastrimi i legjislacionit nga barra administrative e panevojshme, si dhe (3) **digjitalizimi** apo investimet infrastrukturore teknologjike për ndërlidhjen e regjistrave publikë dhe gjenerimin automatik të të dhënave, si dhe krijimi i platformave elektronike, me anë të së cilave informohet dhe shërbehet qytetari, biznesi dhe vetë administrata.

Këto elemente dhe procese që ndikojnë në zvogëlimin e barrës administrative, kërkojnë planifikim, koordinim, menaxhim dhe mirëmbajtje të duhur, të cilat mund të kushtojnë dhe të marrin shumë kohë, por sjellin kursime si për palët ashtu edhe për administratën publike.

³ Shih *Vendimin 03/2022* të Komisionit për Planifikim Strategjik, të datës 24/11/2021, me nr. Protokollin 2735, për zbatimin Kornizës për Menaxhim dhe Planifikim Strategjik.

⁴ Përveç SRAP, do të përgatitet Strategjia e Qeverisjes Elektronike dhe Agjenda Digjitale, të cilat do përmbajnë objektivat dhe veprimet konkrete për avancimin e digjitalizimit në vend, përfshirë digjitalizimin e shërbimeve dhe ndërveprueshmërinë e sistemeve.

Sidoqoftë, në mënyrë të kombinuar, ato e motivojnë dhe plotësojnë njëra tjetrën, duke prodhuar rezultate dhe efekte sinergjike.

Planifikimi strategjik për trajtimin e barrës administrative, nënkupton parandalimin dhe zvogëlimin e saj nëpërmjet përfshirjes në të gjitha proceset e politikëbërjes. Programi do të fokusohet vetëm në thjeshtimin administrativ në kombinim me digjitalizim të procedurave administrative të thjeshtuara, të shoqëruar me veprime për ngritjen e kapaciteteve dhe veprime promovuese, që në njërin anë shërbejnë për qëndrueshmëri institucionale, ndërsa në anën tjetër shërbejnë për ngritje të vetëdijes të qytetarëve, bizneseve dhe vet administratës.

1.1. Qëllimet

Qëllimet kryesore të Qeverisë, të shprehura në Program janë:

- *Zvogëlimi i barrës administrative për qytetarët, bizneset dhe administratën;*
- *parandalimi i barrës administrative të panevojshme gjatë zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit të politikave publike.*

Me arritjen e qëllimeve të Programit, synohet:

- *rritja e kursimeve të qytetarëve dhe bizneseve;*
- *kënaqshmëria e qytetarëve dhe bizneseve me ofrimin e shërbimeve administrative nga administrata publike;*
- *rritja e vlerës së treguesve ndërkombëtarë relevantë për qëllimet e Programit, si Barometri i Ballkanit, Banka Botërore, SIGMA, etj.*

Qëllimet dhe synimet e shprehura në Program, do të kuantifikohen dhe operacionalizohen me masa dhe veprime konkrete në Planin e veprimit.



Figura 1 Harta e qëllimeve e ndërlidhur me kornizën strategjike dhe tipet e treguesve

1.2. Parimet

Për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, do të aplikohen dy tipe të parimeve, **parimet e Komisionit Evropian** (tash e tutje KE) për E-qeverisje dhe **parimet e përgjithshme administrative** sipas LPPA, të cilat ndërlidhen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me elementet e definuara, thjeshtimi i të cilave zvogëlon barrën administrative.

Parimet e KE për E-qeverisje, janë:

- *‘vetëm njëherë’* – asnjë organ i administratës publike nuk kërkon një informacion nga përdoruesi, të cilën i njëjti e ka dorëzuar më herët në administratë, në mënyrë që ‘të lëvizin të dhënat dhe jo përdoruesi’. Aplikimi i plotë i këtij parimi sfidohet nga problemet teknologjike, teknike, strukturore dhe ligjore. Prandaj, për mundësimin dhe lehtësimin e aplikimit të këtij parimi, Programi do të koncentrohet, mes tjerash, në aspektin ligjor që e mundëson këtë, si dhe në digjitalizimin që e mundëson lëvizjen e të dhënave dhe jo përdoruesit.
- *‘personalizimi’* – përdoruesit i shprehin preferencat e veta për ndërveprimin me administratën publike, të cilat i përdorin për ta bërë ndërveprimin sa më të thjeshtë. Personalizimi është një mjet i mirë për krijimin e marrëdhënieve të afërta me përdoruesin. Prandaj, për aq sa është e mundshme, Programi kërkon dhe jep udhëzimet që legjislacioni të hartohet në atë mënyrë, që ofrimi i shërbimeve nga ana e administratës publike të jetë sa më i qasshëm, i lehtë dhe i thjeshtë dhe fleksibil ndaj ndryshimeve të reja. Për mundësimin dhe lehtësimin e aplikimit të këtij parimi, Programi jep dhe kërkon zbatimin e udhëzimeve dhe elementeve të konsultimit dhe komunikimit.
- *‘ofrimi proaktiv i shërbimeve’* – administrata publike i di rrethanat e një përdoruesi dhe në mënyrë proaktive ofron shërbime dhe informata që përdoruesi ka nevojë dhe i dizajnon ato sipas nevojave, rrethanave, preferencave, etj.
- *‘së pari në mënyrë digjitale’* – përdoruesi ndërvepron me administratën publike duke përdorur mënyrën digjitale, përveç nëse ka arsye për të mos e bërë këtë.

Parimet e përgjithshme të procedurës administrative në Kosovë, i ngërthejnë parimet e KE për qeverisje elektronike. Parimet e përgjithshme administrative ofrojnë **një mundësi të re** për administratën publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve moderne për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve. Prandaj, me qëllim të aplikimit të thjeshtimit administrativ, elementet e definuara për zvogëlimin e barrës administrative, do të ndërlidhen me parimet e përgjithshme administrative, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i proporcionalitetit, parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, parimi i administratës së hapur, parimi i jo formalitetit dhe efikasitetit, parimi i mospagimit të procedurës dhe parimet tjera të përgjithshme.

Me qëllim të zbatimit apo lehtësimit të zbatimit të parimeve të theksuara më lartë, Zyra për Planifikim Strategjik (tash e tutje ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (tash e tutje ZKM) mund të bëjë dhe analiza dhe plane të veçanta, si dhe mund t’u kërkoj institucioneve përgatitjen e koncept dokumenteve dhe propozimin e masave dhe veprimeve konkrete nëpër dokumente strategjike.

1.3. Prioritetet

Në dy vitet e para operative, prioritet i Programit do të jenë thjeshtimi i informatave të obligueshme⁵ të nivelit qendror, duke u bazuar në ngjarje reale, ku përfshihen **lejet, licencat, regjistrimet, certifikimet, pëlqimet, vërtetimet, autorizimet, njohjet**, etj., informatat e obligueshme të nivelit lokal si dhe shërbimet për **subvencione dhe grante** në nivelin qendror.⁶ Prioritet i veçantë për Qeverinë është digjitalizimi i shërbimeve të thjeshtuara, ndonëse shpeshherë digjitalizimi e motivon thjeshtimin. Po ashtu, me prioritetet të lartë do të jetë **ngritja e kapaciteteve për parandalim dhe zvogëlim**, nëpërmjet trajnimit për barrë administrative të zyrtarëve përkatës në ZKM, ministritë e linjës dhe agjencitë vartëse të tyre, sipas nevojës dhe vlerësimeve. Duhet të theksohet se **inspektimet si barrë administrative**, do të trajtohen si proces në vete, nëpërmjet harmonizimit të legjislacionit, inspektimit elektronike dhe racionalizimit të trupave inspektuese.

Ndër të tjera, një prioritet të veçantë në Program, e zë **ngritja e vetëdijes dhe promovimi i rezultateve**, të cilat do të përdoren për informim të qytetarëve dhe binesëve, informim dhe vetëdijesim të vetë administratës publike, promovim i rezultateve të Qeverisë, rritje të transparencës, komunikimit dhe konsultimit.

Në kuadër të thjeshtimit dhe digjitalizimit të shërbimeve administrative, prioritet do të kenë ato shërbimeve të cilat, në bazë të analizave, konkludohet se përdoren më shumë **nga gratë dhe grupet e cënueshme**.

1.4. Elementet

Barrë administrative është çdo barrë e panevojshme që shkakton kosto administrative, u humb kohë qytetarëve dhe binesëve, për shkak të obligimit për pajtueshmëri me legjislacionin. Sidoqoftë, duhet theksuar se përderisa kostot administrative janë barrë administrative, jo e tërë barra administrative është kosto administrative, pasi që zvogëlimi i barrës administrative ka të bëjë edhe me efikasitetin në zbatimin e parimeve nga ana e zyrtarëve publikë. Efikasiteti dhe efektiviteti i administratës publike nuk ka të bëjë vetëm me zvogëlimin e barrës administrative apo pastrimin e legjislacionit nga elementet e panevojshme, por gjithashtu edhe me zbatimin e

⁵ Termi informat e obligueshme është përdorur për standardizim me praktikata e vendeve të OECD, por për definimin e informatës së obligueshme në Program, varësisht nga konteksti, do të përdoren termet si ‘shërbim administrativ’ dhe ‘procedurë administrative’, por të gjitha nënkuptojnë të njëjtë gjë: procedurën nga momentin që pala e paraqet kërkesën deri në momentin e dhënies së përgjigjes nga autoriteti publik për një shërbim të caktuar. Prioriteti i Programit janë **informatat e obligueshme** që duhet të bëhet kërkesë nga ana e palës. Këtu nuk hyjnë shërbimet shëndetësore e të ngjashme, ofrimi i të cilave është obligim i administratës kundrejt qytetarëve, për të cilat ZPS do të kërkoj adresimin e tyre në dokumente tjera strategjike.

⁶ Duhet theksuar se pothuajse e tërë barra administrative në shërbimet që ofrojnë komunat, shkaktohen nga legjislacioni i administratës qendrore, përveç atyre shërbimeve që derivojnë nga kompetencat e tyre vetanake. Duhet theksuar se pagesat apo tarifatat për shërbimet administrative të deleguara nga niveli qendror, komunat e kanë kompetencën e përcaktimit të tyre. Prandaj, zvogëlimi i barrës administrative në shërbimet e ofruara nga komunat nënkupton, mes tjerash, zvogëlim i barrës administrative që shkaktohet nga legjislacioni i nivelit qendror. Në të shumtën e rasteve, këto shërbime janë të njëjta nëpër të gjitha komunat, por për shkak të tarifave të ndryshme dhe zbatimit të ulët të reformave, me komunat do të punohet një nga një, përveç rasteve kur një shërbim komunal digjitalizohet dhe ofrohet për të gjithë në një qendër të vetme, si digjitalizimi i certifikatave të regjistrimit civil.

parimeve të përgjithshme administrative, gjë që bie në përgjegjësinë e hartuesve në një anë, dhe të zbatuesve të legjislacionit, në anën tjetër.

Gjatë veprimtarisë së tyre në raport me administratën publike, qytetarët dhe bizneset ballafaqohen me kostot rregullatore apo kostot të cilat pasojnë si rezultat i pajtueshmërisë me legjislacionin. Kostoja rregullatore mund të zërthehet në kosto të drejtpërdrejta, kostot e tërthorta, kostot e pajtueshmërisë, kostot afatgjate strukturore dhe kostot e vështirësisë.

Kostot e pajtueshmërisë janë kostot që ndërlidhen më së shumti me barrë administrative. Kostot e pajtueshmërisë ndahen në kosto përmbajtësore dhe **administrative**. Kostot përmbajtësore janë obligimet për investime ndërsa **kostot administrative** janë **informatat e obligueshme** dhe **dokumentet e kërkuara** për to që krijojnë **kosto**, si rezultat i obligimit ligjor.

Fokusi i Programit do të jetë e fokusuar në **koston e pajtueshmërisë** (me përjashtim të koston përmbajtësore), në elementet si më poshtë:

Elementi 1: Informata e obligueshme: secila informatë e obligueshme mund të thjeshtohet, bashkohet me një tjetër apo ëohet në tërësi, për evitimin e dyfishimeve dhe kompleksitetit, nëpërmjet zbatimit të drejtpërdrejtë të parimit të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit [neni 4 & 5, LPPA].

Elementi 2: Pagesa e aplikimit për informatën e obligueshme dhe pagesat tjera për dokumente për marrjen e informatës së obligueshme: disa prej informatave të obligueshme ofrohen me pagesë për qytetarë dhe biznese. Një nga parimet e qeverisjes së mirë është parimi i mbulueshmërisë së koston. Prandaj në secilën matje për barrë administrative kalkulohet edhe kjo pagesë dhe rekomandohet thjeshtimi i saj, që ndërlidhet me zbatimin e drejtpërdrejtë të parimit të mospagimit të procedurave administrative [nenet 10 & 12, LPPA].

Elementi 3: Dokumentet: për kompletimin e procesit për informatën e obligueshme, pala obligohet të sigurojë dokumente të ndryshme, një pjesë e të cilave përbëjnë barrë administrative të panevojshme. Prandaj, të gjitha dokumentet që përbëjnë barrë administrative, thjeshtohen dhe largohen, që ndërlidhet me zbatimin e drejtpërdrejtë të parimit të ligjshmërisë, proporcionalitetit, jo formalitetit dhe efikasitetit [neni 4, 5 & 10, LPPA].

Elementi 4: Vlefshmëria e informatës së obligueshme: vlefshmëria e informatës së obligueshme përbënë një prej elementeve kryesore për zvogëlimin e barrës administrative. Thjeshtimi i këtij elementi bëhet kur vlefshmëria e informatës së obligueshme zgjatet dhe shpeshtësia e aplikimit zvogëlohet për të njëjtën informatë të obligueshme: për zgjatjen e vlefshmërisë së një informate të obligueshme nga 1 në 2 vite, barra administrative është zvogëluar për 100%, për zgjatjen 2 në 3 vite, barra administrative është zvogëluar për 50%, për zgjatjen nga 4 në 5 vite, barra administrative është zvogëluar për 20%. Thjeshtimi i këtij elementi ndërlidhet me zbatimin e drejtpërdrejtë të parimit të ligjshmërisë dhe parimit të proporcionalitetit [neni 4 & 5, LPPA].

Elementi 5: Afati i pritjes: afati i pritjes për pranimin e përgjigjes për informatën e obligueshme, përbënë kosto të tërthortë financiare, që në të shumtën e rasteve përcaktohet me legjislacion. Prandaj, varësisht nga informata e obligueshme përkatëse, kur konsiderohet se afati i përcaktuar në legjislacion është i tejzgjatur, do të shkurtohet përshtatshëm. Ky element ndërlidhet edhe me koston e vështirësisë, e cila mund të prodhojë korrupsion, i manifestuar me pagesa joformale.

Thjeshtimi i këtij elementi ndërlidhet me zbatimin e drejtpërdrejtë të parimit të pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme [neni 8, LPPA].

Elementi 6: *Kërkesat shitesë administrative*: në disa raste, pas kompletimit të procedurës për marrjen e informatës së obligueshme dhe fillimit të veprimtarisë, palës i kërkohen të dhëna shitesë, siç është kërkesa për dorëzimin e raporteve të shpeshta apo vjetore dhe kërkesave tjera të ngjashme.

Elementi 7: *kushtëzimi administrativ*: në disa raste, për kompletimin e procedurës për marrjen e informatës së obligueshme, vendosen kushtëzime apo veprime të tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me informatën e obligueshme, apo shërbimin për të cilin ka aplikuar pala, siç janë kushtëzimi i pagesës së gjobave. Kjo nuk do të thotë ëim i gjobave, por ëim i kushtëzimit për pagesën e tyre, për marrjen e informatës së obligueshme apo shërbimit përkatës. Ëimin i kushtëzimeve administrative ndërlidhet me zbatimin e drejtpërdrejtë të parimit të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit [neni 4 & 5, LPPA].

Thjeshtimi i këtyre elementeve në shërbime ndikon drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kohës dhe kostos në procedurat administrative për qytetarë dhe biznese.

1.5. Metodologjia e përgjithshme për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative

Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative bëhet në dy faza: fazën *ex ante* dhe fazën *ex post*. **Në fazën *ex ante* do të parandalohet barra administrative, ndërsa në fazën *ex post* do të zvogëlohet.**⁷ Programi fokusohet në zvogëlimin e barrës administrative nëpërmjet **thjeshtimit administrativ apo pastrimit të legjislacionit**, në kombinim me **ridizajnimin e procedurave**. Për thjeshtim administrativ apo pastrim të legjislacionit, fokusi do të jetë në elementet e theksuara më lartë, ndërsa për ridizajnimin e procedurave fokusi do të jetë mbi proceset apo hapat procedural, të cilat janë planifikuar për sigurimin e cilësisë dhe ligjshmërinë e procedurës administrative, që në shumë raste, prodhojnë kompleksitet të lartë, efikasitet të ulët, kosto dhe vonesë. Duhet theksuar se me **thjeshtim** të shërbimeve administrative, nënkuptohet edhe **eliminimi** i plotë i një shërbimi administrative (psh., licence) apo **bashkimi i dy** shërbimeve administrative në një të vetëm. Duhet theksuar se vendimmarrja për thjeshtimin dhe nivelin e thjeshtimit të elementeve më lartë, në kontekst të analizave i takon Zyrës së Kryeministrit, ndërsa vendimi merret nga ana e Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrivë mbi bazën e koordinimit të mirë. Në rast të ndonjë pengese, kjo çështje trajtohet në Komisionit për Planifikim Strategjik.

Modeli i kostimit standard (tash e tutje MKS) nuk tregon se cili element duhet të thjeshtohet, por tregon vetëm nivelin e barrës administrative që shkakton elementi apo tërësia e elementeve së bashku.⁸ Prandaj, për përzgjedhjen e elementeve dhe hapave procedural të panevojshme për thjeshtim, nevojitet kryerja e një testi të proporcionalitetit dhe gatishmërisë aktuale, që ndihmon zyrtarin në përzgjedhjen e thjeshtimit. Gjatë identifikimit të interesit publik duhet të mishërohen

⁷ Shih pjesëzën Mjetet, në pjesën *Ex ante* vs *Ex Post*: parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative.

⁸ Shih më poshtë, te pjesëza 'Modeli i kostimit standard'.

parimet e theksuara më lartë në pjesëzën ‘Parimet’. Si udhëzim dhe orientim i zyrtarëve publikë të cilët janë të përfshirë në parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, kryesisht zyrtarët ligjorë dhe zyrtarët për planifikimin e politikave, do të shërbejnë pyetjet orientuese në theksuara në Shtojcën 4. Varësisht nga procesi, *ex ante* apo *ex post*, këto pyetje do të përdoren nga të gjithë zyrtarët publikë të cilët janë të përfshirë në hartimin e politikave publike (zyrtarët ligjorë dhe zyrtarët për hartim dhe koordinim të politikave).

Për ato analiza apo reforma të cilat kërkojnë ndryshimin e shumë ligjeve për të njëjtin qëllim, atëherë do të përdoret teknika ‘omnibus’, **e cila është më e thjeshtë, më e qartë, më e efektshme, që sjell rezultate të shpejta dhe zvogëlon barrën administrative në punën e Qeverisë dhe Kuvendit.**⁹ Kjo do të përcillet me matjen e kostos pas zvogëlimit të barrës administrative, me anë të MKS.

Po ashtu, gjatë procesit, do të inicohet metoda ‘**një brenda, një jashtë**’, që shërben për parandalimin dhe për zvogëlimin e barrës administrative. Për këtë do të inicohet një plan dhe analizë, për identifikimin e atyre informatave të obligueshme të cilat mund t’i nënshtrohen më shpejtë kësaj metode. Pas identifikimit të këtyre informatave të obligueshme, atëherë në cilindo rast që ministrat e linjës propozojnë legjislacion që përmbanë informatë të obligueshme, me argumentim të nevojshëm, do të kërkohet largimi i të vjetrës për pranimi i të resë. Për përshpejtimin e zbatimit të kësaj metode, e njëjta do të diskutohet bashkë me ministrat në Komisionin për Planifikim Strategjik.

Në fund, për të mos krijuar lehtësimin e punës për lexim dhe referim ligjor, do të aplikohet mjete i konsolidimit të legjislacionit primar dhe dytësor.

⁹ Ndërlidhja e zvogëlimit të barrës administrative me procesin e harmonizimit ligjor të ligjeve të veçanta me LPPA dhe ndërlidhjen e zvogëlimit të barrës administrative me reformën e përgjithshme të inspektiveve, është theksuar në *Koncept dokumentin për zvogëlimin e barrës administrative*, fq. 21-22, të miratuar me Vendimin nr. 03/05 të datës 06.03.2020. Mirëpo, pas diskutimeve me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, është planifikuar që ky bashkim i proceseve të mos ndodh, mirëpo të hartohet një ligj i vetëm për thjeshtimin e lejeve dhe licencave në nivel qendror, duke përdorur teknike ‘omnibus’.

2. EX ANTE & EX POST: parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative

Për mundësimin e parandalimit dhe zvogëlimin të barrës administrative, është i domosdoshëm planifikimi e koordinimi i mirë, i integruar dhe organik i tipeve të politikave publike në një vend të vetëm brenda ZKM, si dhe bashkëpunimi i mirë me ministrinë e linjës. Përpjekjet për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative, janë të domosdoshme dhe do të integrohen plotësisht në qarkoren rregullatore vendore. Ndonëse proceset *ex ante* dhe *ex post* dallojnë konceptualisht njëra me tjetrën, janë vendosur në një kapitull të vetëm, për arsye se mjetet të cilat mund të përdoren në të këto të dyja, janë të në të shumtën e rasteve të njëjta dhe ndarja e tyre do të mund të përbëntë dyfishim tekstual, ndonëse jo dhe aq përmbajtësor.

2.1. Proceset

Përgjatë qarkores rregullatore në Kosovë, fazat kryesore janë faza *ex ante* dhe faza *ex post*, ndërsa proceset kryesore të politikëbërjes janë procesi i zhvillimit të politikës publike, procesi i zbatimit të politikës publike dhe procesi i rishikimit të politikës publike. Për këtë qëllim, parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative janë pjesë e të tri proceseve të politikëbërjes, integrimi të cilave do të bëhet nëpërmjet aplikimit të parimeve, përdorimit të mjeteve dhe metodave për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative, të shpjeguara në pjesëzën e mëposhtme.




Figura 2 Qarkorja rregullatore e politikëbërjes në Kosovë

2.2. Mjetet

Mjetet për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, janë mjetet e rregullimit më të mirë, të cilat shërbejnë për zhvillimin dhe rishikimin e politikave publike. Me anë të mjeteve për rregullim më të mirë, të cilat aplikohen në Kosovë, do të bëhet identifikimi, parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative. Konsultimi, komunikimi dhe digjitalizimi janë disa prej mjeteve tjera të cilat kontribuojnë në parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, të theksuara më poshtë, si kapituj të veçantë të Programit.

2.2.1. Modeli i kostimit standard

Barra administrative e krijuar nga legjislacioni zvogëlimi i saj **kuantifikohet** nëpërmjet Modelit të Kostimit Standard (tash e tutje MKS). MKS mund të përdoret në të dy fazat, *ex ante* për parandalim dhe *ex post* për zvogëlim. MKS është **mjet neutral** ndaj legjislacionit, që vlerëson kostot administrative që ndërlidhen me zbatimin e legjislacionit, jep informacionin mbi efikasitetin e zbatimit të dispozitave ligjore, **nuk adreson nëse** informatat dhe të dhënat e kërkuara janë të arsyeshme, nëse legjislacioni **është i nevojshëm** dhe nëse stoku i barrës administrative aktuale **arsyeton përfitimet**. Prandaj, për përzgjedhjen e elementeve për thjeshtim (para apo pas kuantifikimit) është e nevojshme të bëhet një test i proporcionalitetit dhe gatishmërisë aktuale të administratës publike, nëpërmjet pyetjeve orientuese të theksuara në Shtojcën 4.

Kur mungojnë të dhënat mbi vëllimin e barrës administrative, **atëherë matja mund të bëhet paralel me ndryshimet në legjislacion, apo pas miratimit, kur edhe bëhen matjet e rezultateve**, të zbrërthyer në përqindje të thjeshtimit, në kursime, në kohë, etj. Nëse rezultatet nuk maten, atëherë nuk dallohet suksesi prej dështimit. Me qëllim të përshtatjes me nevojat dhe prioritizimin e Programit, **ZPS e përditëson MKS dhe udhëzuesin** për përdorimin e saj. Sidoqoftë, MKS është mjet fleksibil, që mund të thjeshtohet, mund të përshtatet me nevojat vendore dhe me elementet për zvogëlimin e barrës administrative, të theksuara më lartë, në pjesëzën ‘Definimi dhe elementet’, mirëpo ZPS do të kujdeset që ky thjeshtim apo përshtatje nuk do të ketë efekt në cilësinë e matjes dhe analizës. Të gjitha rregullat, ndarjet dhe aspektet tjera për nevoja të kuantifikimit, shpjegohen në udhëzuesin për MKS dhe në skedarin excel apo elektronik, i cili e mundëson kalkulimin gjenerik, sipas formulës standarde.

2.2.2. Vlerësimi i ndikimit rregullator

Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative do të bëhet gjatë hartimit të koncept dokumenteve nëpërmjet **vlerësimit të ndikimit rregullator**, si mjet që përfaqëson elementin empirik apo bazimin në të dhëna për hartimin e politikave publike, në veçanti legjislacionit. Para miratimit të koncept dokumentit nga Qeveria, në fazën e lëshimit të opinionit, ZPS e shqyrton koncept dokumentin, nëse opsioni i rekomanduar në koncept dokument, ka përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit rregullator për barrë administrative për qytetarë dhe biznese, në mënyrë që

legjislacioni i ri apo legjislacioni ekzistues i rishikuar, të mos ketë barrë administrative të panevojshme. Kuantifikimi i barrës administrative gjatë vlerësimit të ndikimit rregullator, si për *ex ante* për parandalim apo *ex post* për zvogëlim, do të bëhet nëpërmjet përdorimit të MKS.

Aplikimi i MKS për parandalimin e barrës administrative në rast të legjislacionit të ri për çështjet që më herët nuk kanë pasur rregullim, është më i rrallë dhe më i vështirë. Për këtë qëllim, mënyra më e mirë dhe në disa raste e vetmja për parandalimin e barrës administrative në legjislacionit e ri, që përmbajnë informata të obligueshme për biznese dhe qytetarë, është analizimi i praktikave të mira të vendeve tjera dhe aplikimi i parimeve për zvogëlimin e barrës administrative. Pas kuantifikimit të barrës administrative në legjislacionin ekzistues gjatë kryerjes së vlerësimit të ndikimit rregullator, për përzgjedhjen e elementeve që krijojnë barrë administrative të panevojshme duhet të largohen, duhet të merren parasysh **pyetjet orientuese**, të theksuara në Shtojcën 4.

Me qëllim të përshtatjes me parimet, elementet dhe prioritizimin e Programit, por edhe nevojave dhe kërkesave tjera, **ZKM rishikon dhe përditëson rregullat dhe udhëzimet** për hartimin e koncept dokumenteve.

2.2.3. Vlerësimi *ex post* i legjislacionit

Vlerësimi *ex post* i legjislacionit është shqyrtimi i legjislacionit në fuqi për përshtatshmërinë, efikasitetin, efektivitetin, koherencën, ndikimin dhe qëndrueshmërinë gjatë zbatimit. Për këtë arsye është më kompleks dhe përdoret më rrallë. Vlerësimi *ex post* si mjet i rregullimi të mirë, mund të përdoret edhe për zvogëlimin e barrës administrative. Për këtë qëllim, në vlerësimin për efikasitetin e legjislacionit gjatë zbatimit, do të bëhet edhe vlerësimi për barrën administrative e informatave të obligueshme që përmban legjislacioni. Për kuantifikimin e barrës administrative gjatë vlerësimit *ex post* të legjislacionit, përdoret MKS.

Në secilin rast që del se legjislacioni i vlerësuar përmban barrë administrative, atëherë vlerësimi *ex post* i legjislacionit duhet të përmbajë rekomandimin për zvogëlimin e saj dhe vlerësimin e rezultateve, pas zvogëlimit të saj. Sipas nevojës, ZPS e ndihmon institucionin përgjegjës për vlerësimin *ex post* të legjislacionit përkatës, **për përdorimin e MKS**, ndërsa ZL kontrollon dhe kërkon që vlerësimet *ex post*, të përmbajnë edhe analizën dhe rekomandimin për zvogëlimin e barrës administrative dhe zbatimin e rekomandimit në legjislacion. Pas kuantifikimit të barrës administrative në legjislacionin ekzistues gjatë vlerësimit *ex post* të legjislacionit, për përzgjedhjen e elementeve që krijojnë barrë administrative të panevojshme administrative duhet të largohen, duhet të merren parasysh **pyetjet orientuese**, të theksuara në Shtojcën 4.

2.2.4. Memorandumi shpjegues

Shpjegimi dhe justifikimi i legjislacionit është njëra nga shtyllat kryesore për kuptimin e legjislacionit nga ana e vendimmarrësve dhe praktikuesve. Për këtë arsye, memorandumi shpjegues (tash e tutje MSh) është mjet shumë i dobishëm edhe në procesin e parandalimit dhe

zvogëlimit të barrës administrative. Për secilin akt juridik, për të cilin nuk do të zhvillohet paraprakisht vlerësimin e ndikimit rregullator, atëherë MSh do të përmbajë elementet e vlerësimit të ndikimit rregullator, ku **pjesë e detyrueshme** do të jetë theksimi i zvogëlimit të barrës administrative. Institucioni propozues do të theksojë aspektin e zvogëlimit të barrës administrative, natyrisht, aty ku kjo qasje aplikohet sipas tipit të legjislacionit dhe ku parimet për zvogëlimin e barrës administrative janë të vlefshme. MSh do të përmbajnë shpjegimet për harmoninë e projektligjit të hartuar dhe koncept dokumentit, si dhe justifikimin për mospërputhjen e njëra tjetrës. Mes tjerash, MSh do të përmbajë edhe justifikimin për metodën apo teknikën e përdorur për hartim ligjor, si përdorimi i ‘omnibus’ për harmonizim ligjor, që zvogëlon barrën administrative për vet Qeverinë dhe Kuvendin, si dhe mundëson arritjen e shpejtë të ndryshimeve apo reformave të planifikuara. MSh do të përcillet së bashku me legjislacionin në Qeveri dhe në Kuvend. ZPS në bashkëpunim me ZL, do të përditësojnë udhëzimet për hartimin e MSh.

3. Digjitalizimi dhe zvogëlimi i barrës administrative

Koncepti tradicional i ofrimit të shërbimeve e ka administratën publike në qendër, koncept që lë anash kërkesat dhe përvojat e qytetarëve dhe bizneseve. Qasja e Programit e njeh dhe bazohet në qeverisjen elektronike me përdoruesin në qendër dhe në ngjarjet reale, duke marrë parasysh nevojat dhe përvojat e përdoruesit. Duhet theksuar se digjitalizimi, **në vete, e zvogëlon por jo në mënyrë të vërejtshme barrën administrative dhe nuk e përmirëson domosdoshmërisht efikasitetin dhe efektivitetin e administratës publike, nëse nuk aplikohet fillimisht thjeshtimi administrativ.** Digjitalizimi i duhur do të thotë më pak shëtitje administrative, më pak letër, më pak skanime, më pak shpenzime, më pak nevojë për sqarime dhe më shumë kohë për aktivitete tjera. Për këtë arsye, për të arritur efektin e vet fundor, digjitalizimit duhet t'i paraprijë thjeshtimi administrativ i procedurës për marrjen e informatave të obligueshme. Sidoqoftë, duke e pasë parasysh kompleksitetin e kornizës ligjore në vend, si dhe procese që mund të marrin kohë, si procesi i përgatitjes së akteve ligjore, atëherë mund të procedohet edhe me digjitalizimin para thjeshtimit administrativ, me planifikim të duhur të thjeshtimit në të ardhmen.¹⁰

Kësisoj, digjitalizimi **i duhur** e rritë besimin e qytetarëve në administratën publike, rritë llogaridhënien dhe transparencën, rritë përfshirjen e qytetarëve në punën e administratës publike, përmirëson qasjen nga grupet e margjinalizuara dhe kontribuon në mbrojtjen e mjedisit. Për këtë qëllim, digjitalizimi do të aplikohet në mënyrën më të thjeshtë që është e mundshme, e lehtë dhe e shpejtë për t'u përdorur, duke evituar paraqitjen fizike në administratë publike, dëshmitë, verifikimet nga pala dhe letrën e printuar. **Prandaj, legjislacioni duhet të hartohet në atë mënyrë që të mundësojë dhe jo të pengojë digjitalizimin.**

Nëpërmjet platformës E-Kosova do të aplikohet **parimi i 'një dritareje të vetme'**, ku do të publikohen **të gjitha** shërbimet e digjitalizuara, ndërsa të gjitha platformat tjera elektronike nëpërmjet të cilave ofrohen shërbime, do të jenë të ndërlidhura me E-Kosovën, duke e ndjekur **parimin 'një kyçje e vetme'**, që nënkupton mundësinë që përdoruesi mund të kyçet në cilindro sistem me një llogari të vetme, ku do të ofrohen shërbimet 24/7. Në E-Kosova do të aplikohen vazhdimisht të parimi i 'një dritareje të vetme' dhe parimi i 'një kyçjeje të vetme', si dhe e njëjta do të përmbajë të gjitha mjetet e komunikimit të mirë, të theksuara më poshtë, në kapitullin 'Konsultimi dhe komunikimi'. Platforma E-Kosova do të ndërlidhet me të gjitha regjistrat publikë, në atë mënyrë që për secilin shërbim të integruar në të, do të përdoren të dhënat e njëjta, në mënyrë që përdoruesi të mos ketë nevojë të përsërisë veprimet informuese kundrejt administratës publike. Platforma E-Kosova do të përmbajë edhe mënyrën e pagesës elektronike, dokumentet me vulë elektronike, etj. Një aspekt, tjetër që kontribuon në zvogëlimin e barrës administrative, është **përdorimi i nënshkrimit elektronik**, për çfarë duhet të vetëdijësohet publiku dhe vetë administrata publike. Mirëpo, orientimet dhe veprimet e nevojshme për këtë aspekt, do të vendosen në SRAP, SQE dhe në dokumente tjera strategjike.

¹⁰ Kjo është dëshmuar në rastin e shërbimit të vazhdimt të regjistrimit të veturave, si shërbim prioritet në këtë Program për thjeshtim, i shprehur në masën 2 të Planit të Veprimit.

4. Ngritja e kapaciteteve

Me qëllim të zbatimit të Programit duhet të ngriten kapacitetet e zyrtarëve koordinues dhe zbatues në mënyrë të vazhdueshme, duke filluar nga zyrtarët e ZKM dhe atyre të ministrive të linjës. Për këtë qëllim, do të ndiqet qasja e kombinuar dhe do të zhvillohet **moduli i trajnimit për barrë administrative**, i cili do të jetë një **kombinim i komponenteve kryesore për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative**: MKS, vlerësimi i ndikimit rregullator, parimet e procedurave të përgjithshme administrative dhe hartimi ligjor.¹¹ Këto komponenta **shoqërohen me pjesë konceptuale**, si definimi i barrës administrative dhe digjitalizimi në funksion të barrës administrative. Duhet pasur parasysh se edhe vlerësimi *ex post* i legjislacionit është një prej mjeteve të rregullimit më të mirë dhe mund të përdoret vetëm për zvogëlimin e barrës administrative. Sidoqoftë, për shkak se vlerësimi *ex post* i legjislacionit bëhet më rrallë dhe më një përzgjedhje prioritare, është lënë jashtë këtij moduli, ndonëse rregullat e njëjta për zvogëlimin e barrës administrative, si në rastin e vlerësimit të ndikimit rregullator, vlejné edhe gjatë vlerësimit *ex post* të legjislacionit.




Figura 3 Komponentat e trajnimit dhe ndërlidhja me njëra tjetrën

Pjesëmarrja në trajnim do të jetë e kombinuar, që nënkupton se zyrtarët me **funksione të ndryshme** do të ndjekin **trajnimin e njëjtë** përnjëherë, ku ndahen sfidat, problemet, pyetjet, mësimet dhe përvojat mes tyre. Qasja e kombinuar për ngritje të kapaciteteve, e cila e **motivon interaktivitetin**, bënë që trajnimi të jetë i dobishëm për krijimin e qëndrueshmërisë institucionale në funksion të parandalimit dhe zvogëlimin të barrës administrative. Kjo qasje, do të shërbejë, mes tjerash, edhe për vetëdijesimin e zyrtarëve publikë për procesin e barrës administrative, që nga fillimi deri në fund, si dhe rëndësinë e ndikimit e saj në ekonomi e shoqëri. Trajnimet do të shoqërohen me udhëzues dhe praktikume të përgatitur nga ZPS në

¹¹ Ndonëse secila prej këtyre komponentave e ka modulën e vet të veçantë trajnimit, të njëjtat janë të përgjithshme dhe nuk e kanë theksin të BA, sipas analizës të realizuar nga ZPS.

bashkëpunim institucionet tjera relevante, në mënyrë që zyrtarët e trajnuar, të kenë një mjet të cilit i referohen gjatë punës së tyre ditore, në funksion të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative. Trajnimet do të organizohen sipas prioritizimit institucional, jo më shumë se dy trajnime në muaj dhe jo më pak se tre ditë për trajnim. Trajnimin do e përcjellë një test i njohurive, në fillim dhe në fund të trajnimit, për vlerësimin e ndikimit të trajnimit. Po ashtu, trajnimi do të zhvillohet **në mënyrë elektronike**, në mënyrë që zyrtarët e interesuar publikë dhe publiku të kenë mundësi të trajnohen dhe të vetëdijesohen, sa i përket aspekteve kryesore të barrës administrative. Versioni elektronik do të ketë edhe formën e testimit dhe certifikimit, në mënyrë elektronike dhe do të shfaqet online.

5. Konsultimi dhe komunikimi

Konsultimi dhe komunikimi të organizuara në mënyrë të duhur, janë mjete për rregullimin më të mirë për aktivizimin dhe përfshirjen e publikut në zhvillimin e politikave dhe ngrit vetëdijen për barrë administrative dhe rezultatet e zvogëlimit të saj. Komunikimi dhe promovimi i rezultateve të mira të zvogëlimit të barrës administrative do të bëhet sa më thjeshtë dhe me përdoruesin në qendër. Konsultimi e komunikimi i organizuar mirë, si dhe ngritja e vetëdijes në formën e duhur, e përmirëson reputacionin, e rritë besimin dhe e ndryshon perceptimin për administratën publike dhe zyrtarët publikë.

Komunikimi i brendshëm është mënyrë e mirë për kuptimin dhe koordinimin më të mirë të procesit të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative, që ndikon në njohjen, sjelljen, përgjegjësinë dhe inovacionin e zyrtarëve publikë. Prandaj, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për barrën administrative dhe krijimin e kulturës të qëndrueshme administrative për zhvillim të politikave dhe ofrim më të mirë shërbimeve, do të përdoret **qasja e kombinuar ndërmjet aktivizimit të publikut dhe trajnimi dhe komunikimi i zyrtarëve publikë**.

5.1. Konsultimi i fokusuar

Politikat publike të mira zhvillohen nëpërmjet përfshirjes të sa më shumë palëve që afektohen nga ajo politikë. Për këtë, organizimi i konsultimit me palët relevante që afektohen nga politikat, është një nga elementet thelbësore në parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative. Organi propozues duhet të mbledhë në konsultime të fokusuara grupet që afektohen nga politika publike, si gjatë hartimit të strategjive, koncept dokumenteve, etj., duke u bazuar në ngjarje reale. Ngjarjet reale shpesh paraqet efektet e fshehura të legjislacionit. Aspektet që duhet të diskutohen me grupet e fokusuara mbi barrën administrative janë informatat e obligueshme, dokumentet që kërkohen për sigurimin e informatës së obligueshme, vlefshmëria e informatës së obligueshme, kostot, koha dhe çështja tjera që përbëjnë barrë administrative, sipas qasjes së vendosur me këtë Program.

Konsultimi i fokusuar do të bëhet me dokumente të qarta dhe koncize të politikave publike, targetim të duhur, thirrje të duhur dhe të qasshme për kontribut, kohë të mjaftueshme dhe publikim të kontributeve dhe rezultateve. Për sigurimin dhe kryerjen e konsultimit të fokusuar, ministritë e linjës dhe ZKM, përfshijnë dhe kërkojnë mendimin e grupeve të fokusuara, mundësisht për çdo politikë të propozuar. Për këtë, metodologjitë e dokumenteve strategjike dhe të politikave, si dhe MSh duhet të theksojnë, mes tjerash, edhe aspektin e konsultimit të fokusuar. Në rast të ndonjë rishikimi apo ndryshimi të madh të sektorit, e cila pason me ndryshime rigoroze ligjore apo zhvillimin e pakove ligjore përkatëse, ZPS mund të kërkojë organizimin e mbledhjeve të **mekanizmave përkatës për zhvillim ekonomik**, në mënyrë që të realizohet **dialogu publiko-privat** ndërmjet Qeverisë dhe komunitetit të biznesit, në funksion të identifikimit të barrës administrative dhe parandalimin e zvogëlimin e saj.

Disa prej pyetjeve orientuese që shërbejnë për identifikimin e publikut të fokusuar, janë:

- Kë e afekton politika publike dhe informata e obligueshme e propozuar në të?
- Kush e zbaton politikën publike dhe informata e obligueshme e propozuar në të?

Mjetet të cilat do të përdoren për konsultimin e fokusuar për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative janë pyetësorët, intervistat, sms-ët, tryezat, konferencat, e mjete të tjera të ndryshme inovative.

5.2. Komunikimi

Komunikimi do të jetë i qartë dhe sqarues mbi propozimet dhe rezultatet e Qeverisë, në funksion të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative. Publiku do të informohet mbi aspektet të cilat i kursejnë kohë dhe para në marrjen e shërbimeve nga administrata publike. Duke marrë parasysh zhvillimin e madh teknologjik dhe medial, mjetet e preferuara të publikut mbeten mediat sociale, televizionet dhe interneti. Për shkak të këtij diversiteti të madh, komunikimi duhet do të jetë gjithëpërfshirës, i thjeshtë dhe efektiv, që i mundëson publikut të krijojë përshtypjet e veta mbi rezultatet e mira. Komunikimi do të jetë i orientuar kah përdoruesi, nëpërmjet ndërlidhjes së rezultateve të reformave me përvojat e përdoruesve, se si ato e përmirësojnë kualitetin e jetës dhe aktivitetit të tyre të përditshëm, duke evituar përshkrimet që ndjekin formalitetin dhe kompleksitetin administrativ.

Komunikimi për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative do të realizohet nëpërmjet mesazhit dhe thirrjes politike, organizimit të ngjarjeve, materialeve të printuara, videove të ndryshme dhe nëpërmjet platformave elektronike që ofrojnë shërbime, të cilat nuk do të përmbajnë vetëm të dhëna statistikore, por rezultate dhe përfitime të grupit të fokusuar.

Komunikimi i rezultateve të zvogëlimit të barrës administrative **nëpërmjet mesazhit dhe thirrjes politike do të bëhet nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe Ministrat**, varësisht nga rëndësia dhe pronësia e reformës. Mesazhet dhe thirrjet e tyre mund të jenë në formën e postimeve në rrjetet sociale, intervistave në media dhe videove të shkurta që shfaqen në media dhe në internet, të përgatitura mirë dhe me mesazhe të qarta politike. Platforma e ZKM, do të përmbajë **një dritare apo një rubrikë të veçantë për barrë administrative**, e cila shërben për informim dhe promovim.

Organizimi i ngjarjeve të ndryshme në formën e takimeve, konferencave, seminareve, punëtorive, anketave dhe tryezave, me grupe të ndryshme **të të rinjve, të moshuarve, përfaqësues të bizneseve, shoqërisë civile, zyrtarëve publikë, studentëve, fermerëve, gastronomive, etj., do të mbahen nga niveli politik dhe shërbimi civil**. Këto organizime do të mbulohen nga mediet apo nga platformat e ndryshme në internet. Për promovimin më të mirë të rezultateve të zvogëlimit të barrës administrative, ngjarjet e organizuara do të shoqërohen me materialet të ndryshme për komunikim, si broshurat, fletëpalosjet, banerët, manualet, etj.

Duke u bazuar në ngjarjet reale dhe efektin e zvogëlimit të barrës administrative, do të krijohen **video të animuara të ndryshme**, të cilat do të shfaqen në **media, internet dhe në platformat elektronike të administratës publike të cilat ofrojnë shërbime**. Videot e animuara nuk do të jenë në formatin **përshkrues**, por në formatin **shpjegues**, të përkthyer në **tri gjuhë**.

Për promovimin dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike, platforma E-Kosova dhe platformat tjera, do të orientohen dhe do të tentojnë të zbatojnë parimet si në vijim:

- *Asistenca vetanake apo vetëshërbimi digjital*, që u mundëson qytetarëve të jenë plotësisht autonom në një faqe interneti dhe të gjejnë zgjidhet pa pasur nevojë për shëtitje dhe hulumtime të mëtutjeshme. Për këtë qëllim, mes tjerash, ASHI obligohet që për secilin shërbim që ofrohet në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës E-Kosova, të përmbajë ‘pyetjet e shpeshta’, të cilat mund të përditësohen duke u bazuar në ankesat, komentet dhe idetë e përdoruesve.
- *Omnikanali*, që ofron një qasje të plotë dhe gjithëpërfshirëse në mbështetje të përdoruesve për marrjen e shërbimeve nga platforma elektronike.



- ❖ *Komunikimi më zë*, që u mundëson përdoruesve që nëpërmjet telefonit të bisedojnë me mirëmbajtësit e platformës. Kjo formë është shumë e dobishme për të moshuarit dhe grupet e marginalizuara.
- ❖ *Rrjetet sociale*, që u mundëson përdoruesve të zgjedhin llojin e medieve që ata dinë të përdorin. Kjo formë shfrytëzohet më shumë nga të rinjtë.
- ❖ *Chatboti*, që mundësohen nëpërmjet programeve të automatizuara, të cilat kanë zgjidhje të shpejta për probleme të lehta.
- ❖ *Mesazhet*, që u mundësojnë përdoruesve të zgjidhin problemet dhe sfidat tekstualisht nëpërmjet telefonit. Kjo formë shfrytëzohet më shumë nga të moshuarit dhe grupet e marginalizuara.
- ❖ *Email*, që u mundëson përdoruesve të shpjegojnë problemet dhe sfidat në detaje. Kjo formë shfrytëzohet më shumë kur problemet dhe sfidat janë të ndërlikuara dhe konsiderohet formë më e besueshme e komunikimit.
- ❖ *Shfletimi i përbashkët*, që u mundëson përdoruesve të kuptojnë më mirë përdorimin e sistemit. Kjo formë përdoret më shumë kur shërbimi merret për herë të parë.

6. Koordinimi i Qeverisë me Kuvendin dhe Komunat

Për mbarëvajtjen e procesit të zvogëlimit të barrës administrative, koordinimi i Qeverisë me Kuvendin dhe me komunat është i domosdoshëm. Koordinimi me Kuvendin është i domosdoshëm për arritjen e rezultateve, ndërsa me komunat, përveç të tjerash, edhe për zbatimin e ndryshimeve. Përgjegjës për komunikimin me Kuvendin për zvogëlimin e barrës administrative, është Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë.

Sa i përket koordinimit me Kuvendin, në legjislacionin i cili nuk ngërthen aspekte politike kontraverse, përkushtimi i Kuvendin do të jetë më i lartë, por me mbikëqyrje efektive parlamentare. Ndër të tjera, bashkëpunimi me Kuvendin është i domosdoshëm për zvogëlimin e barrës administrative në legjislacionin dhe informatat e obligueshme të shkaktuara nga agjencitë rregullatore.¹²

Një aspekt i rëndësishëm i koordinimit të zvogëlimit të barrës administrative ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit, është ndryshimi i shumë ligjeve me një akt të vetëm ‘omnibus’. Pasi që kemi të bëjmë me reformë të madhe e cila ka efekte të mëdha në jetën e qytetarëve dhe në veprimtarinë e bizneseve, Kuvendi duhet të lajmërohet me kohë dhe t’u shpjegohet intervenimi, në mënyrë që të evitohen keqkuptimet dhe vonesat e mundshme. Prandaj, para se legjislacioni të shkojë në Kuvend për reforma të mëdha dhe nëpërmjet ‘omnibusit’, atëherë do të organizohen takime me komisionet përkatëse parlamentare, në mënyrë që reforma të jetë e koordinuar mirë dhe të mos ketë vonesa të panevojshme.

Sa i përket koordinimit me komuna, duhet të kihet parasysh se barra administrative në shërbimet që ofrohen nga komunat, në përqindje jashtëzakonisht të madhe, shkaktohet nga legjislacioni i hartuar dhe miratuar në nivel qendror. Prandaj, përfshirja e tyre në grupet punuese, njoftimi, trajnimi dhe ngritja e vetëdijes së zyrtarëve komunal mbi intervenimet në funksion të zvogëlimit të barrës administrative, janë të domosdoshme. **Secila komunë do të përcaktojë personin përgjegjës për barrën administrative, në mënyrë që i njëjti të komunikojë me administratën publike dhe publikun për arritjen e rezultateve.** Po ashtu, personat përgjegjës për barrën administrativ në komuna, do të jenë pjesë e trajnimeve, që do të rezultojnë në ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe ngritjen e vetëdijes për zvogëlimin e barrës administrative.

¹² Në kuadër të analizimit të barrës administrative, në Planin e veprimit janë edhe analizimi i informatave të obligueshme, në kuadër të agjencive rregullatore. Shih masën e parë në kuadër të Planit të veprimit.

7. Zbatimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

7.1. Koordinimi politik

Për zbatimin e suksesshëm të Programit, **përgjegjës politik është Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë**. Për këtë qëllim, Zëvendëskryeministri i parë do të angazhohet për shtytjen përpara të masave në Program për zvogëlimin të barrës administrative, duke kërkuar nga ministrat dhe zëvendësit e tyre angazhim dhe përkushtim politik.

Struktura përgjegjëse ndër-institucionale në nivel politik për shtytjen e zbatimit të suksesshëm të Programit, është **Komisioni për Planifikim Strategjik** (tash e tutje KPS). Në mbledhjet e KPS marrin pjesë ministrat të cilët duhet të informohen dhe t'u kërkohej zbatimi i masave për zvogëlimin e barrës administrative, sipas Programit.¹³

Në mbledhjet e KPS, mund të **merren vendime dhe të jepen rekomandime** për zbatimin e Programit, si dhe të kërkohej zgjidhje për sfidat dhe problemet në proces.

7.2. Koordinimi profesional

Për zbatimin e suksesshëm të Programit, janë dy tipe të koordinimit në nivel të shërbimit civil, **koordinimit strukturor dhe koordinimit rregullator**.

Koordinimi strukturor mund të përmblihet në përgjithësi, në trinitetin e mëposhtëm:

- **Zyra për Planifikim Strategjik** është përgjegjëse për planifikimin e barrës administrative, koordinimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të Programit, matjen apo kuantifikimin e barrës administrative, si dhe aspekte tjera të theksuara në këtë Program.
- **Zyra Ligjore** e Zyrës së Kryeministrit, është përgjegjëse për shqyrtimin ligjor të të gjitha akteve juridike në funksion të parandalimit dhe zvogëlimin të barrës administrative, para se ato të miratohen nga Qeveria apo ministrat përkatës.
- **Agjencia e Shoqërisë së Informacionit** në bashkëpunim me institucionet tjera, është përgjegjëse për koordinimin e procesit të digjitalizimit të shërbimeve administrative dhe vendosjes së tyre në platformën E-Kosova, si dhe është përgjegjëse edhe për aspekte tjera të theksuara në këtë Program.

Për lehtësimin e punës së koordinimit dhe zërthimit të përgjegjësive institucionale nga lart poshtë, në kuadër të koordinimit strukturor, do të themelohen dhe shërbejnë edhe këto kategori koordinuese:

¹³ Shih Vendimin e Qeverisë 04/12 të datës 09.07.2020 për themë e Komisionit për Planifikim Strategjik. KPS krysohet nga Kryeministrit, por sipas legjislacionit në fuqi, Zëvendëskryeministri i parë mund të kryesoj KPS për çështje specifike, siç është barra administrative.

- **Zyrtari përgjegjës për barrë administrative** nëpër ministritë e linjës dhe agjencive ekzekutive relevante, i caktuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë të linjës. Emërimi i një zyrtari përgjegjës për barrë administrative është i nevojshëm edhe në disa prej agjencive ekzekutive, prandaj në bazë të nevojave dhe vlerësimeve, agjencitë ekzekutive do të emërojnë të njëjtit. Personi përgjegjës nëpër ministri të linjës, mund të jetë zyrtarë i **departamentit ligjor apo departamentit për integritet evropian dhe koordinim të politikave**. Në rast se shihet e nevojshme dhe duke u bazuar në institucione, mund të caktohet edhe dy zyrtarë përgjegjës. Po ashtu, do të caktohet personi përgjegjës për barrë administrative në secilën komunë.
- **Këshilli ndër-ministror për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, si trupë qeveritare, që vlerëson dhe kujdeset për zbatimin e Programit**, si dhe jep zgjidhje për sfidat dhe problemet, para se këto të kalojnë për koordinim politik. Anëtarët e trupës qeveritare, do të jenë personat përgjegjës për barrën administrative, të cilët do të **takohen sipas sektorëve dhe temave që diskutohen**. Ndër të tjera, në trupën qeveritare, mund të ftohen si anëtarë edhe personat përgjegjës për barrë administrative nëpër komuna, ndërsa në cilësinë e vëzhguesve dhe mbështetësve mund të ftohen **ekspertë të fushave relevante për barrën administrative, shoqëria civile, komuniteti i biznesit dhe përfaqësuesit e partnerëve zhvillimorë**. Përgjegjësitë dhe detyrat e trupës qeveritare, përcaktohen me vendim të Qeverisë.

Koordinimi rregullator mund të përmblihet në përgjithësi, në këto aspekte:

- Në rast se legjislacionit (të ri apo të rishikuar) në proces të hartimit, i ka paraprirë koncept dokumenti apo vlerësimi *ex post* i legjislacionit, atëherë në grupin punues për hartimin e legjislacionit, sipas mundësisë, **marrin pjesë një numër i zyrtarëve të njëjtë që kanë hartuar koncept dokumentin** apo vlerësimin *ex post* i legjislacionit;
- Në grupin punues për hartimin e legjislacionit **merr pjesë personi përgjegjës për barrë administrative** në institucionin propozues;
- Gjatë konsultimeve paraprake, **ZL do të shqyrtojë legjislacionin e ri në funksion të zvogëlimit të barrës administrative**, sipas qasjes të vendosur në këtë Program dhe do të jap rekomandimet e veta për ndryshim. Në rast se institucioni propozues insiston për dispozitat që krijojnë barrë administrative, ato duhet të justifikohen mirë në MSh;
- Gjatë konsultimeve paraprake, për legjislacionin e ri apo legjislacionin ekzistues të rishikuar, ZPS dhe ZL, së bashku do të shqyrtojnë të njëjtin **mbi përputhshmërinë me koncept dokumentin** që i ka paraprirë (nëse ka) dhe do të japin rekomandimet e veta, sipas qasjes të vendosur në këtë Program. Në rast institucioni propozues insiston në ndryshimet që nuk janë në harmoni me koncept dokumentin që i ka paraprirë, atëherë kjo duhet të justifikohet mirë në MSh, me integrimin e vlerësimit të ndikimit rregullator për ndryshimet e reja;

- Gjatë konsultimeve paraprake, ZL do të shqyrtojë legjislacionin ekzistues të rishikuar sa i përket përputhjes me rekomandimet e dala nga vlerësimi *ex post* të legjislacionit (nëse ka);
- Para miratimit të legjislacionit në Qeveri apo Ministri, në rast së legjislacioni i ri apo i rishikuar, krijon barrë administrative të panevojshme dhe është në shpërputhje me koncept dokumentin apo vlerësimin *ex post* të legjislacionit, si dhe kjo nuk është justifikuar mjaftueshëm në MSh, **ZL dhe ZPS lëshojnë opinione negative**, të argumentuara mirë, ku i rekomandojnë Qeverisë apo Ministrisë që të mos e miratojnë legjislacionin e propozuar.

Departamenti përgjegjës për procesin e barrës administrative është Zyra për Planifikim Strategjik, ndërsa sa i përket funksionit të koordinimit të koncept dokumenteve, do të vazhdojë të koordinohen në Sekretariat të Zyrës së Kryeministrit, por koncept dokumentet që vlerësohet që duhet të shqyrtohen në kontekst të barrës administrative, duhet të iniciohen, shqyrtohen dhe miratohen në bashkëpunim me ZPS. Po ashtu, koncept dokumentet që do të hartohen vetëm për shkak të procesit të barrës administrative, do të iniciohen, koordinohen dhe kryesohen nga ZPS. Përgjegjësitë për funksionet e lartpërmendura mund të ndryshohen me anë të organizimit të brendshëm të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive.

Këto aspekte të përgjithshme për koordinimin rregullator, por të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të Programit, **do të përkthehen në dispozita ligjore në Rregulloren e Punës së Qeverisë (tash e tutje RrPQ) dhe në udhëzime konkrete në udhëzues përkatës**. ZPS mund të ndryshojë udhëzimet për përdorimin e mjeteve përkatëse të rregullimit më të mirë, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme për zbatimin e Programit.¹⁴

Shqyrtimi dhe rishikimi i qasjes, qëllimeve, parimeve dhe prioritizimit të Programit dhe Planit të Veprimit ndryshohet sipas **nevojave, vlerësimeve dhe rrethanave**.¹⁵ Për nevoja të zbatimit të Programit, ZPS së bashku me institucionet tjera, mund të **zhvillojë plane konkrete**, të cilat i bashkëngjiten Programit. Të njëjtat mund të **miratohen në KPS apo në Qeveri**, varësisht nga natyra e veprimeve në planin konkret. Për zbatimin e suksesshëm të Programit, ZPS do të kujdeset që veprimet në PV të Programit, **të jenë pjesë e planifikimit operacional vjetor, si objektiva dhe veprime konkrete**.

Për zbatimin e Programit në tërësi, do të koordinohet dhe **do të kërkohet ndihma e partnerëve zhvillimorë**. Për zbatimin e masave dhe veprimeve të Programit, mund të kërkohet ndihma dhe angazhimi i **ekspertëve dhe studentëve**, varësisht nga tema dhe prioriteti. Kategoria e fundit mund të ndihmojnë posaçërisht për **intervistimin e palëve dhe matjen e vlerës bazë të barrës administrative dhe treguesve në terren**, si dhe aspekteve tjera administrative në funksion të zbatimit të Programit.

¹⁴ Veprimet për ndryshimin e RrPQ dhe udhëzuesit përkatës, planifikohen edhe në SRAP, pasi që, përveç ndryshimeve në funksion të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative, përditësohen edhe për nevoja tjera në kuadër të politikëbërjes, sipas të gjeturave vendore dhe rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare, si SIGMA.

¹⁵ Programi apo Plani i Veprimit, mund të rishikohen varësisht nga rrethanat e krijuara. Duhet theksuar se, aspekte të planifikuara në Program, sikurse pjesa e digjitalizimit, mund të transferohen dhe avancohen më shumë në Strategjinë për Qeverisje Elektronike.

7.3. Koordinimi me partnerët zhvillimorë

Ndër partnerët zhvillimorë kryesorë për procesin e barrës administrative në Kosovë janë Zyra e BE-së në Kosovë, GIZ dhe IFC. Konsultimi dhe bashkëpunimi me partnerët zhvillimorë është një nga prioritetet kyçe të theksuara në Program. Qëllimi kryesor i partnerëve zhvillimorë është krijimi i një platforme të qëndrueshme për procesin e barrës administrative, respektivisht për thjeshtimin dhe digjitalizimin e shërbimeve administrative, duke u bazuar në disa parime si ato të Komisionit Evropian për qeverisje elektronike dhe parimet e procedurës administrative vendore.

Koordinimi do të bëhet nëpërmjet takimeve të rregullta, veçanërisht në kuadër të projektit të asistencës teknike për procesin e zvogëlimit dhe parandalimit të barrës administrative, të financuar nga IPA dhe qeveria gjermane dhe implementuar nga GIZ. Në takimet e Komitetit Drejtues do të ftohen të gjithë partnerët që përkrahin procesin dhe do të ndahen detyrat dhe aktivitetet që do të realizohen nga secili partner.

7.4. Ndikimi buxhetor i zbatimit të Programit

Ndikimi buxhetor i Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 konsiderohet të jetë **rreth 40 milionë euro**. Modaliteti për zbatimin e suksesshëm të Programit dhe ndërlidhjes së tij me buxhet, është ndërlidhja e procesit të barrës administrative me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe koordinimi i mirë i mbështetjes së partnerëve zhvillimorë.

Vitet 2022-2024

Zbatimi i Programit për vitet 2022-2024 mbulohet nga Plani i Veprimit 2022-2024, veprimet e të cilit e kanë vlerën financiare prej **14 milionë e 471 mijë e 682 euro**, nga të cilat 4 milionë e 600 mijë e 204 euro, janë të planifikuara në kuadër të buxhetit të vitit 2022 dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2023-2024.

Ndërsa, 9 milionë e 871 mijë e 478 euro, janë zotime nga partnerët zhvillimorë, ku përfshihen partnerët si në vijim: Bashkimi Evropian dhe Qeveria gjermane përmes projektit të zbatuar nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Qeveria Zvicerane përmes fondeve të kontraktuara nga Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC) dhe partnerë të tjerë. Pra, Plani i Veprimit 2022-2024 është i mbuluar plotësisht me mjetet financiare.

Vitet 2025-2027

Vlerësimet indicative për pjesën e dytë të zbatimit të Programit, për vitet 2025-2027, kanë vlerën indicative prej **25 milionë euro**. Këto mjete financiare janë të nevojshme për vazhdimin e thjeshtimit dhe digjitalizimit të shërbimeve administrative në nivel qendror dhe lokal, gjatë

viteve 2022-2027, dhe aspekteve tjera që ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me zvogëlimin e barrës administrative.

Hendeku financiar

Mjetet financiare prej **25 milionë euro**, për vitet 2025-2027, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e pjesës së dytë të Programit, ende nuk janë të planifikuara në dokumente të buxhetit dhe në këtë fazë të hershme nuk ka ndonjë zotim nga ana e donatorëve.

Zbatimi i parimit të mbulueshmërisë së kostot, i mishëruar në nenin 12 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, do të sjell një zvogëlim apo elimin të pagesave për marrjen e shërbimeve. Të hyrat buxhetore të humbuara sipas vlerësimeve, pas zbatimit të këtij parimi do të jenë indikativisht 2 milion euro për vit, edhe për nivel qendror edhe në nivel lokal. Përderisa është e vështirë të vlerësohet saktësisht hendeku i të hyrave në baza vjetore që rrjedhin nga zbatimi I këtij parimi, mund të vlerësohet se në fund të Programit, në vitin 2027, të hyrat vetanake të komunave si shembull, mund të zvogëlohen më shumë 10 milion euro.¹⁶

Prandaj, për momentin, **25 milionë euro për zbatimin e Programit pas vitit 2025 dhe 10 milionë eurove si rënie e të hyrave buxhetore** nga eliminimi apo zvogëlimi i pagesave për shërbime administrative, vlerësohet se hendeku financiar për zbatimin e Programit është **është rreth 35 milionë euro**.

Disa prej investimeve dhe veprimeve, të cilat do të kenë një ndikim në disa prej veprimeve të planifikuara në këtë Program, nuk janë të përfshira në këtë Program dhe në kostimin e tij, pasi që këto veprime parashihet të vendosen në Strategjinë për E-Qeverisje.

Sigurimi i mjeteve financiare për zbatimin e Programit

Sigurimi i buxhetit për zbatimin e Programit, do të bëhet nëpërmjet përfshirjes së veprimeve të planifikuara në Program në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, deri në vitin 2027. Ndarjet buxhetore ministrore dhe kombinimi i tyre me mbështetjen e partnerëve zhvillimorë, do të mundësojnë zbatimin e suksesshëm dhe në kohë të Programit.

Për zbatimin e suksesshëm dhe në kohë të Programit, do të konsiderohen edhe fondet e IPA, nëpërmjet mbështetjes sektoriale buxhetore, ku arritja e treguesve përkatës sjell përfitime direkte financiare. Fondet e disbursuara në buxhet, pas arritjes së treguesve përkatës për thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve administrative, në bazë të vlerësimeve buxhetore por edhe

¹⁶ Duke u bazuar në Të hyrat e Përgjithshme të Qeverisë, të raportuara në Llogaritë Qeveritare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/llogarite-qeveritare>), pagesat për shërbimet administrative hyjnë të kategoria P131 Pagesat për prodhimet jo regtare (shitjet). Kjo kategori është ndarë duke u bazuar në Sistemin Evropian të Llogarive 2010 (ESA 2010). Duke marrë parasysh aspekte të ndryshme, si regjistrimi i bizneseve të reja, validiteti i shërbimeve, etj., si dhe mungesa e zërthimit të thukët të këtyre të hyrave, është vështirë të vendoset si tregues. Mirëpo, ulja e buxhetit, si pasojë e eliminimit apo zvogëlimit të lartësisë së pagesave për marrjen e shërbimeve, do të kalkulohet në momentin e matjes së kursimeve pas zvogëlimit të barrës administrative, siç paraqitet në Treguesin 1 të Qëllimit të përgjithshëm në Plan të Veprimit (për më tepër shih Shtojcën 5 – Pasaporta e Treguesve).

diskutimeve në Komisionin për Planifikim Strategjik, do të mund të alokoheshin për thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve administrative.

7.5. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Monitorimi i zbatimit të Programit do të bëhet në disa mënyra, sipas hierarkisë apo përgjegjësisë institucionale. **ZPS do të jetë organi përgjegjës për monitorimin e Programit në tërësi, duke përgatitur raporte sipas afatit ligjor dhe sipas kërkesës.**

Trupa qeveritare për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative do të diskutojë nivelin e zbatimit të Programit **në periudha gjashtëmuajore**, të cilat do t'i paraqes në ZPS si dëshmi që shërbejnë për përgatitjen e raporteve. Ky monitorim do të përqendrohet në (1) zbatimin e veprimeve e nevojshme të parapara në planin e veprimit, si krijimi i grupeve punuese, zbatimi i rekomandimeve të theksuara në këtë kapitull, si dhe aspekte tjera teknike që kanë efekt në mbarëvajtjen e Programit, si dhe (2) në arritjen e rezultateve të reduktimit të barrës administrative.

ZPS me anë të raporteve gjashtëmuajore mujore nga trupa qeveritare, do të përgatis raportet gjashtëmuajore dhe raportin njëvjeçar. **Raporti vjetor do të prezantohet dhe miratohet në KPS.** Të gjitha aspektet e Programit, përfshirë barra administrative e zvogëluar, rezultatet e anketave vendore, indekseve ndërkombëtare apo raportet e institucioneve kredibile, që ndërlidhen me barrë administrative, do të paraqiten në raport. Për këtë, ZPS do të shfrytëzojë periudhën e raportimit për planifikimin operacional të punës së Qeverisë, në rast se veprimet e Programit janë pjesë e saj, **në mënyrë që të mos dyfishohet raportimi i zyrtarëve dhe në mënyrë që të dhënat të mos jenë në kundërshtim me njëra tjetrën.**

Në pajtim me qasjen sistemore të Programit, raporti po ashtu do të përmbajë rezultate tjera të integruara nëpër **dokumente tjera strategjike**, rezultate këto të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, ndikojnë në zvogëlimin e barrës administrative. Për këtë qëllim, raporti vjetor do të përmbajë rezultatet e zvogëlimit të barrës administrative, sikurse përqindja e thjeshtimit të barrës, kursimeve, kohës dhe ngecjet, sfidat, problemet e rekomandimet, të cilat do të merren parasysh nga institucionet, grupet punuese dhe trupa qeveritare.

Po ashtu, për aq sa është e mundur, ZPS do të përfshijë në raport edhe veprimet dhe rezultatet e parandalimit të barrës administrative. Ngecjet, sfidat dhe problemet e identifikuar **do të prezantohen në KPS, në mënyrë që Kryeministri, Zëvendëskryeministri i parë dhe ministrat të informohen me procesin, mbarëvajtjen dhe të shtyjnë para veprime të nevojshme për zbatimin e Programit.**

Vlerësimi dhe ndryshimi (nëse ka nevojë) i Programit, do të bëhet pas përfundimit të afatit të Planit të veprimit, pas shqyrtimit në KPS, ndërsa vlerësimi dhe ndryshimi i Planit të veprimit do të bëhet çdo tremujor të fundit të vitit të dytë. Detajet dhe udhëzimet e

nevojshme për monitorim dhe raportim të zbatimit të Programit, do të ofrohen me anë të **udhëzuesit të përgjithshëm për barrë administrative**, të zhvilluar nga ZPS.

PLANI I VEPRIMIT 2022-2024

Nr.	Qëllimi i përgjithshëm	Vlera bazë 2022	Synimi 2023	Synimi 2024	Rezultati				
Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative									
1	Treguesi: <i>Kursimet kumulative të qytetarëve dhe bizneseve pas zvogëlimit të barrës administrative</i>	0	>1 mil. €	>6 mil. €	Kursimet e qytetarëve dhe bizneseve janë rritur si pasojë e zvogëlimit të barrës administrative, kursime të cilat mund të orientohen në fusha të tjera të ekonomisë.				
2	Treguesi: <i>Licencat dhe lejet për biznese</i>	2.7	3	>3	Barra administrative për marrjen e një licence nga ana e biznesit, është më e ulët.				
Nr.	Masat, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë 2022	Synimi 2023	Synimi 2024	Rezultati				
1	Thjeshtimi dhe digjitalizimi i shërbimeve administrative në nivel qendror								
1	Treguesi: <i>Numri i shërbimeve administrative, të thjeshtuara</i>	44	>150	>250	Shërbimet administrative të nivelit qendror, të thjeshtuara që konsumojnë më pak shpenzime dhe kohë.				
2	Treguesi: <i>Numri i shërbimeve administrative, të digjitalizuara</i>	0	>50	>150	Aplikimi për shërbimeve në mënyrë digjitale, nëpërmjet platformës E-Kosova, është më cilësor dhe më i qasshëm.				
3	Treguesi <i>Skemat sociale në MFPT, të digjitalizuara</i>	2	12	28	Skemat sociale në MFPT të digjitalizuara dhe të shfaqura në E-Kosova.				
4	Treguesi <i>Përqindja e bizneseve që përdorin faturën elektronike në raport me bizneset që e kanë obligim ligjor</i>	0	30%	90%	Lehtësimi i të bërit biznes nëpërmjet përfshirjes së bizneseve në lëshimin e faturave elektronike.				
5	Treguesi <i>Numri i bizneseve të fiskalizuara nëpërmjet platformës softwerike për menaxhim të parasë së gatshme</i>	0	>8000	>15000	Ngritja e të hyrave dhe efikasiteti në deklarimin e tatimeve, si dhe ulja e barrës administrative për biznese nëpërmjet eliminimit gradual të arkave fiskale.				
6	Treguesi <i>Numri i shërbimeve administrative të ATK të integruara në E-Kosova</i>	0	5	15	Platforma E-Kosova e pasuruar me shërbimet administrative të ATK, duke ndjekur parimin 'një kyçje e vetme'.				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti	Referenca në dokumente
			Viti 1	Viti 2	Viti 3				

1.1	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve administrative të MBPZHR ¹⁷	TM4 2023	16,168	24,672	/	BRK, Financim nga donatorët	ZL/MBPZHR	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas analizës së miratuar nga QRK, në shtojcën 1.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; Koncepti dokumenti për zvogëlimin e barrës administrative; dhe Agjenda e Reforma Evropiane – ERA II
1.2	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve administrative të MMPHI	TM4 2023	16,168	24,672	/	BRK, Financim nga donatorët	ZL/MMPHI	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas analizave të miratuara nga QRK, në shtojcën 1 dhe shtojcën 2 ¹⁸ .	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; Koncepti dokumenti për zvogëlimin e barrës administrative; dhe Analiza e miratuar në QRK me vendimin nr. 03/50 të datës 23.12.2021.
1.3	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve administrative të MSH	TM4 2023	16,168	24,672	/	BRK, Financim nga donatorët	ZL/MSH	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas analizës së miratuar në QRK, në shtojcën 2.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Analiza e miratuar në QRK me vendimin nr. 03/50 të datës 23.12.2021.
1.4	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve administrative të MPB	TM4 2023	16,168	24,672	/	BRK, Financim nga donatorët	ZL/MPB	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas analizës në shtojcën 2.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Analiza e miratuar në QRK me vendimin nr. 03/50 të datës 23.12.2021.
1.5	Kryerja e analizës për thjeshtimin e shërbimeve administrative të MASHTI, MD, MFPT, MKRS dhe ME	TM4 2022	23,084	/	/	BRK, Financim nga donatorët	ZL/ministrit ë e linjës	Analiza me rekomandime për thjeshtimin të shërbimeve administrative të MASHTI, MD, MFPT,	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].

¹⁷ Për shkak të zbatimit me vonesë dhe zbatimit jo të duhur të reformave, si dhe pas diktimit me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, është vendosur që Zyra Ligjore, me mbështetjen e Korporatës Ndërkombëtare Financiare - IFC, të hartojë të gjitha aktet juridike sipas analizave dhe të dërgojë te ministritë si finale, në mënyrë që ato të kryejnë konsultimin dhe miratimi e të njëjtave. Ky koment është i vlefshëm për të gjitha veprimet, nga 1.1 deri në 1.8.

¹⁸ Shtojca 2 është miratuar në Mbledhjen e 50-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/50 të datës 23.12.2021.

								MKRS dhe ME, e miratuar nga Qeveria. ¹⁹	
1.6	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve administrative të MASHTI, MD, MFPT, MKRS dhe ME	TM2 2024	30,794	43,176	21,558	BRK, Financim nga donatorët	ZL/Ministrit ë e linjës	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas analizës së miratuar nga Qeveri me rekomandime për thjeshtimin e PA të MASHTI, MD, MFPT, MKRS dhe ME.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
1.7	Kryerja e analizës për thjeshtimin e shërbimeve administrative në ZRRE, KPM, KPMM, ARKEP, BQK, ARSHU dhe AAC	TM2 2023	53,878	62,756	/	BRK, Financim nga donatorët	ZL/Agjencit ë rregullatore	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas analizës së miratuar në QRK për PA të ZRRE, KPM, KPMM, ARKEP, BQK, ARSHU dhe AAC.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
1.8	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative të ZRRE, KPM, KPMM, ARKEP, BQK, ARSHU dhe ACC	TM4 2024	13,878	95,512	95,512	BRK, Financim nga donatorët	ZL/Agjencit ë rregullatore	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas analizës së miratuar në QRK me rekomandime për thjeshtimin e PA në ZRRE, KPM, KPMM, ARKEP, BQK, ARSHU dhe AAC.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.9	Përditësimi i Regjistrit Qendror për Sistemin e Lejeve dhe Licencave me ndryshimet e reja	TM3 2023	/	4,626	/	BRK	ZL	RQSSL i përditësuar.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.10	Analiza për digjitalizimin e lejimeve në nivel qendror	TM4 2022	149,252	/	/	BRK, Financim nga donatorët	ASHI	Analiza për digjitalizimin e lejimeve, e përfunduar.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
1.11	Digjitalizimi i shërbimeve administrative sipas analizës për digjitalizim (1.10)	Në vazhdimës i	0	1,500,000	3,000,000	BRK, Financim nga donatorët	ASHI/ML	Digjitalizimi i shërbimeve administrative dhe të vendosura në E-Kosova.a	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.12	Digjitalizimi i procedurave për	TM4 2023	/	330,000	/	BRK Financim	MBPZHR/A SHI	Procedurat për subvencione në	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4

¹⁹ Analiza përfundimtare do të miratohet në Qeveri, si Shtojcë e Programit për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative.

	subvencione në MBPZHR					nga donatorët		MBPZHR, të digjitalizuara dhe të vendosura në E-Kosova.	Qeverisja]
1.13	Digjitalizimi i shërbimeve të skemave sociale në MFPT	TM2 2024	/	500,000	500,000	BRK, Financim nga donatorët	MFPT/ASHI	Procedurat për skema sociale në MFPT, të digjitalizuara dhe të vendosura në E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.14	Digjitalizimi i shërbimeve të Agjencisë së Punësimit	TM4 2023	/	500,000	/	BRK, Financim nga donatorët	MFPT/ASHI	Digjitalizimi i shërbimeve administrative dhe të vendosura në E-Kosova	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.15	Digjitalizimi i shërbimeve administrative të Administratës Tatimore të Kosovës	TM2 2024	/	1,500,000	1,500,000	BRK, Financim nga donatorët	MFPT/ASHI	Digjitalizimi i shërbimeve administrative dhe të vendosura në E-Kosova	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.16	Digjitalizimi i shërbimeve administrative të Doganës së Kosovës	TM2 2024	/	1,000,000	500,000	BRK, Financim nga donatorët	MFPT/ASHI	Digjitalizimi i shërbimeve administrative dhe të vendosura në E-Kosova	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.17	Digjitalizimi i shërbimeve administrative të Thesarit të Kosovës	TM3 2024	/	/	500,000	BRK, Financim nga donatorët	MFPT/ASHI	Digjitalizimi i shërbimeve administrative dhe të vendosura në E-Kosova	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
1.18	Analiza për zhvillimin e pasaportës së biznesit	TM2 2023	/	4,626	/	BRK	MINT/ZPS	Analiza për zhvillimin e pasaportës së biznesit e kryer.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
	Buxheti i përgjithshëm për Masën 1:		335,558	5,639,384	6,117,100				
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>								
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>								
2	Thjeshtimi i shërbimeve administrative të përzgjedhura duke u bazuar në ngjarje reale								
1	Treguesi: <i>Ulja e kohës së kërkuar për kompletimin e procedurës së aplikimit për shërbimet e përzgjedhura veç-e-veç</i>	Përcaktohet gjendja aktuale [2022]	20%	40%	Shërbimet publike administrative të përzgjedhura marrin kohën më pak dhe kryhen më shpejtë.				
Nr.	Veprimi	Afati i	Buxheti		Burimi i	Institucioni	Produkti	Referenca në	

		fundit	Viti 1	Viti 2	Viti 3	financimit	udhëheqës dhe mbështetës		dokumente
2.1	Themelimi i grupit punues për përgatitjen e akteve juridike dhe sigurimin e zbatimit të rekomandimeve për shërbimet administrative të përzgjedhura	TM3 2022	15,420	/	/	BRK	ZPS/ministri të e linjës	Grupi punues i themeluar, me vendim të Qeverisë.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.2	Zbatimi i rekomandimit për thjeshtimin e regjistrimit për herë të parë (R), vazhdimin e regjistrimit (V) dhe ndërrimin e pronësisë (P), të veturave	TM2 2023	15,420	15,420	/	BRK	MPB	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas rekomandimeve të analizës në shtojcën 3.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.3	Digjitalizimi i shërbimeve administrative për regjistrimin për herë të parë dhe ndërrimin e pronësisë të veturave	TM4 2023	/	90,840	/	BRK, Financim i donatorëve	MPB/ASHI	Shërbimet administrative të digjitalizuara dhe të qasshme në platformën E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.4	Zbatimi i rekomandimit për thejshimin e shërbimeve administrative për lejen ndërtimore – Kategoria I dhe II	TM2 2023	15,420	15,420	/	BRK	MMPHI	Shërbimet administrative të thjeshtuara sipas rekomandimeve të analizës në shtojcën 3.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.5	Digjitalizimi i shërbimeve administrative për lejen ndërtimore – Kategoria I (K1) dhe Kategoria II (K2) ²⁰	TM2 2024	/	130,840	/	BRK, Financim nga donatorët	MMPHI/Ko munat/ASHI	Shërbimet administrative të digjitalizuara dhe të qasshme në platformën E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.6	Zbatimi i rekomandimit për thjeshtimin e shërbimit administrativ për marrjen e Certifikatës për të kaluarën kriminale	TM2 2023	3,084	3,084	/	BRK	KGJK	Shërbimi administrativ i thjeshtuar sipas rekomandimeve të analizës në shtojcën 3.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]

²⁰ Ky shërbim është mjaft kompleks dhe është i ndërlidhur ngushtë me komunat, pasi që në komuna aplikohet për leje ndërtimore. Prandaj, digjitalizimit të këtij shërbimit të përzgjedhur mund t'i paraprijë një analizë e detajshme, si dhe mund të bëhet në një apo disa komuna, si pilotim.

2.7	Digjitalizimi i plotë i shërbimit administrativ për marrjen e Certifikatës për të kaluarën kriminale ²¹	TM2 2023	/	43,878	/	BRK, Financim nga donatorët	KGJK/ASHI	Shërbimi administrativ e digjitalizuar dhe e qasshme në platformën E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.8	Zbatimi i rekomandimit për thjeshtimin e shërbimeve administrative për njohjen e diplomave bachelor (B), master (M) dhe doktoratë (D)	TM1 2023	7,710	7,710	/	BRK	MASHT	Shërbimet administrative i thjeshtuar sipas rekomandimeve të analizës në shtojcën 3.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.9	Digjitalizimi i plotë i shërbimeve administrative për njohjen e diplomave bachelor, master dhe doktoratë	TM4 2023	/	120,840	/	BRK, Financim nga donatorët	MASHTI/ASHI	Shërbimi administrativ i digjitalizuar dhe e qasshme në platformën E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.10	Zbatimi i rekomandimit për thjeshtimin e shërbimit administrativ për pajisje me letërnjoftim për persona nga 16-18 vjeç dhe ata mbi 18 vjeç	TM1 2023	7,710	7,710	/	BRK	MPB/ARC	Shërbimi administrativ e thjeshtuar sipas rekomandimeve të analizës në shtojcën 3.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.11	Digjitalizimi i shërbimit administrativ për pajisje me letërnjoftim për persona nga 16-18 vjeç dhe ata mbi 18 vjeç	TM4 2023	/	90,840	/	BRK, Financim nga donatorët	ARC/ASHI	Shërbimi administrativ e digjitalizuar dhe e qasshme në platformën E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.12	Zbatimi i rekomandimit për thjeshtimit të shërbimit administrativ për marrjen e Certifikatën e Residencës Tatimore për qytetarë dhe biznese	TM1 2023	7,710	7,710	/	BRK	MFPT/ATK	Shërbimi administrativ i thjeshtuar sipas rekomandimeve të analizës në shtojcën 3.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.13	Digjitalizimi i shërbimit administrativ për marrjen e Certifikatës së Residencës Tatimore për qytetarë dhe biznese	TM4 2023	/	60,840	/	BRK, Financim nga donatorët	ATK/ASHI	Shërbimi administrativ i digjitalizuar dhe e qasshme në platformën E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.14	Zbatimi i rekomandimit për thjeshtimin e shërbimit administrativ për aplikim për vulë apostile	TM2 2023	7,710	7,710	/	BRK	MPJD/ZPS	Shërbimi administrativ i thjeshtuar sipas rekomandimeve të analizës në shtojcën 3.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]

²¹ Ky veprim i takon Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që nënkupton se nuk i përket intervenimit të ekzekutiv (Qeverisë). Mirëpo, grupi punues për hartimin e Programit ka pasur takim me KGJK dhe janë pajtuar që ky veprimet të mbetet në PV dhe në rast nevojë, të mbështetet KGJK nga donatorët për arritjen e plotë të këtij veprimi. Duhet theksuar se KGJK veçse ka filluar procedurat e para për digjitalizimin e plotë të Certifikatës.

2.15	Digjitalizimi i shërbimit administrativ për aplikimin për vulë apostile	TM4 2023	/	130,840	/	BRK, Financim nga donatorët	MPJD/ASHI	Shërbimi administrativ i digjitalizuar dhe i qasshëm në E-Kosova.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.16	Matja e rezultateve pas thjeshtimit për vlerësimin e arritjes së synimit	TM3 2023	/	6,168	/	BRK	ZPS	Rezultatet e matura dhe të vendosura në raport vjetor për barrë administrative.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.17	Nxjerrja e mësimave nga thjeshtimi dhe digjitalizimi i shërbimeve administrative të përzgjedhura dhe përditësimi i moduleve dhe trajnimeve më këto mësim	Në vazhdimësi	6,168	6,168		BRK	ZPS	Mësimet e njerra dhe të përgatitura për nevoja të grupeve punuese	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
2.18	Përgatitja e planit dhe analizës për shërbimet tjera administrative të përzgjedhura	TM1 2023	/	6,168	/	BRK	ZPS	Plani dhe analiza të përgatitur dhe i miratuar në Qeveri, si shtojcë e këtij Programi.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
	Buxheti i përgjithshëm për Masën 2:		86,352	744,476	6,168				
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>								
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>								
3	Rritja e koordinimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative								
1	Treguesi: <i>Niveli i zyrtarëve publikë të trajnuar për barrë administrative</i>	0 [2022]	>200	>400				Zyrtarët publikë përkatës të ZKM, ministrive të linjës, agjencive ekzekutive relevante dhe komunave, të aftësuar për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative.	
2	Treguesi: <i>Të gjitha ministratë e linjës, agjencitë ekzekutive relevante dhe komunat, e kanë caktuar personin përgjegjës për barrë administrative</i>	JO [TM2 2022]	PO [TM3, 2022]	N/A				Të gjitha institucionet relevante kanë caktuar personat përgjegjës për barrë administrative, të cilët kontribuojnë dhe sigurojnë mbarëvajtjen e procesit të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative.	
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			Viti 1	Viti 2	Viti 3				
3.1	Caktimi i personit përgjegjës në	TM3 2022	3,084	/	/	BRK	Ministratë e linjës dhe	Zyrtarët përgjegjës, të caktuar me Vendim të	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4

	ministri të linjës dhe një personi përgjegjës nëpër agjencitë ekzekutive vartëse relevante, për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative						agjencitë ekzekutive relevante.	Sekretarëve të Përgjithshëm.	Qeverisja]
3.2	Caktimi i personave përgjegjës për barrë administrative nëpër Komuna	TM3 2022	3,084	/	/	BRK	Komunat/ MAPL	Zyrtarët përgjegjës për BA nëpër komuna, të caktuar me vendim të Kryetarit.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
3.3	Themelimi i Këshillit ndër-ministror për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative	TM3 2022	3,084	/	/	BRK	QRK	Trupa qeveritare e themeluar, me Vendim të Qeverisë.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
3.4	Zhvillimi i kalendarit të takimeve të trupit qeveritar	TM3 2022	3,084	/	/	BRK	Këshilli ndër-ministror për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative	Kalendari i takimeve të trupit qeveritar, i miratuar nga trupa qeveritare.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
3.5	Organizimi i takimeve të trupit qeveritar, sipas kalendarit të takimeve	Në vazhdimësi	2,056	6,168	6,168	BRK	Këshilli ndër-ministror për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative	6 takime për vit, të mbajtura të trupit qeveritar, sipas kalendarit të takimeve.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
3.6	Organizimi i takimit vjetor me komisionet parlamentare përkatëse për diskutim rreth barrës administrative	Në vazhdimësi	1,028	2,056	2,056	BRK	ZPS	Takimi vjetor me komisionet parlamentare përkatëse, i mbajtur.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
3.7	Zhvillimi i modulit të trajnimit për barrën administrative (përfshirë planin dhe metodën e testimit)	TM4 2022	27,710	/	/	BRK, Financim i donatorëve	ZPS/IKAP	Moduli i zhvilluar dhe i gatshëm për përdorim.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
3.8	Zhvillimi i praktikumit për barrë	TM4 2022	12,710	/	/	BRK	ZPS/ZL	Praktikumi i zhvilluar dhe i shpërndarë tek zyrtarët gjatë trajnimit, si	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]

	administrative							dhe te grupet punuese për hartim të legjislacionit.	
3.9	Përditësimi i udhëzuesit për koncept dokumente	TM4 2022	8,084	/	/	BRK, Financim i donatorëve	ZPS	Udhëzuesi për koncept dokumente, i miratuar në Qeveri.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
3.10	Përditësimi i udhëzuesit për modelin e kostimit standard dhe skedarit excel, sipas qasjes së Programit	TM4 2022	12,710	/	/	BRK, Financim i donatorëve	ZPS	Udhëzuesi për modelin e kostimit standard dhe skedarit excel, i miratuar në Qeveri.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
3.11	Zhvillimi i skedarit elektronik të modelit të kostimit standard	TM2 2023	12,710	/	/	BRK, Financim i donatorëve	ZPS	Skedari elektronik i MKS, i zhvilluar dhe i gatshëm për përdorim.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
3.12	Hartimi i manualit për memorandume shpjeguese	TM4 2022	8,668	/	/	BRK, Financim i donatorëve	ZPS/ZL	Manuali për memorandume shpjeguese, i miratuar në Qeveri.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
3.13	Trajnimi i zyrtarëve përgjegjës për barrë administrative me modulën e trajnimit për barrë administrative	TM1 2023	/	9,168	/	BRK, Financim i donatorëve	IKAP	Zyrtarët përgjegjës për barrë administrative të trajnuar.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
3.14	Trajnimi i zyrtarëve të përzgjedhur të ministrive të linjës dhe agjencive ekzekutive, sipas planit të trajnimit për barrë administrative	TM4 2024	/	34,672	39,672	BRK, Financim i donatorëve	IKAP	20 trajnime për barrë administrative. 10 për vit, të mbajtura.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]; dhe Programi për Reforma Ekonomia 2022 – 2024 [Masa e reformës 9].
3.15	Mbajtja e Kampeve Digjitale për shërbyes civilë (punëtori të përshtatura për ngritjen e bashkëpunimit dhe vetëdijës për digjitalizimin e shërbimeve dhe efekteve të saj)	Në vazhdimësi	/	20,140	20,140	BRK, Financim nga donatorët	ZPS, ASHI, ML	Së paku 1 Kamp Digjital i mbajtur për vit.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja];
3.16	Zhvillimi i e-trajnimit për barrë	TM3 2023	/	42,336	/	BRK, Financim i	ZPS/IKAP	E-trajnimi për barrë administrative i zhvilluar	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4

	administrative					donatorëve		dhe i qasshëm në uebfaqen e ZKM dhe platformën E-Kosova.	Qeverisja]
3.17	Hartimi i planit dhe analizës për zbatimin e metodës ‘një brenda, një jashtë’.	TM1 2023	6,168	6,168	/	BRK	ZPS	Plani i përfunduar.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
	Buxheti i përgjithshëm për Masën 3:		107,264	120,708	68,036				
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>								
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>								
4	Thjeshtimi i shërbimeve administrative në nivelin lokal²²								
1	Treguesi: <i>Numri i komunave shërbimet e të cilave janë thjeshtuar</i>	2 [2022]	5	9	Shërbimet administrative publike në nivelin lokal të thjeshtuara, që konsumojnë më pak shpenzime dhe kohë.				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			Viti 1	Viti 2	Viti 3				
4.1	Kryerja e analizës për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative në komunën e Ferizajit dhe komunën e Pejës	TM4 2022	32,336	/	/	BRK, Financim nga donatorët	MAPL/ZPS	Analiza me rekomandime për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative për komunën e Ferizajit dhe komunën e Pejës, e përfunduar.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
4.2	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative në komunën e Ferizajit dhe Pejës	TM4 2023	/	57,008	/	BRK, Financim nga donatorët	Komuna/M APL	Shërbimet publike administrative të thjeshtuara sipas analizës për komunën e Ferizajit dhe komunën e Pejës.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]

²² Kjo masë koncentrohet në dy aspekte: rishikimin dhe thjeshtimin e legjislacionit qëndror që shkakton barrë administrative në procedurat e nivelit lokal, si dhe ofrimin shërbimeve administrative nga komuna, me anë të legjislacionit komunal. Kursimet për qytetarë dhe biznese nga thjeshtimi i tyre, hyjnë në matjen kumulative të kursimeve në treguesin 1 të qëllimit të përgjithshëm. Siç është theksuar në pjesën narrative, pagesat apo tarifët për shërbimet administrative të deleguara nga niveli qendror, komunat e kanë kompetencën e përcaktimit të tyre. Prandaj, zvogëlimi i barrës administrative në shërbimet e ofruara nga komunat nënkupton, mes tjerash, zvogëlimi i barrës administrative që shkaktohet nga legjislacioni i nivelit qendror. Në të shumtën e rasteve, këto shërbime janë të njëjta nëpër të gjitha komunat, por për shkak të tarifave të ndryshme dhe zbatimit të ulët të reformave, me komunat do të punohet një nga një, përveç rasteve kur një shërbim komunal digjitalizohet dhe ofrohet për të gjithë në një qendër të vetme, si digjitalizimi i certifikatave të regjistrimit civil.

4.3	Krijimi i Regjistrit Elektronik informativ për shërbimet publike administrative në komunën e Ferizajit dhe komunën e Pejës	TM2 2023	/	48,504	/	BRK, Financim nga donatorët	Komuna/M APL	Regjistri Elektronik i krijuar dhe i qasshëm në portalin e komunës së Ferizajit dhe Komunës së Pejës.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
4.4	Kryerja e analizës për thjeshtimin e shërbimeve administrative në pesë (5) komunat tjera të përzgjedhura ²³	TM4 2023	/	224,016	/	BRK, Financim nga donatorët	MAPL/ZPS	Analiza me rekomandime për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative për pesë (5) komuna të përzgjedhura, të përfunduara.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
4.5	Zbatimi i rekomandimeve për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative në pesë (5) komunat të përzgjedhura.	TM4 2024	/	68,504	124,016	BRK, Financim nga donatorët	Komunat/M APL	Shërbimet publike administrative të thjeshtuara sipas analizës për pesë (5) komunat e përzgjedhura.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
4.6	Krijimi i Regjistrave Elektronike informativ për procedura administrative në pesë (5) komunat tjera të përzgjedhura	TM2 2024	/	74,672	68,504	BRK, Financim nga donatorët	Komuna/M APL	Regjistrat Elektronik të krijuar dhe të qasshëm në portalet e pesë (5) komunave të përzgjedhura.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
4.7	Kryerja e planit për zgjerimin e thjeshtimit administrativ në të gjitha komunat	TM2 2023	/	18,504	224,016	BRK	ZPS/MAPL	Plani i hartuar.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
4.8	Zhvillimi i rubrikës E-Komunat brenda platformës E-Kosova ²⁴	TM2 2023	/	30,000	/	BRK	MAPL/ASH I	Rubrika E-Komunat brenda platformës E-Kosova, e përfunduar dhe funksionale.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
	Buxheti i përgjithshëm për Masën 4:		32,336	521,208	416,536				
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>								
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>								

²³ Komunat do të përzgjidhen gjatë procesit duke u bazuar në potencialin ekonomik.

²⁴ Faza e parë e rubrikës E-Komunat brenda platformës E-Kosova parasheh bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve dhe komunës për politikat publike komunale dhe komunikimin efikas për kërkesat, sfisat dhe problemet e tyre. Digjitalizimi i shërbimeve që ofrohen nga komunat, që është faza e dytë e projektit për E-Komunat, do të planifikohet në plotësimin dhe ndryshimin e parë të Planit të Veprimit të Programit, bashkë me veprimet dhe treguesit përkatës.

5 Rritja e komunikimit dhe ngritja e vetëdijes për barrë administrative ²⁵									
1	Treguesi: % e të anketuarëve nga qytetarët dhe bizneset që kanë njohuri dhe janë të kënaqur me mbarëvajtjen e procesit të zvogëlimit të barrës administrative	Përcaktohet vlera bazë [2022]	>30%	>50%	Qytetarët dhe bizneset janë të njoftuar dhe të kënaqur me punën e Qeverisë, mbi zvogëlimin e barrës administrative.				
2	Treguesi: % e të anketuarëve në administratën publike që kanë njohuri për barrën administrative dhe efektet e saj	Përcaktohet vlera bazë [2022]	>30%	>50%	Administrata publike e njoftuar dhe e përfshirë në procesin e barrës administrative dhe efektet e saj.				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			Viti 1	Viti 2	Viti 3				
5.1	Përgatitja e Kalendarit të takimeve për konsultim dhe komunikim të procesit të barrës administrative	TM4 2022	4,112	/	/	BRK	ZPS	Kalendari i përgatitur dhe miratuar në KPS.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
5.2	Organizimi i takimeve të Komisionit për Planifikim Strategjik	Në vazhdimësi	1,028	2,056	2,056	BRK	ZVKM/ZPS	2 takime për vit, të mbajtura me KPS.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
5.3	Organizimi i takimeve të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime	Në vazhdimësi	1,028	2,056	2,056	BRK	ZVKM/ZPS	2 takime për vit, të mbajtura me KKEI.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
5.4	Organizimi i konferencës rajonale vjetore për barrë administrative	TM4 të secilit vit.	31,028	31,028	31,028	BRK, Financim nga donatorët	ZVKM/ZPS	1 konferencë rajonale vjetore, e mbajtur.	Programi i Qeverisë 2021-2025 [2.4 Qeverisja]
				<p>certifikaten e numrit fiscal; (ii) Kompetenca profesionale CPC posedon kapacitete profesionale të trajnuar dhe çertifikuar.</p> <p>2. Licenca B aplikohet kur kompania dëshiron që të ofroj shërbimet jo vetëm për sezon por në formë të rregullt dhe të vazhdueshme.</p> <p>3. Neni 8 i Udhëzimit Administrativ Nr.07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus parasheh pagesën prej 50 euro me rastin e aplikimit për secilën prej licencave.</p> <p>4. Udhëzim administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus parasheh që me rastin e licencimit, aplikuesi duhet të dorëzoj dëshminë e Kompetencës profesionale CPC që posedon kapacitete profesionale të trajnuar dhe certifikuar.</p> <p>5. Me rastin e aplikimit për këtë licencën A, aplikuesi</p>	<p>2. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus ashtuqë të parashihet marrja e lejes në vend të licencës, dhe të bashkohet Licenca A dhe Licenca B, ashtu që të kërkohet vetëm marrja e një Lejes për ofrimin e këtyre shërbimeve. Përgjithshëm përmbën situata kur ka marrëveshja bilaterale mes shteteve.</p> <p>3. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, më saktësisht paragrafi 1.1 i nenit 8 ashtu që të hiqet obligimi që aplikuesi të paguaj shumën prej 50 euro me rastin e aplikimit.</p> <p>4. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, ashtuqë të hiqet obligimi që aplikuesi duhet të dorëzoj dëshminë e Kompetencës profesionale CPC që posedon</p>	<p>licencave bëhet për qëllimin se të njejtat ofrojnë shërbimin e njëjtë por në kohë të ndryshme. Për më tepër ky propozim ka ardhur nga ana e zyrtarëve.</p> <p>2. Heqja e pagesës me rastin e aplikimit bëhet në përputhje me nenin 18 të Ligjit 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.</p> <p>3. Heqja e kërkesës së dorëzimit të dokumenteve të noterizuara me rastin e aplikimit si: Kompetencës profesionale CPC posedon kapacitete profesionale të trajnuar dhe çertifikuar bëhet sepse të njejtat janë dokumente lëshimin e të cilave e bën vetë Ministria.</p> <p>4. Të njejtat janë dokumente që Ministria duhet t'i sigurojë vetë përmes një databaze.</p> <p>4. Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këto licenca nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të</p>
--	--	--	--	--	--	--

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

					paguan shumën prej 300 euro, dhe me rastin e aplikimit për licencën B, aplikuesi paguan shumën prej 500 euro.	kapacitete profesionale të trajnuar dhe certifikuar. 5. T'i propozohet Ministrisë që kostoja prej 300 euro dhe 500 euro që paguhet për marrjen e këtyre licencave të kalkulohet në kuadër të kostos së marrjes së të njejtës, ashtu që e njëjta të jetë në perputhje me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti.	administruar atë (neni 18 I Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim I tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma prej 300 dhe 500 euro reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë procesit të lejimit.
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	DTT13	1. Licenca C – nënkupton ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor vendor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus 2. Licenca D – transporti rrugor vendor dhe ndërkombëtar të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus	Leje	Ministria e Infrastrukturës, Departamenti i Transportit Tokesor	1. Ligji nr.04/I-179 për transportin rrugor, në nenin 7 parasheh licencën si domosdoshmëri për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve. 2. Licenca C aplikohet kur kompania dëshiron të ofrojë transportin rrugor vendor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus dhe Licenca D aplikohet kur kompania ofron transport rrugor vendor dhe ndërkombëtar të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus. 3. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e	1. Të ndryshohet Ligji nr.04/I-179 për transportin rrugor, në nenin 7 I cili parasheh licencën si domosdoshmëri për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve, ashtuqë të parashihet nevoja për marrjen e lejes dhe jo licencës. Përgjithshëm përbën situata kur ka marrëveshja bilaterale mes shteteve. 2. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, më saktësisht paragrafi 1.1 i nenit 8 ashtuqë të hiqet obligimi që aplikuesi të paguaj shumën	1. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, licenca profesionale ju lëshohet personave fizik, ndërsa leja ju lëshohet personave juridik si në rastin konkret. Andaj ndryshimi i propozuar bazohet në nenin 8 dhe 9 të këtij ligji. Bashkimi i dy licencave bëhet për qëllimin se të njejtat ofrojnë shërbimin e njëjtë. Për më tepër ky propozim ka ardhur nga ana e zyrtarëve. 2. Heqja e pagesës me rastin e aplikimit bëhet në përputhje me nenin 18 të Ligjit 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

				<p>operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, në paragrafin 1.1 të nenit 8, obligon aplikuesin të paguaj shumën prej 50 euro me rastin e aplikimit.</p> <p>3. Udhëzim administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus parasheh që me rastin e licencimit, aplikuesi duhet të dorëzoj dëshminë e Kompetencës profesionale CPC posedon kapacitete profesionale të trajnuar dhe certifikuar për të dy licencat.</p> <p>4. Me rastin e aplikimit Licencën C, aplikuesi paguan shumën prej 200 euro, ndërsa me rastin e aplikimit për Licencën D, aplikuesi paguan shumën prej 1000 euro.</p>	<p>prej 50 euro me rastin e aplikimit, dhe të bashkohet Licenca C dhe Licenca D, ashtu që të kërkohet vetëm marrja e një Lejes për ofrimin e këtyre shërbimeve.</p> <p>3. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus ashtuqë të hiqet obligimi që aplikuesi duhet të dorëzoj dëshminë e Kompetencës profesionale CPC posedon kapacitete profesionale të trajnuar dhe certifikuar.</p> <p>4. T'i propozohet Ministrisë që kostoja prej 200 dhe 1000 euro që paguhet për marrjen e kësaj licence të kalkulohet në kuadër të koston së marrjes së të njejtës, ashtu që e njejtë të jetë në perputhje me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti</p>	<p>3. Heqja e kërkesës së dorzëimit të dokumenteve të noterizuara me rastin e aplikimit si: Kompetencës profesionale CPC posedon kapacitete profesionale të trajnuar dhe certifikuar bëhet sepse të njejtat janë dokumente lëshimin e të cilave e bën vetë Ministria. Të njejtat janë dokumente që Ministria duhet t'i sigurojë vetë përmes një database.</p> <p>4. Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë licencë nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar atë (neni 18 i Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim i tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma prej 200 dhe 1000 euro reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë procesit të lejimit.</p>
--	--	--	--	---	--	--

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

<p>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</p>	<p>DTT14</p>	<p>Licencë sipas kategorive A,B,C dhe D për stacione të autobusëve</p>	<p>Leje</p>	<p>Ministria e Infrastrukturës, Departamenti i Transportit Tokesor</p>	<p>1. Ligji Nr. 04/l-179 për transportin rrugor, në nenin 37 parasheh licencën sipas kategorive A, B, C dhe D për stacione të autobusëve.</p> <p>2. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2013 për licencimin e stacioneve të autobusëve në nenin 6 parasheh që licenca për stacion të autobusëve lëshohet në bazë të kategorive dhe jo një licencë e përgjithshme dhe e njëjta ka validitet pesë (5) vjeçar. 2. U.A. Nr. 08/2013, në nenin 5, parasheh obligimin e pagimit të shumës prej 100 euro me rastin e aplikimit.</p> <p>3. Me rastin e aplikimit për këtë licencë, aplikuesi paguan shumën prej 500 deri 3,000 euro.</p>	<p>1. Të ndryshohet Ligji Nr.04/l-179 për transportin rrugor, në nenin 37, i cili parasheh licencën si domosdoshmëri për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve, ashtu që të parashihet nevoja për marrjen e lejes dhe jo licencës.</p> <p>2. Të ndryshohet neni 6 i Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2013 ashtu që të lejohet marrja e licencës për dy e më shumë kategori me një procedurë dhe të përcaktohet validiteti i licencës të jetë i përheshëm dhe jo pesë (5) vjeçar. Ne rast se subjekti fillimisht licencohet vetëm për një kategori, në momentin që kërkon licencimin për kategori të tjera, vetëm të shtojë dokumentet e nevojshme dhe jo të fillojë procedurën nga fillimi.</p> <p>3. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2013 për licencimin e stacioneve të autobusëve, në nenin 5, ashtu që të hiqet obligimi i pagesës së shumës prej 100 euro me rastin e aplikimit.</p> <p>3. T'i propozohet Ministrisë që kostoja prej 500 deri 3,000</p>	<p>1. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin E Lejeve dhe Licencave, licenca profesionale ju lëshohet personave fizik, ndërsa leja ju lëshohet personave juridik si në rastin konkret. Andaj ndryshimi i propozuar bazohet në nenin 8 dhe 9 të këtij ligji.</p> <p>2. Me rastin e fuzionimit të procedurës së licencimit në një të vetme, aplikuesit i hiqet barra që të ofrojë të njëjtat dokumente për secilën kategori. Në rastin kur aplikuesi licencohet vetëm për një kategori dhe në të ardhmen i njëjti dëshiron të licencohet për kategori të tjera, i ofron vetëm dëshmitë e plotësimit të kushteve të parapara me ligj dhe nuk dyfishon dokumente që tashmë veç gjenden në Ministri dhe ekzistimi i një kategorie të licencës e vërteton ekzistimin e tyre. Një fuzionim i tillë i procedurës, përpos që lehtëson barrën administrative të një aplikuesi, lehtëson edhe punën e zyrtarëve përgjegjës. Për më tepër,</p>
---	--------------	--	-------------	--	--	--	--

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

						<p>euro që paguhet për marrjen e kësaj licence të kalkulohet në kuadër të kostos së marrjes së të njejtës, ashtuqë e njejtë të jetë në përputhje me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti.</p>	<p>meqenëse subjekti me rastin e licencimit veçse ka dëshmuar që plotëson kriteret për licencim, procedura e ri-licencimit duhet hequr komplet. Për të njëjtën duhet zhvilluar mekanizmat mbikëqyrës që kujdesen që subjekti i licencuar vazhdon t'i plotësojë kriteret ligjore për licencën që mban. Në këtë formë, i lehtësohet barra administrative dhe financiare subjektit dhe zyrtarëve institucional përkatës. Heqja e pagesës me rastin e aplikimit bëhet në përputhje me nenin 18 të Ligjit 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.</p> <p>3. Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë licencë nuk duhet të kalojë shumë e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar atë (neni 18 i Ligjit Nr. 04L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim i tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma prej 500 deri</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

							3,000 euro reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë procesit të lejimit.
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	DTT15	Çertifikata për autobus		Ministria e Infrastrukturës, Departamenti i Transportit Tokesor	<p>1. Neni 8 i Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor parasheh obligimin e paisjes me certifikatë për autobus të gjithë autobusëve pasi qeëkompania të jetë e licencuar dhe autobusët të jenë të regjistruar.</p> <p>2. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, në nenin 11, paragrafi 5.1, parasheh obligimin për pagesën e shumës prej 50 euro me rastin e aplikimit për marrjen e certifikatës.</p>	<p>1. Të ndryshohet neni 8 i Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor i cili parasheh obligimin e paisjes me certifikatë për autobus të gjithë autobusëve pasi qe kompania të jetë e licencuar dhe autobusët të jenë të regjistruar. Të lihet ky obligim vetëm për autobusët të cilët nuk janë certifikuar në momentin e marrjes së lejes.</p> <p>2. Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2015 për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus, në nenin 11, paragrafi 5.1, ashtuqë të hiqet obligimi për pagesën e shumës prej 50 euro me rastin e aplikimit për marrjen e certifikatës.</p>	<p>1. Kjo certifikatë nuk ka nevojë të figurojë në Regjistrin Qendror të Lejeve dhe Licencave meqenëse e njejta nuk është as leje dhe as licencë.</p> <p>2. Kjo certifikatë është e nevojshme vetëm për autobusët shtesë që i përdorë kompania e të cilët nuk janë përdorur për ofrimin e mbushjes së kriterit për marrjen e lejes. (Direktiva/Rregullore për qasjen në profesion 1071/2009; 1072/2009 dhe 1073/2009 për kryerjen e transportit nderkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave) Heqja e certifikatës do të lehtësonte shumë barrën administrative për bizneset ashtu që do të hiqej pagesa prej 50 euro e detyrueshme për secilin autobus për çdo 5 vite.</p>
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	DTT16	Leja për transport të jashtëzakonshëm të mallrave	Leje	Ministria e Infrastrukturës, Departamenti për Menaxhimin e Rrugëve	1. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2014 për Transport të Jashtëzakonshëm, në nenin 9 parasheh validitetin e lejes	1. Të ndryshohet neni 9 i Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2014 për Transport të Jashtëzakonshëm, ashtuqë të parashikohet validiteti i lejes	1. Koha e shkurtër e paraparë për validitetin e kësaj leje, prej një (1) muaji, konsiderohet të jetë barrë shumë e madhe edhe për

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

					<p>për një periudhë prej një (1) muaji.</p> <p>2. Në paragrafin 1.1 të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2014 për Transport të Jashtëzakonshëm parashihet obligimi për pagesë prej 20 euro me rastin e aplikimit për këtë leje.</p> <p>3. Procedura e ankesës nuk rregullohet sipas LPPA.</p>	<p>për transport të jashtëzakonshëm të mallrave për një periudhë prej një (1) viti dhe jo për një (1) muaj.</p> <p>2. Të ndryshohet paragrafi 1.1 i nenit 7 i Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2014 për Transport të Jashtëzakonshëm, ashtu që të mos kërkohet pagesa prej 20 euro për procedurën për marrje të lejes.</p> <p>3. Të rregullohet procedura e ankesës sipas LPPA.</p>	<p>operatorin, por edhe për zyrtarin përgjegjës. Për të adresuar rrezikshmërinë, ndotjen dhe dëmtimin që shkaktohet nga ky lloj transporti është propozuar të rritet shuma që paguhet për këtë leje dhe njëkohësisht të rritet koha e validitetit të saj.</p> <p>2. Heqja e pagesës me rastin e aplikimit bëhet në përputhje me nenin 18 i Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave</p>
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	DA7	Çertifikata për trajner në fushën e patent shoferit	Licencë profesionale	Ministria e Infrastrukturës, Departamenti i automjeteve	<p>1. Neni 112.3 I Ligjin Nr. 05/L-064 per Patent Shofer parashih çertifikatën për trajner në fushën e patent shoferit.</p> <p>2. Neni 23 I Udhëzimit Administrativ (MI) Nr.11/2017 për Trajner në Fushën e Patent Shoferit parashih paisjen me këtë çertifikate.</p> <p>3. Vendimi i Ministrit Nr. 8325 datë 02.11.2017 i cili vendim e ka bazën ligjore në nenin 25 të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2017 për trajner ne fushën e patentë shoferit I percakton</p>	<p>1. Të ndryshohet neni 112.3 I Ligjin Nr. 05/L-064 për Patent Shofer i cili parashih çertifikatën për trajner në fushën e patent shoferit, ashtu që të parashihet Licenca për trajner në fushën e patent shoferit.</p> <p>2. Të ndryshohet Vendimi i Ministrit Nr.8325 datë 02.11.2017, i cili vendim e ka bazën ligjore ne nenin 25 të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2017 për trajner në fushën e patentë shoferit ashtu që të hiqet kërkesa që të paguhet shume prej 200 Euro për marrjen e çertifikatës.</p>	<p>1. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, licenca profesionale ju lëshohet personave fizik, ndërsa leja ju lëshohet personave juridik si në rastin konkret. Andaj ndryshimi i propozuar bazohet në nenin 8 dhe 9 të këtij ligji.</p> <p>2. Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë certifikatë nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar atë (neni 18 i</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

					<p>këto tarifa për këtë çertifikatë:</p> <p>Për paraqitje të provimit-riprovimit kualifikues pjesa me shkrim për trajner ne fushën e patentë shoferit 50 €.</p> <p>Për paraqitje të provimit-riprovimit profesional për trajner ne fushën e patentë shoferit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesa me shkrim 50 € - Pjesa me gojë 30€ - Pjesa praktike 100 € <p>Lëshimi I çertifikatës 200 €</p> <p>Pjesëmarrja në trajnimin bazë për trajner ne fushën e patentë shoferit 1150 €.</p> <p>Për pjesëmarrje ne trajnimin për trajner te certifikuar ne fushën e patentë shoferit 50€.</p>	<p>2. T'i propozohet Ministrisë që kostoja prej 1,500 euro që paguhet për kryerjen e këtij trajimi të kalkullohet në kuadër të koston së marrjes së të njejtës, ashtu që e njejtja të jetë në perputhje me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti.</p>	<p>Ligjit Nr. 04L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim I tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma prej 1630 euro në total reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë procesit të lejimit.</p>
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	DA8	Licencë për kontrollin teknik të automjeteve	Leje	Ministria e Infrastrukturës, Departamenti I automjeteve	<p>1. Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete në nenin 88 dhe 91 parashih nevojën e paisjes me Licencë për operatorin.</p> <p>2. Neni 12 I Udhëzimit Administrativ (MI) nr.01/2018 për Kontrollimin</p>	<p>1. Të ndryshohet Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete në nenin 88 dhe 91 që parashohin nevojën e paisjes me Licencë për operatorin, ashtu që të përcaktohet nevoja për paisje me Leje dhe jo Licencë.</p>	<p>1. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, licenca profesionale ju lëshohet personave fizik, ndërsa leja ju lëshohet personave juridik si në rastin konkret. Andaj ndryshimi i propozuar</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

					<p>Teknik të Automjeteve parasheh tarifa prej 3000 euro, per vijen e kontrollimit teknik te automjeteve deri në 3.5 tonë tarifen prej 2000 euro, per vijen e kontrollimit teknik te automjetevr mbi 3,5t; tarifen prej 300 euro, per vijen e kontrollimit teknik te motocikletave</p>	<p>2. T'i propozohet Ministrisë që kostoja prej 3000 euro, per vijen e kontrollimit teknik te automjeteve deri ne 3.5 tonë; tarifën prej 2000 euro, per vijen e kontrollimit teknik te automjetevr mbi 3,5 tonë; tarifen prej 300 euro, për vijen e kontrollimit teknik te motocikletave që paguhet për marrjen e kësaj leje të kalkulohet në kuadër të kostos së marrjes së të njejtës, ashtu që e njejta të jetë në perputhje me nenin 18 te Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Ky kalkulim mund të bëhet nga projekti.</p>	<p>bazohet në nenin 8 dhe 9 të këtij ligji.</p> <p>2. Kostoja financiare që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për këtë leje nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar atë neni 18 i Ligjit Nr. 04L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave). Një kalkulim i tillë mund të kryhet nga ana e projektit dhe të analizohet nëse shuma në total reflekton shpenzimet që autoriteti mbulon gjatë procesit të lejimit.</p>
--	--	--	--	--	---	---	---

Procesi i thjeshtësimit të Lejeve dhe Licencave në Ministrinë e Shëndetësisë

Në procesin e thjeshtësimit të lejeve dhe licencave pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe harmonizimit të të njëjtave me Ligjin 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave janë analizuar gjithsej 55 leje dhe licenca. Ky draft raport ka për qëllim të identifikojë, analizojë dhe ofrojë rekomandime për thjeshtimin e lejeve dhe licencave të administruara nga Ministria e Shëndetësisë (MSH), Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, gjegjësisht Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK), Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK), Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK), Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK), dhe Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK).

Procesi i inventarizimit dhe analizës së lejeve dhe licencave, i kompletuar gjatë periudhës shtator – nëntor 2021, është bërë në mënyrë transparente dhe gjithpërfshirëse. Fillimisht janë identifikuar të gjitha lejet dhe licencat që administrohen nga MSH, AKPPM, dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësorë. Njëkohësisht, është identifikuar baza ligjore, përkatësisht ligjet dhe aktet nënligjore, me të cilat rregullohen këto leje dhe licenca. Pas identifikimit të tyre, me qëllim që të kuptohet se si zbatohen ato në praktikë, janë mbajtur takime dhe diskutime të shumta me zyrtarë të ministrisë dhe agjencioneve të ndërlidhura. Gjatë këtyre takimeve janë plotësuar formularë përkatës për të gjitha lejet dhe licencat e identifikuar, dhe së bashku me ekipin e projektit janë kontrolluar informatat e mbledhura. Po ashtu, janë zhvilluar edhe dy fokus grupe me përfaqësues të sektorit privat si dhe profesionistë shëndetësorë për të parë ndikimin e lejimeve në punën e tyre. Në fazën e fundit, përmes informacioneve të mbledhura, së bashku me analizën ligjore dhe ekonomike, janë përgatitur rekomandime për thjeshtimin e secilës leje dhe licencë, të përmbledhura në këtë draft raport.

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës	OFTK1-A	Licencimi i fizioterapeutëve		Komisioni për licencim Licenca nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit dhe Kryetari i Odës	<p>1. Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, neni 9 paragrafi 1.3 rregullon vetëm kompetencën e odës për licencim, ri-licencim dhe revokim por jo edhe këtë lloj leje.</p> <p>2. Disa nga dokumentet nuk ka nevojë të kërkohen nga pala.</p> <p>3. Mungon procedura e ankesës.</p> <p>4. Mënyra e pagesës e papërshtatshme dhe e kufizuar.</p> <p>5. Kjo odë pothujase të gjitha shërbimet e licencimit por edhe shërbimet e tjera i kryen në mënyrë elektronike përmes webfaqes https://oftk-ks.org/ e cila është mjaft miqësore me përdoruesit (user-friendly).</p>	<p>1. Të ndryshohet Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe në një aneks të listohen të gjitha licencat profesionale që lëshohen nga odat.</p> <p>2. Të bëhet ndryshimi i Rregullores Nr. 01/2020 për procedurat dhe kriteret e anëtarësimit në OFTK ku kërkohen vetëm informatat dhe të njëjtat të sigurohen sipas detyrës zyrtare e jo dokumentet si: Kopja e letërnjoftimit, Certifikata e noterizuar e provimit profesional apo provimit për specialiste, Kartela e identifikimit të anëtarësisë me të cilin dëshmohet anëtarësimi (kjo kartelë lëshohet pa pagesë).</p> <p>3. Të ndryshohet Rregullorja Nr. 01/2020 për procedurat dhe kriteret e anëtarësimit në OFTK në të cilën vendoset e drejta e ankesës, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën.</p> <p>4. Të ndryshohet Vendimi Nr. 01/2020 për taksat administrative për shërbimet e OFTK-në mënyrë që pagesa të bëhet në fund të procedurës dhe të bëhet edhe përmes e-banking, POS etj. Të pranohet secila dëshmi që vërteton pagesën.</p> <p>5. Nënshkrimi i licencës të bëhet nga Kryetari i Odës ose nga i autorizuari i odës për këtë qëllim.</p>	<p>Ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nevojitet për të harmonizuar këtë ligj me nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave sipas të cilit një leje dhe licencë mund të përcaktohet vetëm me ligj.</p> <p>Ndryshimi i Rregullores Nr.01/2020 për procedurat dhe kriteret e anëtarësimit në OFTK duhet të bëhet për ta harmonizuar me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave por edhe me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare sipas LPPA. Ndryshimi nga një dokument me emër në një kërkesë si p.sh në vend të kopjes së letërnjoftimit të kërkohen të dhënat personale bëhet me qëllim që të mundësohet komunikimi elektronik duke përfshirë edhe ndërlidhjen e sistemeve elektronike.</p> <p>Më tej, ndryshimi i rregullores duhet të bëhet për të rregulluar të drejtën dhe procedurën e ankesës e cila mungon komplet. Ndryshimi i vendimit Nr. 01/2020 për taksat administrative për shërbimet e OFTK-duhet të bëhet për të mundësuar në fund pagesën për të shmangur frekuencën dhe humbjen e kohës për pagese dhe në anën tjetër të mos kufizohet vetëm një formë dëshmie për të provuar pagesën.</p> <p>Vlera e taksës dhe çdo pagese tjetër duhet të jetë në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						<p>6. Në rastet kur paraqitja e disa dokumenteve është e domosdoshme, të mos kërkohet kopja e noterizuar e atyre; p.sh. kërkohet 'Certifikata e noterizuar e provimit profesional apo provimit për specialist'. Noterizimi nuk është i nevojshëm meqenëse ky dokument lëshohet nga vetë Ministria e Shëndetësisë. Kjo vlen për të gjitha licencat që lëshohen nga OFTK.</p> <p>7. Taksa për licencim (80 euro) si dhe për pajisje me vulë (20 euro) janë të larta dhe mund të mos jenë në përputhje me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-2020 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave (Taksa që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për një lejim nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin). Rekomandohet kalkulimi i kostove që shpenzohen për të ofruar këtë shërbim (Banka Botërore mund të ofrojë ndihmë për këtë).</p>	shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin.
Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës	OFTK1-B	Ri-licencimi i fizioterapeutëve	Licencë	Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KEVP) Licenca nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit për	Njëjtë si te licenca OFTK1-A	<p>1. Licenca OFTK1-A të jetë pa afat; Afati 5 vjeçar mund të qëndrojë por vetëm me qëllim të valorizimit për kreditimin e 100 pikëve për mbajtjen licencës bazike.</p> <p>2. Dokumentet e vetme që mund të kërkohen janë ato që dëshmojnë arritjen e 100 pikëve, të gjitha dokumentet tjera nuk ka nevojë të kërkohen sepse ato ekzistojnë dhe janë siguruar gjatë procesit të licencimit të parë.</p>	Nuk ka nevojë të zhvillohet procedura si në rastin e licencimit për herë të parë meqenëse i gjithë qëllimi i ri-licencimit është konstatimi i kërkesave për mbajtjen e licencës profesionale (neni 10, par.3.5) dhe mbajtja e kualifikimeve profesionale përmes arsimimit të vazhdueshëm (neni 13) i Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
				Licencim dhe Kryetari i Odës		<p>3. Licenca për herë të parë OFKT1-A nëse arrihen 100 pikë nuk ka nevojë të ndryshohet por vetëm të azhurnohen të dhënat në regjistrin e licencave. Nëse nuk arrihen 100 pikë kredituese mund të revokohet licenca e parë dhe vazhdohet me proces të provimit për të dëshmuar mbajtjen e kualifikimeve profesionale.</p> <p>4. Të ndryshohet Rregullorja Nr. 01/2020 për Licencë procedurat dhe kriteret e anëtarësimit në OFTK në të cilën vendoset e drejta e ankesës, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën.</p> <p>5. Këto ndryshime mund të bëhen me ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2020 për procedurat dhe kriteret e anëtarësimit në OFTK.</p>	
Oda e Fiziote rapeutëve të Kosovës	OFTK2	Licenca e dublikuar (kopja e licencës)	Licencë	Komisioni për licencim Licenca nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit dhe Kryetari i Odës	Të mos përfshihet në regjistër pasi që nuk është licencë e re.	<p>1. Të kërkohe vetëm një kërkesë më të dhëna minimale për bërë të ditur faktin e humbjes dhe dëmtimit të licencës.</p> <p>2. Të dhënat e tjera janë ose duhet të jenë në regjistrin e licencave që mbahet nga oda.</p> <p>3. Nënshkrimi i kopjes së dublikuar të bëhet nga Kryetari i Odës ose nga personi i autorizuar i Odës për këtë qëllim.</p>	Nuk ka nevojë dhe asnjë argument pse duhet të zhvillohet procedurë dhe të mbledhet dhe marrë vendim komisioni i licencimit për një veprim aq të thjeshtë siç është nxerrja e kopjes së dublikuar i cili lehtësisht mund të konstatohet dhe lëshohet licenca e dublikuar nga shërbimi profesional i Odës.
Oda e Mjekëve të Kosovë	OMK1 -A	Licencimi i doktorëve të mjekësisë	Licencë	Komisioni per licencim Licenca	1. Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë neni 9 paragrafi 1.3, rregullon vetëm kompetencën e odës për	1. Të ndryshohet ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe në një aneks të listohen të gjitha licencat profesionale që lëshohen nga odat.	Ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nevojitet për të harmonizuar këtë ligj me nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
ës (OMK)		(licencimi i përgjithshëm)		nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit dhe Kryetari i Odës	<p>licencim, ri-licencim dhe revokim por jo edhe këtë lloj leje.</p> <p>2. Disa nga dokumentet nuk ka nevojë të kërkohen nga pala.</p> <p>3. Mungon procedura e ankesës.</p> <p>4. Mënyra e pagesës e papërshtatshme dhe e kufizuar.</p>	<p>2. Të bëhet ndryshimi i Rregullores Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Ri-licencimin e mjekëve ku kërkohen vetëm informatat dhe të njëjtat të sigurohen sipas detyrës zyrtare e jo dokumentet si: kopja e letërnjoftimit, certifikata e noterizuar e provimit profesional apo provimit për specialiste. Të fshihet kërkesa për certifikatë mjekësore (tek mjekët e pensionuar) sepse e njëjta tregon gjendjen shëndetësore por jo edhe aftësitë për të ushtruar profesionin e mjekut.</p> <p>3. Të ndryshohet Rregullorja Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Ri-licencimin e Mjekëve në të cilën vendoset e drejta e ankeses, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën.</p> <p>4. Të ndryshohet Vendimi i OMK-së për caktimin e taksave administrative 02/2020 për shërbimet e OMK-ve mënyren që pagesa të bëhet në fund të procedurës dhe të bëhet edhe përmes e-banking, POS etj. Të pranohet secila dëshmi që vërteton pagesën.</p> <p>5. Nënshkrimi i licencës të bëhet nga Kryetari i Odës ose nga i autorizuari i odës për këtë qëllim.</p> <p>6. Në rastet kur paraqitja e disa dokumenteve është e domosdoshme, të mos kërkohet kopja e noterizuar e atyre; p.sh. kërkohet 'Certifikata e noterizuar e provimit</p>	<p>Licencave sipas te cilit nje leje dhe licence mund te percaktohet vetem me ligj.</p> <p>Ndryshimi i Rregullores Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Rilicencimin e Mjekëve duhet te behet per te harmonizuar me nenin 16 te Ligjit Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave por edhe me parimin e zhvillimit te procedures sipas detyres zyrtare sipas LPPA. Ndryshimi nga nje dokument me emer ne nje kerkese si p.sh ne vend te kopjes se leternjoftimit te kerkohen te dhenat personale behet me qellim qe te mundesohet komunikimi elektronik duke perfshire edhe nderlidhjen e sistemeve elektronike.</p> <p>Me tej, ndryshimi i rregullores duhet te behet per te rregullaur te drejten dhe proceduren e ankeses e cila mungon komplet. Ndryshimi i vendimit te OMK-se per caktimin e taksave administrative 02/2020-duhet te behet per te mundesuar ne fund pagesen per te shmangur frekuencen dhe humbjen e kohes per pagese dhe ne anen tjetet te mos kufizohet vetem nje forme deshmie per te provuar pagesen.</p> <p>Vlera e taksës dhe cdo pagese tjetër duhet të jetë në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave dhe nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin.</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						profesional apo provimit per specialist'. Noterizimi nuk është i nevojshëm meqenëse ky dokument lëshohet nga vete Ministria e Shëndetësisë. Kjo vlen për të gjitha licencat që lëshohen nga OMK.	
Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK)	OMK1-B	Rilicencimi i doktorëve të mjekësisë (licencimi i përgjithshëm)	Licencë	Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KEVP) Licenca nënshkruhet ng: Kryetari i Komisionit për Licencim dhe Kryetari i Odës	Njëjtë si te licenca OMK1-A	<p>1. Licenca OMK1-A të jetë pa afat; afati 5 vjeçar mund të qëndroj por vetëm me qëllim të valorizimit për kreditimin e 100 pikëve për mbajtjen e licencës bazike.</p> <p>2. Dokumentet e vetme që mund të kërkohen janë ato që dëshmojnë arritjen e 100 pikëve, të gjitha dokumentet tjera nuk ka nevojë të kërkohen sepse ato ekzistojnë dhe janë siguruar gjatë procesit të licencimit të parë.</p> <p>3. Licenca për herë të parë OMK1-A, nëse arrihen 100 pikë nuk ka nevojë të ndryshohet por vetëm të azhurnohen të dhënat në regjistrin e licencave. Nëse nuk arrihen 100 pikë kredituese mund të revokohet licenca e parë dhe vazhdohet me proces të provimit për të dëshmuar mbajtjen e kualifikimeve profesionale.</p> <p>4. Të ndryshohet Rregullorja Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Ri-licencimin e Mjekëve në të cilën vendoset e drejta e ankesës, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën.</p> <p>5. Këto ndryshime mund të bëhen me</p>	Nuk ka nevojë të zhvillohet procedura si në rastin e licencimit për herë të parë meqenëse i gjithë qëllimi i rilicencimit është konstatimi i kërkesave për mbajtjen e licencës profesionale (neni 10, par.3.5) dhe mbajtja e kualifikimeve profesionale përmes arsimimit të vazhdueshëm (neni 13) i Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Poashtu të largohet edhe taksa prej 40 euro për rilicencim.

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejit	Lloji i lejit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Ri-licencimin e Mjekëve.	
Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK)	OMK2-A	Licencimi i specialistëve dhe subspecialistëve (licencimi specialistik)	Licencë	Komisioni për licencim Nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit dhe Kryetari i Odës	<p>1. Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësore, neni 9 paragrafi 1.3 rregullon vetëm kompetencën e odës për licencim, rilicencim dhe revokim por jo edhe këtë lloj leje.</p> <p>2. Disa nga dokumentet nuk ka nevojë të kërkohen nga pala.</p> <p>3. Mungon procedura e ankesës.</p> <p>4. Mënyra e pagesës e papërshtatshme dhe e kufizuar.</p>	<p>1. Të ndryshohet Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe në një aneks të listohen të gjitha licencat profesionale që lëshohen nga odat.</p> <p>2. Të bëhet ndryshimi i Rregullores Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Rilicencimin e Mjekëve ku kërkohen vetëm informatat dhe të njëjtat të sigurohen sipas detyrës zyrtare e jo dokumentet si: kopja e letërnjoftimit, certifikata e noterizuar e provimit profesional apo provimit për specialiste. Të fshihet kërkesa për certifikatë mjekësore (tek mjekët e pensionuar) sepse e njëjta tregon gjendjen shëndetësore por jo edhe aftësite për të ushtruar profesionin e mjekut.</p> <p>3. Të ndryshohet Rregullorja Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Rilicencimin e Mjekëve në të cilën vendoset e drejta e ankesës, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën.</p> <p>4. Të ndryshohet Vendimi i OMK-së për caktimin e taksave administrative 02/2020 për shërbimet e OMK-ve mënyrën që pagesa të bëhet në fund të procedurës dhe të bëhet edhe përmes e-banking, POS etj. Të pranohet secila dëshmi që vërteton pagesën.</p>	<p>Ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nevojitet për të harmonizuar këtë ligj me nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave sipas të cilit një leje dhe licence mund të përcaktohet vetëm me ligj.</p> <p>Ndryshimi i Rregullores Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Rilicencimin e Mjekëve duhet të bëhet për të harmonizuar me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave por edhe me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare sipas LPPA. Ndryshimi nga një dokument me emër në një kërkesë si p.sh në vend të kopjes së letërnjoftimit të kërkohen të dhënat personale bëhet me qëllim që të mundësohet komunikimi elektronik duke përfshirë edhe ndërlidhjen e sistemeve elektronike.</p> <p>Më tej, ndryshimi i rregullores duhet të bëhet për të rregulluar të drejtën dhe procedurën e ankesës e cila mungon komplet. Ndryshimi i vendimit të OMK-së për caktimin e taksave administrative 02/2020 duhet të bëhet për të mundësuar në fund pagesën për të shmangur frekuencën dhe humbjen e kohës për pagese dhe në anën tjetër të mos kufizohet vetëm një forme dëshmie për të provuar pagesën.</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejit	Lloji i lejit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						<p>5. Nënshkrimi i licencës të bëhet nga Kryetari i Odës ose nga i autorizuari i odës për këtë qëllim.</p> <p>6. Ne rastet kur paraqitja e disa dokumenteve është e domosdoshme, të mos kërkohet kopja e noterizuar e atyre; p.sh. kërkohet 'Certifikata e noterizuar e provimit profesional apo provimit për specialist'. Noterizimi nuk është i nevojshëm meqenëse ky dokument lëshohet nga vetë Ministria e Shëndetësisë. Kjo vlen për të gjitha licencat që lëshohen nga OMK.</p>	Vlera e taksës dhe çdo pagesë tjetër duhet të jetë në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin.
Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK)	OMK2-B	Rilicencimi i specialistëve dhe subspecialistëve (licencimi specialistik)	Licencë	<p>Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KEVP)</p> <p>Licenca nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit për Licencim dhe Kryetari i Odës</p>	Njëjtë si te licenca OMK2-A	<p>1. Licenca OMK1-A të jetë pa afat.</p> <p>2. Afati 5 vjeçar mund të qëndroj por vetëm me qëllim të valorizimit për kreditimin e 100 pikëve për mbajtjen e licencës bazike.</p> <p>3. Dokumentet e vetme që mund të kërkohen janë ato që dëshmojnë arritjen e 100 pikëve, të gjitha dokumentet tjera nuk ka nevojë të kërkohen sepse ato ekzistojnë dhe janë siguruar gjatë procesit të licencimit të parë.</p> <p>3. Licenca për herë të parë OMK1-A nëse arrihen 100 pikë nuk ka nevojë të ndryshohet por vetëm të azhurnohen të dhënat në regjistrin e licencave. Nëse nuk arrihen 100 pikë kredituese mund të revokohet licenca e parë dhe vazhdohet me proces të provimit për të dëshmuar mbajtjen e kualifikimeve profesionale.</p>	Nuk ka nevojë të zhvillohet procedura si në rastin e licencimit për herë të parë meqenëse i gjithë qëllimi i rilicencimit është konstatimi i kërkesave për mbajtjen e licencës profesionale (neni 10, par.3.5) dhe mbajtja e kualifikimeve profesionale përmes arsimimit të vazhdueshëm (neni 13) i Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejit	Lloji i lejit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						<p>4. Të ndryshohet Rregullorja Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Ri-licencimin e Mjekëve në të cilën vendoset e drejta e ankesës, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesë.</p> <p>6. Këto ndryshime mund të bëhen me ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Rilicencimin e Mjekëve.</p>	
Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK)	OMK3	Leje për hulumtime bio-mjekësore (përfshin edhe lejet për COVID)	Licencë	Komisioni për Çështje Etike; Licenca nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit	<p>1. Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nuk e rregullon askund këtë lloj leje.</p> <p>2. Disa nga dokumentet nuk ka nevojë të kërkohen nga pala.</p> <p>3. Mungon procedura e ankesës.</p> <p>4. Mënyra e pagesës e papërshtatshme dhe e kufizuar.</p> <p>6. Mungon afati i lëshimit të licencës.</p>	<p>1. Të ndryshohet Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe në një aneks të listohen të gjitha licencat profesionale që lshohen nga odat.</p> <p>2. Të bëhet ndryshimi i Rregullores Nr. 07/2020 për fusheveprimin dhe kompetencat e Komisionit për Çështjet Etike ku kërkohen vetëm informatat dhe të njejtat të sigurohen sipas detyres zyrtare e jo dokumentet si: Kopjet e licencave valide profesionale të pjesëmarrësve në hulumtim.</p> <p>3. Të ndryshohet Rregullorja Nr. 07/2020 për fusheveprimin dhe kompetencat e Komisionit për Çështjet Etike në të cilën vendoset e drejta e ankesës, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën.</p> <p>4. Të ndryshohet Vendimi i OMK-së për caktimin e taksave administrative 02/2020</p>	<p>Ndryshimi i ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nevojitet për të harmonizuar këtë ligj me nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave sipas të cilit një leje dhe licenc mund të percaktohet vetëm me ligj.</p> <p>Ndryshimi i Rregullores Nr. 04/2020 për Regjistrimin, Licencimin, dhe Rilicencimin e Mjekëve duhet të bëhet për të harmonizuar me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave por edhe me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare sipas LPPA. Ndryshimi nga një dokument me emër në një kerkese si p.sh në vend të kerkeses për kopjet e licencave valide profesionale të pjesëmarrësve në hulumtim të kërkohen të dhenat personale bëhet me qëllim që të mundësohet komunikimi elektronik duke përfshirë edhe nderlidhjen e sistemeve elektronike.</p> <p>Me tej, ndryshimi i rregullores duhet të bëhet</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						<p>për shërbimet e OMK-ve mënyren qe pagesa te behet ne fund te procedures dhe te behet edhe permes e-banking, POS etj. Të pranohet secila dëshmi qe vërteton pagesën.</p> <p>5. Te caktohet afati per zhvillimin dhe marrjen e vendimit per kete lloj licence.</p> <p>6. Taksat janë shumë të larta (prej 120-480 euro) dhe mund te mos jenë në përputhje me nenin 18 te Ligjit Nr. 04/L-2020 pë Sistemin e Lejeve dhe Licencave (taksa që autoriteti kompetent mund të ngarkojë për një lejim nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin). Taksat duhet të ndryshojnë sipas ngarkesës dhe jo sipas subjektit (personi fizik apo person juridik). Rekomandohet kalkulimi i kostove që shpenzohen per te ofruar kete sherbim (Banka Boterore mund te ofrojë ndihmë për këtë).</p>	<p>per te rregullaur te drejten dhe proceduren e ankeses e cila mungon komplet. Ndryshimi i vendimit te OMK-së per caktimin e taksave administrative 02/2020 duhet të bëhet për të mundesuar në fund pagesen per te shmangur frekuencen dhe humbjen e kohes per pagese dhe ne anen tjeter te mos kufizohet vetem nje forme deshmie per te provuar pagesen.</p> <p>Vlera e taksës dhe cdo pagese tjetër duhet të jetë në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave dhe nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin.</p>
Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK)	OMK4	Licenca e dublifikuuar (kopja e licencës)	Licencë	Komisioni për licencim Licenca nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit dhe Kryetari i Odës	Të mos përfshihet në regjistër pasi që nuk është licencë e re.	<p>1. Te kerkohet vetem nje kerkese me te dhena minimale per bere te ditur faktin e humbjes ose demtimit te licences.</p> <p>2. Të dhënat e tjera janë ose duhet të jenë në regjistrin e licencave që mbahet nga oda.</p> <p>3. Nënshkrimi i kopjes se dublifikuuar te bëhet nga Kryetari i Odës ose nga i autorizuari i odës për këtë qëllim.</p>	Nuk ka nevojë dhe asnje argument pse duhet te zhvillohet procedurë dhe të mbledhet dhe marre vendim komisioni i licencimit per nje veprim aq te thjesht sic eshte nxerrja e kopjes se dublifikuuar i cili lehtesisht mund te konstatohet dhe leshohet licenca e dublifikuuar nga sherbimi profesional i odes.

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK)	OFK1-A	Licencimi i farmacistëve	Licencë	Komisioni për licencim Licenca nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit dhe Kryetari i Odës	<p>1. Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësore, neni 9 paragrafi 1.3 rregullon vetëm kompetencën e odës për licencim, rilicencim dhe revokim por jo edhe këtë lloj leje.</p> <p>2. Disa nga dokumentet nuk ka nevojë të kërkohen nga pala.</p> <p>3. Mungon procedura e ankesës me rastin e licencimit ndërsa për rilicencim nuk është e plotë.</p> <p>4. Mënyra e pagesës e papërshtatshme dhe e kufizuar.</p>	<p>1. Te ndryshohet ligji Nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësore dhe në një aneks të listohen të gjitha licencat profesionale që lshohen nga odat.</p> <p>2. Të bëhet ndryshimi i Rregullores Nr. 08/2019 për Licencimin dhe Rilicencimin e Farmacistëve ku kërkohen vetëm informatat dhe të njëjtat të sigurohen sipas detyres zyrtare e jo dokumentet si: kopja e leternjoftimit, certifikata e noterizuar e provimit profesional apo provimit për specialiste, kartela e identifikimit të anetaresise me të cilin deshmonet anetaresimi.</p> <p>3. Te ndryshohet Rregullorja Nr. 08/2019 për Licencimin dhe Rilicencimin e Farmacistëve në të cilën vendoset e drejta e ankeses, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën.</p> <p>4. Të ndryshohet Vendimi Nr. 08/2019 për caktimin e taksave administrative për sherbimet e OFK-së në mënyrën që pagesa të bëhet në fund të procedurës dhe të bëhet edhe përmes e-banking, POS etj. Të pranohet secila dëshmi që verteton pagesën.</p> <p>5. Nënshkrimi i licencës të bëhet nga Kryetari i Odës ose nga i autorizuari i Odës për këtë qëllim.</p>	<p>Ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësore nevojitet për të harmonizuar këtë ligj me nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave sipas të cilit një leje dhe licencë mund të përcaktohet vetëm me ligj.</p> <p>Ndryshimi i Rregullores 08/2019 për Licencimin dhe Rilicencimin e Farmacistëve duhet të bëhet për të harmonizuar me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave por edhe me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyres zyrtare sipas LPPA. Ndryshimi nga një dokument me emër në një kërkesë si p.sh në vend të kopjes së leternjoftimit të kërkohen të dhenat personale, bëhet me qëllim që të mundësohet komunikimi elektronik duke përfshirë edhe nderlidhjen e sistemeve elektronike.</p> <p>Me tej, ndryshimi i rregullores duhet të bëhet për të rregulluar të drejtën dhe procedurën e ankesës e cila mungon komplet. Ndryshimi i Vendimi Nr. 08/2019 për caktimin e taksave administrative për sherbimet e OFK-së duhet të bëhet për të mundësuar në fund pagesën për të shmangur frekuencën dhe humbjen e kohës për pagesë dhe në anën tjetër të mos kufizohet vetëm një formë dëshmie për të provuar pagesën.</p> <p>Vlera e taksës dhe çdo pagesë tjetër duhet të jetë në pajtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave dhe nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejit	Lloji i lejit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
					<p>6. Regjistri i licencave mungon ose nuk është i plotë.</p> <p>7. Emërtimi është i gabuar si licencë e cila i referohet një personi fizik për angazhimin në një profesion që paraqet një rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik.</p> <p>8. Mungojne rregullat për revokimin dhe transferin e kësaj leje.</p>	<p>Autoriteti Kompetent, Autorizimi i Marketingut për produkt medicinal i lëshuar nga AKPPM, Autorizim për import të poseduar nga importuesi të dhënë nga AKPPM ose licencë për import të lëshuar nga AKPPM dhe duhet ti përmbush standardet e PMP.</p> <p>4. Te ndryshohet ligji 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale ne te cilin vendoset rregulla per lejueshmerine e ankeses, procedura, organi qe shqyrton ankesen dhe afati per paraqitje te ankeses dhe vendimmarrje mbi ankesen ne pajtim me LPPA.</p> <p>5. Te ndryshohet ligji 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale dhe hiqen te gjitha taksat per sherbimet ndersa tarifat te vendosen ne pajtim me nenin 12 te LPPA. Menyra e pagesa te behet ne fund te procedures dhe te behet edhe permes e-banking, POS etj. Te pranohet secila deshmi qe verteton pagesen. Ne rast se refuzohet leshimi i kesaj leje te behet kthimi i gjitha pagesave te bera nga pala.</p> <p>6. Te krijohet/kompletohet regjistri i licencave me te gjitha elementet ashtu sic i permban licenca.</p> <p>7. Te ndryshohet menyra e vendimmarrjes per kete licence dhe delegimi i pergjgjesise te behet tek nepunesi profesional ashti sic parashihet ne nenin 26 te LPPA. Nenshkrimi i</p>	<p>pajisje medicinale duhet t'i menjanoj te gjitha taksat per sherbime ndersa tarifat e licences duhet te percaktohen sipas nenin 12 te LPPA si dhe te percaktoj rregulla per te mundesuar ne fund pagesen per te shmangur frekuencen dhe humbjen e kohes per pagese dhe ne anen tjeter te mos kufizohet vetem nje forme deshmie per te provuar pagesen.</p> <p>Regjistri i licencave eshte i domosdoshem sidomos ne rast te humbjes ose demtimit te nje licence per te dublikuar te njejten, por edhe per te mundesuar komunikimin dhe shkembimin e informatave me organet tjera publike.</p> <p>Delegimi i kompetences per vendimarrja eshte kerkese ligjore e LPPA duke perfshire edhe nenshkrimin e licences.</p> <p>Rregullat per revokimin jane te nevojshme qofte edhe si referim te Ligji Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave.</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejit	Lloji i lejit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						<p>licences te behet nga udheheqsi i njesise perkatsisht zyrtari pergjegjes ne AKPPM i caktuar ne pajtim me LPPA.</p> <p>8. Te ndryshohet kategoria e lejimi nga licence ne leje.</p> <p>9. Rregullat per revokimin dhe transeferin e kesaj leje te aplikohen ato te percaktuara ne Ligjin Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave.</p>	
Agjencia Kosovare per Produkte dhe Pajisje Medicinale	AKPP M14	Licencë për prodhim të produkteve medicinale	Leje	<p>Departamenti i Licencimit në kuadër të AKPPM</p> <p>Licenca nënshkruhet nga Drejtori dhe Kryeshefi i AKPPM</p>	<p>1. Ligji Nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale e përmend këtë lloj lejimi në nenin 10 si autorizim për prodhim.</p> <p>2. Licenca jepet me afat prej 5 vjeteve i cili përcaktohet me akt nënligjor dhe pas kalimit të këtij afati duhet të bëhet rilicencimi për të cilin duhet të ndjeket e njëjta procedurë si te licencimi.</p> <p>3. E drejta e ankesës nuk është e rregulluar në mënyrë të plotë dhe jo në pajtim me LPPA.</p> <p>4. Me ligj parashihen tarifa të shërbimit për këtë lloj lejimi e që është në kundërshtim me nenin 12 të LPPA.</p> <p>5. Pagesa për këtë licencë mund</p>	<p>1. Te ndryshohet Ligji Nr. 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale dhe kjo leje te jepet pafat duke fshire afatin e vlefshmerise dhe nevojën per rilicencim</p> <p>2. Te ndryshohet Ligji Nr. 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale ne te cilin vendoset rregulla per lejueshmerine e ankeses, procedura, organi qe shqyrton ankesen dhe afati per paraqitje te ankeses dhe vendimmarrje mbi ankesen ne pajtim me LPPA.</p> <p>3. Te ndryshohet ligji 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale dhe hiqen te gjitha taksat per sherbimet bdersa tarifat te vendosen ne pajtim me nenin 12 te LPPA. Menyra e pagesa te behet ne fund te procedures dhe te behet edhe permes e-banking, POS etj. Te pranohet secila deshmi qe verteton pagesen. Ne rast se refuzohet leshimi i kesaj leje te behet kthimi i gjitha pagesave te bera nga pala.</p>	<p>Arsyja e vetme pse duhet te behet rilicencimi eshte pagesa prandaj edhe nevoja per rilicencim eshte e pajustificiueshme dhe barre e panevojshme per palen.</p> <p>Ndryshimi i ligjit 04/L -190 per produkte dhe pajisje duhet per te rregullaur te drejten dhe proceduren e ankeses e cila mungon komplet Ndryshimi i ligjit 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale duhet t'i menjanoj te gjitha taksat per sherbime ndersa tarifat e licences duhet te percaktohen sipas nenin 12 te LPPA si dhe te percaktoj rregulla per te mundesuar ne fund pagesen per te shmangur frekuencen dhe humbjen e kohes per pagese dhe ne anen tjetër te mos kufizohet vetem nje forme deshmie per te provuar pagesen. Regjistri i licencave eshte i domosdoshem sidomos ne rast te humbjes ose demtimit te nje licence per te dublikuar te njejtën, por edhe per te mundesuar komunikimin dhe shkembimin e informatave me organet tjera publike.</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
					<p>të bëhet me këste për çdo vit, ndërsa nëse nuk paguhet kësti revokohet licenca.</p> <p>6. Regjistri i licencave mungon ose nuk është i plotë.</p> <p>7. Emërtimi është i gabuar si licencë e cila i referohet një personi fizik për angazhimin në një profesion që paraqet një rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik.</p> <p>8. Mungojnë rregullat për revokimin dhe transferin e kësaj leje.</p>	<p>4. Te krijohet/kompletohet regjistri i licencave me te gjitha elementet ashtu sic i permban licenca.</p> <p>5. Te ndryshohet menyra e vendimmarrjes per kete licence dhe delegimi i pergjjesise te behet tek nepunsesi profesional ashti sic parashihet ne nenin 26 te LPPA. Nenshkrimi i licences te behet nga udheheqsi i njesise perkatsisht zyrtari pergjegjes ne AKPPM i caktuar ne pajtim me LPPA.</p> <p>6. Te ndryshohet kategoria e lejimi nga licence ne leje.</p> <p>7. Rregullat per revokimin dhe transeferin e kesaj leje te aplikohen ato te percaktuara ne Ligjin Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave.</p>	<p>Delegimi i kompetences per vendimarrja eshte kerkese ligjore e LPPA duke perfshire edhe nenshkrimin e licences. Rregullat per revokimin jane te nevojshme qofte edhe si referim te Ligji Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave.</p>
Agjencia Kosovare per Produkte dhe Pajisje Medicinale	AKPP M15	Licencë për laborator galenik	Leje	<p>Departamenti i Licencimit në kuadër të AKPPM</p> <p>Licenca nënshkruhet nga Drejtori dhe Kryeshefi i AKPPM</p>	<p>1. Ligji Nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale e përmend këtë lloj lejimi në nenin 10 si autorizim për prodhim.</p> <p>2. Licenca jepet me afat prej 5 vjetëve i cili përcaktohet me akt nënligjor dhe pas kalimit të këtij afati duhet të bëhet rilicencimi për të cilin duhet të ndjeket e njejta procedure si te licencimi.</p> <p>3. E drejta e ankesës nuk është e</p>	<p>1. Te ndryshohet Ligji Nr. 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale dhe kjo leje te jepet pafat duke fshire afatin e vlefshmerise dhe nevojen per rilicencim.</p> <p>2. Te ndryshohet Ligji Nr. 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale ne te cilin vendoset rregulla per lejueshmerine e ankeses, procedura, organi qe shqyrton ankesen dhe afati per paraqitje te ankeses dhe vendimmarrje mbi ankesen ne pajtim me LPPA.</p> <p>3. Te ndryshohet ligji 04/L -190 per produkte</p>	<p>Arsyja e vetme pse duhet te behet rilicenci eshte pagesa prandaj edhe nevoja per rilicencim eshte e pajustificiueshme dhe barre e panevojshme per palen. Ndryshimi i ligjit 04/L -190 per produkte dhe pajisje duhet per te rregullaur te drejten dhe proceduren e ankeses e cila mungon komplet Ndryshimi i ligjit 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale duhet t'i menjanoj te gjitha taksat per sherbime ndersa tarifat e licences duhet te percaktohen sipas nenin 12 te LPPA si dhe te percaktoj rregulla per te mundesuar ne fund pagesen per te shmangur frekuencen dhe humbjen e kohes per pagese dhe ne anen tjetër</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
					<p>rregulluar në mënyrë të plotë dhe jo në pajtim me LPPA.</p> <p>4. Me ligj parashihen tarifa të shërbimit për këtë lloj lejimi e që është në kundërshtim me nenin 12 të LPPA.</p> <p>5. Pagesa për këtë licencë mund të bëhet me këste për çdo vit, ndërsa nëse nuk paguhet kësti revokohet licenca.</p> <p>6. Regjistri i licencave mungon ose nuk është i plotë.</p> <p>7. Emërtimi është i gabuar si licencë e cila i referohet një personi fizik për angazhimin në një profesion që paraqet një rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik.</p> <p>8. Vlerësimi i përmbushjes së disa kriterëve bëhet në teren përmes zyrtarëve të lartë të AKPPM dhe është fazë obligative e procedurës.</p> <p>9. Mungojnë rregullat për revokimin dhe transferin e kësaj leje.</p>	<p>dhe pajisje medicinale dhe hiqen të gjitha taksat për shërbimet bndersa tarifatat vendosen në pajtim me nenin 12 të LPPA. Menyra e pagesa të bëhet në fund të procedurës dhe të bëhet edhe përmes e-banking, POS etj. Të pranohet secila dëshmi që verteton pagesën. Në rast se refuzohet leshimi i kësaj leje të bëhet kthimi i gjitha pagesave të bera nga pala.</p> <p>4. Të krijohet/kompletohet regjistri i licencave me të gjitha elementet ashtu siç i përmban licenca.</p> <p>5. Të ndryshohet menyra e vendimmarrjes për këto licence dhe delegimi i përgjegjësive të bëhet tek nepunsesi profesional ashtu siç parashihet në nenin 26 të LPPA. Nenshkrimi i licencës të bëhet nga udhëheqsi i njesisë perkatsisht zyrtari përgjegjës në AKPPM i caktuar në pajtim me LPPA;</p> <p>6. Të ndryshohet kategoria e lejimit nga licence në leje.</p> <p>7. Vlerësimi i përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të bëhet përmes plotësimit të një deklarate nën betim pa pas nevojë për të bërë vizita nga zyrtarët e lartë të AKPPM.</p> <p>8. Rregullat për revokimin dhe transeferin e kësaj leje të aplikohen ato të percaktuara në Ligjin Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.</p>	<p>te mos kufizohet vetëm një formë dëshmie për të provuar pagesën.</p> <p>Regjistri i licencave është i domosdoshëm sidomos në rast të humbjes ose demtimit të një licence për të dublikuar të njëjtën, por edhe për të mundësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informatave me organet tjera publike.</p> <p>Delegimi i kompetencës për vendimmarrja është kërkesë ligjore e LPPA duke përfshirë edhe nenshkrimin e licencës. Rregullat për revokimin janë të nevojshme qoftë edhe si referim të Ligji Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
Agjencia Kosovare per Produkte dhe Pajisje Medicinale	AKPP M16	Licencë për operim me narkotikë	Leje	Departamenti i Licencimit në kuadër të AKPPM Licenca nënshkruhet nga Drejtori dhe Kryeshefi i AKPPM	<ol style="list-style-type: none"> 1. Licenca jepet me afat prej 5 vjeteve dhe pas kalimit të këtij afati duhet të bëhet rilicencimi për të cilin duhet të ndjeket e njëjta procedurë si te licencimi. 2. Disa nga dokumentet nuk ka nevojë të kërkohen nga pala. 3. E drejta e ankesës nuk është e rregulluar në mënyrë të plotë dhe jo në pajtim me LPPA. 4. Me ligj parashihen tarifa të shërbimit për këtë lloj lejimi e që është në kundërshtim me nenin 12 të LPPA. 5. Pagesa për këtë licencë mund të bëhet me këste për çdo vit, ndërsa nëse nuk paguhet kësti revokohet licenca. 6. Regjistri i licencave mungon ose nuk është i plotë. 7. Emërtimi është i gabuar si licencë e cila i referohet një personi fizik për angazhimin në një profesion që paraqet një rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik. 8. Vlerësimi i përmbushjes së disa kritereve bëhet në teren 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kjo leje te jepet pafat duke fshire afatin e vlefshmerise dhe nevojen per rilicencim. 2. Te behet ndryshimi i Udhezimit Administrativ (MSH) Nr.11/2015 - Qarkulluesit Farmaceutikë me Pakicë për produkte dhe paisje medicinale, ku kerkohen vetem informatat dhe te njejtat te sigurohen sipas detyres zyrtare e jo dokumentet si:Kopja e licencës së punës (si qarkullues me shumicë, pakice, apo institucion shendetesor), Kopja e licencës së punës të personit përgjegjës, Kopja e letërnjoftimit të drejtorit dhe personit përgjegjës, Vërtetimi nga gjykata për statutin penal (për drejtorin dhe personin përgjegjës, origjinale ose e noterizuar, jo më e vjetër se 6 muaj). 3. Te ndryshohet ligji 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale ne te cilin vendoset rregulla per lejueshmerine e ankese, procedura, organi qe shqyrton ankesen dhe afati per paraqitje te ankese dhe vendimmarrje mbi ankesen ne pajtim me LPPA. 4. Te ndryshohet ligji 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale dhe hiqen te gjitha taksat per sherbimet ndersa tarifat te vendosen ne pajtim me nenin 12 te LPPA. Menyra e pagesa te behet ne fund te procedures dhe te behet edhe permes e-banking, POS etj. Te pranohet secila deshmi qe verteton pagesen. Ne rast se refuzohet 	<p>Arsyja e vetme pse duhet te behet rilincimi eshte pagesa prandaj edhe nevoja per rilicencim eshte e pajustificiueshme dhe barre e panevojshme per palen. Ndryshimi i Udhezimit Administrativ (Msh) Nr.11/2015 - Qarkulluesit Farmaceutikë me Pakicë për produkte dhe paisje medicinale duhet te behet me qellim qe i njejt duhet te permbaj informatat sipas paragrafit 12 te Ligjit Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave me qellim te harmonizimit edhe me nenin 16 te Ligjit Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave por edhe me parimin e zhvillimit te procedures sipas detyres zyrtare sipas LPPA. Ndryshimi i ligjit 04/L -190 per produkte dhe pajisje duhet per te rregullaur te drejten dhe proceduren e ankese e cila mungon komplet Ndryshimi i ligjit 04/L -190 per produkte dhe pajisje medicinale duhet t'i menjanoj te gjitha taksat per sherbime ndersa tarifat e licences duhet te percaktohen sipas nenin 12 te LPPA si dhe te percaktoj rregulla per te mundesuar ne fund pagesen per te shmangur frekuencen dhe humbjen e kohes per pagese dhe ne anen tjetet te mos kufizohet vetem nje forme deshmie per te provuar pagesen.</p> <p>Regjistri i licencave eshte i domosdoshem sidomos ne rast te humbjes ose demtimit te nje licence per te dublikuar te njejt, por edhe per te mundesuar komunikimin dhe shkembimin e informatave me organet tjera publike. Delegeini i kompetences per vendimarrja eshte kerkese ligjore e LPPA duke perfshire edhe</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
					<p>përmes zyrtarëve të lartë të AKPPM dhe është fazë obligative e procedurës si dhe është me pagesë.</p> <p>9. Mungojnë rregullat për revokimin dhe transferin e kësaj leje.</p>	<p>leshimi i kesaj leje te behet kthimi i gjitha pagesave te bera nga pala.</p> <p>5. Te krijohet/kompletohet regjistri i licencave me te gjitha elementet ashtu sic i permban licenca.</p> <p>6. Te ndryshohet menyra e vendimmarrjes per kete licence dhe delegimi i pergjegjesise te behet tek nepunesi profesional ashti sic parashihet ne nenin 26 te LPPA. Nenshkrimi i licences te behet nga udheheqsi i njesise perkatsisht zyrtari pergjegjes ne AKPPM i caktuar ne pajtim me LPPA/</p> <p>7. Te ndryshohet kategoria e lejimi nga licence ne leje.</p> <p>8. Vleresimi i permbushjes se kushteve dhe kriterëve te behet permes plotesimit te nje deklarata nen betim pa pas nevojë per te bere vizita nga zyrtaret e larte te AKPPM;</p> <p>9. Rregullat per revokimin dhe transeferin e kesaj leje te aplikohen ato te percaktuara ne Ligjin Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave.</p>	<p>nenshkrimin e licences. Rregullat per revokimin jane te nevojshme qofte edhe si referim te Ligji Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave.</p>
Agjencia Kosovare per Produkte dhe	AKPP M17	Licencë për operim me prekursorë	Leje	Departamenti i Licencimit në kuadër të AKPPM Licenca nënshkruhet nga Drejtori dhe Kryeshefi i AKPPM	<p>1. Licenca jepet me afat prej 1 viti dhe pas kalimit të këtij afati duhet të bëhet rilicencimi për të cilin duhet të ndjeket e njëjta procedurë si te licencimi.</p> <p>2. Disa nga dokumentet nuk ka nevojë të kërkohen nga pala.</p>	<p>1. Kjo leje te jepet pafat duke fshire afatin e vlefshmerise dhe nevojën per rilicencim.</p> <p>2. Te behet ndryshimi i Udhezimit Administrativ (Msh) Nr.11/2015 - Qarkulluesit Farmaceutikë me Pakicë për produkte dhe paisje medicinale, ku kerkohen vetem informatat dhe te njejtat te</p>	<p>Arsyja e vetme pse duhet te behet rilicencimi eshte pagesa prandaj edhe nevojja per rilicencim eshte e pajustificiueshme dhe barre e panevojshme per palen. Ndryshimi i Udhezimit Administrativ (Msh) Nr.11/2015 - Qarkulluesit Farmaceutikë me Pakicë për produkte dhe paisje medicinale duhet te behet me qellim qe i njejtat duhet te</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
Pajisje Medicinale					<p>3. E drejta e ankesës nuk është e rregulluar në mënyrë të plotë dhe jo në pajtim me LPPA.</p> <p>4. Me ligj parashihen tarifa të shërbimit për këtë lloj lejimi e që është në kundërshtim me nenin 12 të LPPA.</p> <p>5. PAGESA për këtë licencë mund të bëhet me këste për çdo vit, ndërsa nëse nuk paguhet kësti revokohet licenca.</p> <p>6. Regjistri i licencave mungon ose nuk është i plotë.</p> <p>7. Emërtimi është i gabuar si licencë e cila i referohet një personi fizik për angazhimin në një profesion që paraqet një rrezik të mesëm apo të lartë për shëndetin publik.</p> <p>8. Vlerësimi i përmbushjes së disa kriterëve bëhet në teren përmes zyrtarëve të lartë të AKPPM dhe është fazë obligative e procedurës si dhe është me pagesë.</p> <p>9. Mungojnë rregullat për revokimin dhe transferin e kësaj leje.</p>	<p>sigurohen sipas detyres zyrtare e jo dokumentet si: Vërtetimi nga gjykata për statutin penal (për drejtorin dhe personin përgjegjës, origjinale ose e noterizuar, jo më e vjetër se 6 muaj), Kopja e leternjoftimit të drejtorit dhe personit përgjegjës.</p> <p>3. Te ndryshohet ligji 04/L -190 për produkte dhe pajisje medicinale në të cilin vendoset rregulla për lejueshmerinë e ankesës, procedura, organi që shqyrton ankesën dhe afati për paraqitje të ankesës dhe vendimmarrje mbi ankesën në pajtim me LPPA.</p> <p>4. Te ndryshohet ligji 04/L -190 për produkte dhe pajisje medicinale dhe hiqen të gjitha taksat për shërbimet ndërsa tarifat të vendosen në pajtim me nenin 12 të LPPA. Menyra e pagesa të bëhet në fund të procedurës dhe të bëhet edhe përmes e-banking, POS etj. Të pranohet secila deshmi që verteton pagesën. Në rast se refuzohet leshimi i kësaj leje të bëhet kthimi i gjitha pagesave të bera nga pala.</p> <p>5. Të krijohet/kompletohet regjistri i licencave me të gjitha elementet ashtu siç përmban licenca.</p> <p>6. Te ndryshohet menyra e vendimmarrjes për këto licence dhe delegimi i përgjegjësisë të bëhet tek nepunsesi profesional ashtu siç parashihet në nenin 26 të LPPA. Nenshkrimi i licencës të bëhet nga udhëheqsi i njesisë</p>	<p>permbaj informatat sipas paragrafit 12 të Ligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave me qëllim të harmonizimit edhe me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave por edhe me parimin e zhvillimit të procedurës sipas detyres zyrtare sipas LPPA. Ndryshimi i ligjit 04/L -190 për produkte dhe pajisje duhet për të rregulluar të drejtën dhe procedurën e ankesës e cila mungon komplet Ndryshimi i ligjit 04/L -190 për produkte dhe pajisje medicinale duhet t'i menjanojë të gjitha taksat për shërbime ndërsa tarifat e licencës duhet të percaktohen sipas nenin 12 të LPPA si dhe të percaktoj rregulla për të mundësuar në fund pagesën për të shmangur frekuencën dhe humbjen e kohës për pagesë dhe në anën tjetër të mos kufizohet vetëm një formë deshmie për të provuar pagesën.</p> <p>Regjistri i licencave është i domosdoshëm sidomos në rast të humbjes ose demtimit të një licence për të dublikuar të njëjtën, por edhe për të mundësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informatave me organet tjera publike.</p> <p>Delegeini i kompetencës për vendimmarrja është kërkesë ligjore e LPPA duke përfshirë edhe nenshkrimin e licencës. Rregullat për revokimin janë të nevojshme qoftë edhe si referim të Ligji Nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave.</p>

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
						<p>perkatsisht zyrtari pergjegjes ne AKPPM i caktuar ne pajtim me LPPA.</p> <p>7. Te ndryshohet kategoria e lejimi nga licence ne leje.</p> <p>8. Vleresimi i permbushjes se kushteve dhe kriterëve te behet permes plotesimit te nje deklarata nen betim pa pas nevojë per te bere vizita nga zyrtaret e larte te AKPPM.</p> <p>9. Rregullat per revokimin dhe transeferin e kesaj leje te aplikohen ato te percaktuara ne Ligjin Nr. 04/L-202 per sistemin e lejeve dhe licencave.</p>	
Agjencia Kosovare per Produkte dhe Pajisje Medicinale	AKPP M18	Licencë për import të produkteve medicinale per terapi individuale	Leje	Departamenti i Licencimit në kuadër të AKPPM Licenca nënshkruhet nga Drejtori dhe Kryeshefi i AKPPM	Kjo licencë (leje) nuk ka bazë ligjore	Të ndryshohet forma e lejimit nga licencë në regjistrim.	Është e tepert dhe pajustificueshme qe produktet medicinale per konsum individual te kalojne ne procedure standarde te licencimit. Ky lloj i licences eshte I njehershëm dhe nuk vlen per rastet tjera.
Agjencia Kosovare per Produkte dhe	AKPP M19	Licencë për eksport të produkteve medicinale	Leje	Departamenti i Licencimit në kuadër të AKPPM Licenca nënshkruhet nga Drejtori dhe Kryeshefi i AKPPM	Kjo licencë (leje) nuk ka bazë ligjore shprehimore në Ligjin Nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale, ndërsa për lëshimin e saj kërkohen dokumente të cilat tashmë janë lëshuar nga AKPPM siç janë: Autorizim marketingu,	Të ndryshohet forma e lejimit nga 'licence' ne 'regjistrim'.	Ky lloj lejimi i kategorizuar si 'licence' nuk ka ndonje kuptim dhe efekt ne mbrojtjen e interesit publik sepse ajo tashme eshte arritur permes tri llojeve te licencave qe leshohen nga AKPPM perderisa AKPPM mund te kerkoje qe produktet medicinale qe eksportohen te regjistrohen pa pasur nevojë te pajisen me licence.

PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027

Organi	Nr. ref	Emri i lejimit	Lloji i lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat:	Rekomandimet:	Justifikimi:
Pajisje Medicinale					Certifikata CPP (Certificate of Pharmaceutical Product), dhe licenca për prodhim ose import.		
Agjencia Kosovare per Produkte dhe Pajisje Medicinale	AKPP M20	Licencë për eksport të pajisjeve medicinale	Leje	Departamenti i Licencimit ne kuader te AKPPM; Licenca nenshkruhet nga: Drejtori dhe Kryeshefi i AKPPM	Kjo licencë (leje) nuk ka bazë ligjore shprehimore në Ligjin Nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale, ndërsa për lëshimin e saj kërkohen dokumente të cilat tashmë janë lëshuar nga AKPPM siç është dëshmia e importit të pajisjes, nëse pajisja nuk është prodhim vendor.	Te ndryshohet forma e lejimit nga 'licence' ne 'regjistrim'.	Ky lloj lejimi i kategorizuar si 'licence' nuk ka ndonje kuptim dhe efekt ne mbrojtjen e interesit publik sepse ajo tashme eshte arritur permes tri llojeve te licencave qe leshohen nga AKPPM perderisa AKPPM mund te kerkoje qe produktet medicinale qe eksportohen te regjistrohen pa pasur nevojte te pajisen me licence.

Shtojca 3: Analiza për thjeshtimin e shërbimeve publike administrative të përzgjedhura duke u bazuar në ngjarje reale

Shërbi mi	Informatat e obligueshme/dokumentet e nevojshme/siguruar nga vet pala/nga organet tjera publike	Pagesat administrativ e/kushtëzimet	Të gjeturat	Rekomandimet	Justifikimi
Regjistri mi i parë i atutomjetit	<p>Baza Ligjore: <i>Udhëzimi Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve, Neni 6, paragrafi 1.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Dokumenti i prejardhjes së mjetit, libreza e origjinës [Pala]. Nëse pala nuk posedon dokumentin origjinal të mjetit (librezën e origjinës) mund ta dorëzojë fotokopjen e dokumentit ose një dokument tjetër të vërtetuar/noterizuar nga shteti përkatës që përmban si dhe vërtetimin nga policia për humbje bashkë me verifikimin nga autokrimet. [Pala]. DUD-i doganor ose dëshmi nga dogana. Në rastin kur DUD-i doganor është paguar në emër të autosallonit apo kompanisë së licencuara nga ARBK për shitjen e mjetit i cili është i regjistruar në ARBK- MTI për këtë veprimtari nga MTI, duhet që pronari i mjetit të prezantojë edhe dëshminë origjinale të shitjes nga autosalloni apo kompania e licencuar për shitje. Për këtë Zyrtari i QRA-se, obligohet ta konsultoj listën e autosalloneve apo të kompanive të licencuara për shitje të regjistruara nga ARBK që është në kuadër të MTI-së, ose përmes sistemit on-line-DK- [Pala]. Certifikata e homologimit të mjetit me përjashtim të rasteve kur mjeti është i liruar nga procedura e homologimit-[Pala]. 	<p>Baza Ligjore: <i>Vendimi nr.012/20, i datës 16.01.2020 për caktimin e tarifave</i></p> <p>(shembull vetura)</p> <ul style="list-style-type: none"> 25 € për regjistrim te veturës [pika 5.4]. 10 € paisja me certifikatë [pika 5.11]. 20 € paisja me targa [pika 5.12]. 10 € për taksë ekologjike [pika 6.1.1]. 40 € për taksë rrugore [pika 6.2.1]. 10 € për taksë komunale 	<ol style="list-style-type: none"> Kërkesa në pikën 3 kërkohet që të vërtetohet përmes dokumentit të Doganës së Kosovës së sistemit e cila sigurohet nga pala. Dokumenti në pikën 4 është në kundërshtim me Ligjin NR. 08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për automjete. Dokumenti që kërkohet në pikën 8, është: letërnjoftimi, pasaporta apo patentë shoferi të cilat sigurohet nga pala. Informata e obligueshme në pikën 11 për të poseduar patent shofer valid, është në kundërshtim me ligjin për automjete, por edhe në të drejtën e pronës. Taksat për regjistrim në pikën në pikën 5.4, në vlerë prej 20€, e paarsyeshme dhe në kundërshtim me LPPA Pagesat e taksave bëhet vetëm në mënyrë dhe formë klasike: për taksën komunale në komunë ndërsa për taksat tjera në QRA. Shlyerja e gjobave është kusht i paarsyeshëm dhe nuk ka as një ndërlidhje me procesin e regjistrimit të automjetit. Kjo kërkesë dhe dëshmimi i pagesës duhet të bëhet nga pala. 	<p>Ndryshimi i nenit 6 , paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Informata e obligueshme në pikën 3 mund të përmbushet përmes sistemit elektronik duke prodhuar dokumentin ose duke ndërlidh sistemin me Doganën. Të harmonizohet kërkesa në pikën 4 me Ligjin NR. 08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për automjete. Dokumentet në pikën 8 të mos kërkohen por informatat nga to, të sigurohen përmes ndërlidhjes së sistemeve ose në forma të tjera, pasi që i posedon i njëjti organ publik. Informata e obligueshme për patentë shofer të fshihet, ndërsa përdorimi i automjetit të behët vetëm nga personat që posedojnë patentë shoferin valid për kategorinë e mjetit që përdoret (ashtu siç është në nenin 53 të Ligjit për automjete). Të fshihet neni 3 paragrafi 4 që kushtëzon regjistrimin e automjetit me shlyerjen gjobave të shqiptuara në trafikun rrugor, 	<ol style="list-style-type: none"> Rekomandimet e dhëna për ndryshim të Udhëzimit Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve bëhen me qëllim që disa nga informatat e obligueshme të fshihen sepse të njëjtat nuk mbrojnë interesin publik. Ndryshimet e tjera rekomandohen të bëhen me qëllim që informatat që i posedon organi ose organet tjera publike nuk ka nevojë të sigurohen nga pala (parimi vetëm një herë sipas nenit 86, paragrafi 3, LPPA). Rekomandimet për ndryshimin e Vendimit nr.012/20, të datës 16.01.2020, për caktimin e tarifave për shkak se disa nga to janë të pajustificueshme dhe në kundërshtim me nenin 12 të LPPA. Eliminimi i kushtëzimeve siç janë pagesa e gjobave, justifikohet me faktin se procesi i regjistrimit ska asnjë lidhje me shlyerjen e

	<ol style="list-style-type: none"> 5. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga data e lëshimit [Pala]. 6. Polica e sigurimit, nuk duhet të jetë më e vjetër se pesë (5) ditë nga data e lëshimit dhe dëshmia e pagesës [Pala]. 7. Taksa komunale e automjetit përjashtimisht kategoritë e liruara nga taksat sipas legjislacionit në fuqi [Pala]. 8. Dokument i vlefshëm i Republikës së Kosovës që përmban të dhënat personale si: letërnjoftimi, pasaporta apo patentë shoferi [Pala] 9. Për shtetasit e huaj të cilët posedojnë lejeqëndrimi të përkohshëm ose përhershëm, mund të regjistrojnë mjetet me targat e rregullta, në rastet kur i kanë të përbushura obligimet doganore. Afati i regjistrimit të automjetit lidhet me skadimin e lejeqëndrimit; 10. Të dhënat për pronarin e mjetit merren përmes ndërlihdjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile për persona fizikë dhe nga ATK dhe ARBK për persona juridikë; 11. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, për persona fizikë, përjashtimisht kategoritë e liruara sipas nenit 3 pika 3 të këtij Udhëzimi Administrativ. 	<p>(përcaktohet me rregullore komunale).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shlyerja e gjobave në trafikun rrugor është kusht për regjistrimin e automjetit, neni 3 paragrafi 4 i UA NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve. 		<p>ndërsa ekzekutimi i gjobave të bëhet nga ATK siç përcaktohet me LPPA.</p> <p>Ndryshimi i Vendimit nr.012/20, i datës 16.01.2020 për caktimin e tarifave</p> <ol style="list-style-type: none"> 6. Të fshihet taksa në vlerë prej 20 € e përcaktuar në pikën 5.4 të këtij vendimi sepse e njëjta është në kundërshtim me LPPA. 7. Pagesat duhet të bëhen në fund të procesit dhe me një dokument të vetëm ndërsa forma dhe mënyrat mund të jenë: në mënyrë klasike, përmes e-banking, përmes POS 	<p>gjobave, përderisa për këtë proces tash më ka zgjidhje ligjore efektive sipas LPPA për këtë çështje.</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Propozimi që pagesë të bëhet në fund të procesit rekomandohet të bëhet me qëllim të zvogëlimit të frekuencës së lartë që e ka pala duke paguar veç e veç por edhe në mënyrë klasike pa pas mundësi pagese në mënyra tjera, përmes e-banking, POS, etj.
<p>Vazhdimi i regjistrimit të automjetit</p>	<p>Baza Ligjore: Udhëzimi Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve, Neni 7, paragrafi 1.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. CRA e lëshuar nga QRA [Pala]. 2. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga data e lëshimit [Pala]. 3. Polica e sigurimit nuk duhet të jetë me evjetër se pesë (5) ditë nga data e lëshimit, dhe dëshmia e pagesës [Pala] 4. Dokument i vlefshëm i pronarit të mjetit që përmban të dhënat personale; letërnjoftimi, 	<p>Baza Ligjore:</p> <p>Vendimi nr.012/20, i datës 16.01.2020 për caktimin e tarifave</p> <p>(shembull vetura)</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 € për taksë ekologjike [pika 6.1.1]. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. CRA duhet të prezantohet fizikisht nga pala ndonëse këto të dhëna i ka ose duhet t'i ketë QRA. Në CRA ka disa rubrika që vulosen dhe nënshkruhen nga Zyrtari i QRA me rastin e vazhdimit. 2. Kërkesat nga 4 deri 9 i janë ngarkuar palës disa nga të cilat janë në posedim të vet organit ose organeve tjera publike përderisa disa tjera janë të panevojshme. 3. Pagesat bëhen vetëm në mënyrë dhe formë klasike dhe për taksën komunale në komunë ndërsa për taksat tjera në QRA. 	<p>Ndryshimi i nenit 7 , paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. CRA të lëshohet vetëm për herën e parë të regjistrimit dhe nuk ka nevojë që e njëjta të ripërtërihet deri në ndërrim të pronarit ose ndonjë ndryshimi në automjet. 2. Gjatë vazhdimit të regjistrimit të automjetit të bëhet vetëm kontrolla teknike dhe pastaj sigurimi sipas pikës 2 dhe 3. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrimi është lloj lejimi prandaj si i tillë bëhet vetëm njëherë me të cilin dëshmohet përmes certifikatës. Nuk ka nevojë në ndryshohet certifikata deri nuk ndryshohen kriteret ose faktet për lëshimin e saj. 2. Si informata të obligueshme e arsyeshme që duhet të bëhen në periudha të caktuara (1 vjecare) janë kontrollat teknike (për të mbrojtur interesin e përgjithshëm)

	<p>pasaporta e Republikës së Kosovës apo Patentë Shoferi [Pala].</p> <p>5. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, (persona fizik), përjashtimisht kategoritë e liruara sipas nenit 3 paragrafi 3 të këtij Udhëzimi Administrativ [Pala].</p> <p>6. Taksa komunale e mjetit përjashtimisht kategoritë e liruara nga taksat sipas legjislacionit në fuqi [Pala].</p> <p>7. Mjeti i cili është i regjistruar në emër të personit juridik, pronari duhet të prezantojë fotokopjen e certifikatës së biznesit, informatën e biznesit dhe dokumentin e identifikimit i vlefshëm, letërnjoftimin, pasaportën ose patentë shoferin [Pala].</p> <p>8. Kërkesën për vazhdim të regjistrimit mund ta bëjë edhe personi i autorizuar, me autorizim të vërtetuar nga noteri apo nga gjykata, duke poseduar fotokopjen e dokumentit të identifikimit, patentë shoferin e pronarit për personin fizik, ndërsa për personin juridik fotokopjen e certifikatës dhe informatës së biznesit [Pala].</p> <p>9. Kërkesën për vazhdim të regjistrimit të mjetit mund ta bëjnë edhe familjaret e pronarit në mjetit, duke ofruar kopjen e dokumentit identifikues letërnjoftim, pasaportë, patentë shofer të vlefshëm të pronarit të mjetit [Pala].</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 40 € për taksë rrugore [pika 6.2.1]. • 10 Euro për taksë komunale (përcaktohet me rregullore komunale) • Shlyerja e gjobave në trafikun rrugor është kusht për regjistrimin e automjetit, neni 3 paragrafi 4 i UA NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve. 	<p>4. Shlyerja e gjobave është kusht i paarsyeshëm dhe nuk ka as një ndërlidhje me procesin e regjistrimit të automjetit. Kjo kërkesë dhe dëshmimi i pagesës duhet të bëhet nga pala.</p>	<p>3. Kërkesat tjera dhe dokumentet e kërkuara, janë të panevojshme. Të fshihet neni 3 paragrafi 4 që kushtëzon regjistrimin e automjetit me shlyerjen gjobave të shqiptuara në trafikun rrugor, ndërsa ekzekutimi i gjobave të bëhet nga ATK siç përcaktohet me LPPA.</p> <p><i>Ndryshimi i Vendimit nr.012/20, datës 16.01.2020 për caktimin e tarifave</i></p> <p>4. Pagesat duhet të bëhen në fund të procesit dhe para lëshimit të policës së sigurimit me një dokument të vetëm ndërsa forma dhe mënyrat mund të jenë: në mënyrë klasike, përmes e-banking, përmes POS. Kërkesa për dëshminë e pagesës së taksës të kërkohet nga kompania e sigurimit.</p>	<p>dhe sigurimi. Informatat nga 4 deri 9 në këtë qasje prezumohet se janë konsumuar gjatë regjistrimit prandaj të njëjtat janë të panevojshme. Gjatë kontrollit policor prezantohet CRA+dëshmia e kontrollit automjetit+polica e sigurimit (së fundmi kanë filluar të aplikohen edhe stickersat që vendosen në tabelat e automjetit).</p> <p>3. Me qëllim të zvogëlimit të frekuencës së lartë që e ka pala duke paguar veç e veç por edhe në mënyrë klasike pa pas mundësi pagese e-banking, POS, etj., pagesat që mbesin mund të bëhen duke e detyruar kompaninë e sigurimit që para lëshimit të policës së sigurimit (kompania e sigurimit certifikohet nga organet publike prandaj bartja e këtij autorizimi nuk ka asnjë problem)</p> <p>4. Eliminimi i kushtëzimeve siç janë pagesa e gjobave justifikohet me faktin se procesi i vazhimit të regjistrimit nuk ka asnjë lidhje me shlyerjen e gjobave përderisa për këtë proces tash më ka zgjidhje ligjore efektive sipas LPPA për këtë çështje.</p>
<p>Ndërrimi i pronësisë së</p>	<p>Baza Ligjore: <i>Udhëzimi Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve, Neni 8, paragrafi 1;</i></p>	<p>Baza Ligjore: <i>Vendimi nr.012/20, datës 16.01.2020 për</i></p>	<p>1. Procesi i ç` lajmërimit në pikën 1 kërkohet të kryhet nga pala (blerësi). Gjatë ç`lajmërimit dorëzohen edhe tabelat e regjistrimit.</p>	<p>Ndryshimi i nenit 8 , paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve si më poshtë:</p>	<p>1. Rekomandimet e dhëna për ndryshim të Udhëzimit Administrativ (MPB) NR. 07/2019 për regjistrimin e mjeteve bëhen me qëllim</p>

<p>automjeti t</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. CRA e çlajmëruar e pronarit paraprak [Pala]. 2. Dëshmia e pronësisë (kontrata e shitblerjes, kontrata në rast dhurate, akti i trashëgimisë, dokument me anë të të cilit dëshmohet pronësia, të vërtetuar nga noteri ose nga gjykata, apo urdhrin nga përmbauesi privat i ekzekutueshëm [Pala]. 3. Me rastin e blerjes së mjetit në kompanitë e regjistruara nga organet përkatëse për shitblerjen e mjeteve nevojitet [Pala]. 4. Kontrata e shitblerjes e vërtetuar nga noteri ose gjykata, për automjetet që janë të regjistruara në emër të autosalloneve [Pala]. 5. Polica e sigurimit në emër të pronarit të ri dhe dëshmia e pagesës [Pala]. 6. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimi [Pala]. 7. Dokument i vlefshëm identifikues i Republikës së Kosovës i pronarit të mjetit, letërnjoftimin, pasaporta ose patentë shoferin Të dhënat merren përmes ndërlidhjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile [Pala]. 8. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, për persona fizikë, përjashtimisht kategoritë e liruara sipas nenit 52 të Ligjit për Automjete [Pala]. 9. Mjeti në pronësi të personit juridik regjistrohen në bazë të certifikatës së biznesit, pronari duhet të prezantojë fotokopjen e certifikatës dhe informatës së biznesit dhe dokumentin e vlefshëm të identifikimit të Republikës së Kosovës (letërnjoftimin, pasaportën ose patentë shoferin, ndërsa për organizata joqeveritare apo institucionet shtetërore, regjistrimi bëhet sipas certifikatës fiskale. Të dhënat merren përmes ndërlidhjes nga ATK dhe ARBK [Pala]. 10. Për mjetet e institucioneve shtetërore për ndërrimin e pronësisë, nevojitet dëshmia nga institucioni për bartjen e pronësisë apo 	<p>caktimin e tarifave</p> <p>(shembull vetura)</p> <ul style="list-style-type: none"> • 25 € për regjistrim te veturës (si nga fillimi) [pika 5.4]. • 10 € paisja me certifikatë [pika 5.11] • 20 € paisja me targa [pika 5.12] • 10 € për taksë ekologjike [pika 6.1.1] • 40 € për taksë rrugore, pika 6.2.1 • 10 Euro për taksë komunale (përcaktohet me rregullore komunale) • Shlyerja e gjobave në trafikun rrugor është kusht për regjistrimin e automjetit, neni 3 paragrafi 4 i UA NR. 07/2019 për 	<ol style="list-style-type: none"> 2. Polica e sigurimit dhe certifikata e kontrollit si në pikën 5 dhe 7 duhet të sigurohen pala (blerësi) si nga fillimi 3. Në pikën 7 kërkohet dokument siç është: letërnjoftimi, pasaporta apo patentë shoferi të cilat sigurohet nga pala. 4. Informata e obligueshme në pikën 8 për të poseduar patent shofer valid është në kundërshtim me ligjin për automjete por edhe në të drejtën e pronës. 5. Informatat e obligueshme ne piken 9 janë ne regjistra publik (ARBK dhe ARC) ndërsa kërkohen nga pala. 6. Taksat për regjistrim në pikën në pikën 5.4, në vlerë prej 20€ e paarsyeshme dhe në kundërshtim me LPPA 7. Pagesa e tabelave në vlerë prej 20 € sipas pikës 5.12 në kundërshtim me LPPA. 8. Pagesat e taksave bëhet vetëm në mënyrë dhe formë klasike dhe për taksën komunale në komunë ndërsa për taksat tjera në QRA. 9. Shlyerja e gjobave është kusht i paarsyeshëm dhe nuk ka as një ndërlidhje me procesin e regjistrimit të automjetit. Kjo kërkesë dhe dëshmimi i pagesës duhet të bëhet nga pala. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Çlajmërimi të bëhet nga vet CRA e jo nga pala. 2. Dokumentet në pikën 7 të mos kërkohen por informatat nga to të sigurohen përmes ndërlidhjes së sistemeve ose në forma të tjera pasi që i posedon i njëjti organ publik. 3. Polica e sigurimit dhe kontrolla teknike nuk ka nevojë të kërkohen rishtazi por vazhdojnë në afatin e mbetur, ndërsa vazhdimi i regjistrimit bëhet pastaj sipas propozimit më lartë. 4. Informata e obligueshme në pikën 8 për patentë shofer të fshihet ndërsa përdorimi i automjetit të behët vetëm nga personat që posedojnë patentë shoferin valid për kategorinë e mjetit që përdoret (ashti sic është në nenin 53 të Ligjit për automjete). 5. Të fshihet neni 3 paragrafi 4 që kushtëzon regjistrimin e automjetit me shlyerjen gjobave të shqiptuara në trafikun rrugor, ndërsa ekzekutimi i gjobave të bëhet nga ATK siç përcaktohet me LPPA. <p>Ndryshimi i Vendimit nr.012/20, datës 16.01.2020 për caktimin e tarifave</p> <ol style="list-style-type: none"> 6. Të fshihet taksa në vlerë prej 20 € e përcaktuar në pikën 5.4 të këtij vendimi sepse e njëjta është në kundërshtim me LPPA pasi që vetura është regjistruar njëherë. 7. Tabelat të ndërrohen vetëm kur blerësi ka vendbanim që ndryshon nga shitësi në kuptim të regjionit por jo edhe kur kudi i regjionit është i njëjtë. 	<p>që disa nga informatat e obligueshme të fshihen sepse të njëjtat nuk mbrojnë interesin publik. Ndryshimet e tjera rekomandohen të bëhen me qëllim që informatat që i posedon organi ose organet tjera publike nuk ka nevojë të sigurohen nga pala (parimi vetëm një herë sipas LPPA).</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Rekomandimet për ndryshimin e Vendimit nr.012/20, datës 16.01.2020 për caktimin e tarifave justifikohen sepse disa nga to janë të pajustificueshme dhe në kundërshtim me nenin 12 të LPPA. 3. Eliminimi i kushtëzimeve sic janë pagesa e gjobave justifikohet me faktin se procesi i ndërrimit të pronarit s`ka asnjë lidhje me shlyerjen e gjobave përdërisa për këtë proces tash më ka zgjidhje ligjore efektive sipas LPPA për këtë çështje. 4. Propozimi që pagesë të bëhet në fund të procesit rekomandohet të bëhet me qëllim të zvogëlimit të frekuencës së lartë që e ka pala duke paguar veç e veç por edhe në mënyrë klasike pa pas mundësi pagese në mënyra tjera përmes e-banking, POS, etj.
---------------------------	--	--	---	--	---

	<p>dhënies në shfrytëzim në institucionin tjetër [Pala].</p> <p>11. Për mjetet të cilat shiten në ankand publike duhet të sjellin dëshminë e shitjes së institucionit përkatës. Ndërsa, në rast të blerjes nga pala e tretë, duhet të sigurohet kontrata e shitblerjes e vërtetuar nga noteri ose nga gjykata [Pala].</p> <p>12. Taksa komunale në emrin e pronarit të ri [Pala].</p>	<p><i>regjistrimin e mjeteve.</i></p>		<p>8. Pagesat duhet të bëhen në fund të procesit dhe me një dokument të vetëm ndërsa forma dhe mënyrat mund të jenë: në mënyrë klasike, përmes e-banking, përmes POS</p>	
<p>Certifikat a për të kaluarën kriminale¹</p>	<p>Baza Ligjore: <i>Rregullorja Nr.0112018 për Sistemin Qendror te Evidencës Penale te Kosovës.</i></p> <p><i>(informatat e mëposhtme figurojnë në ëbfaqe të KGJK, por askund nuk përcaktohen në Rregulloren e lartëcekur)</i></p> <p>1. Kur të paraqiteni në gjykatë, duhet të keni me vete njërën nga këto tre dokumente valide a) letërnjoftimin dhe kopjen e tij b) patentë shoferin dhe kopjen e tij c) pasaporten dhe kopjen e saj [Pala].</p> <p>2. Nëse paraqitni kërkesën përmes uebfaqes, njërën nga dokumentet e mësipërme mund ta ngarkoni drejtpërsëdrejti nga uebfaqja si pjese e kërkesës [Pala].</p> <p>3. Nëse jetoni në një qytet tjetër që nuk është vendlindja juaj, duhet të merrni me vete dhe të paraqisni në gjykatë, certifikatën e bashkësisë lokale nga vendbanimi juaj aktual [Pala].</p>	<p>Baza Ligjore: <i>Rregullorja Nr.0112018 për Sistemin Qendror te Evidencës Penale te Kosovës, neni 19.</i></p> <p>(Në ëbfaqen e KGJK janë të publikuara këto tarifa)</p> <ul style="list-style-type: none"> Nëse aplikoni për arsye punësimi, certifikata lëshohet pa pagesë. Nëse aplikoni për arsye të tjera, certifikata kushton pesë (5) euro. Pagesa bëhet në sportelin 	<p>1. Kërkesat në pikën 1 dhe 2 kërkojnë nga pala edhe pse ato janë në posedim të organeve publike dhe të njëjtat nuk janë kërkesë e Rregullores Nr.0112018 për Sistemin Qendror te Evidencës Penale te Kosovës.</p> <p>2. Kërkesat në pikën 3 është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 17 sepse i njëjti përcakton se certifikata mund të merret në çdo gjykatë të shkallës së parë apo dege të gjykatës në tere territorin e Republikës së Kosovës pa marrë parasysh vendbanimin apo vendqëndrimin e personit që kërkon certifikatën e tillë.</p> <p>3. Edhe pse aplikimi mund të bëhet në mënyrë elektronike, tërheqja e certifikatës duhet të bëhet fizikisht nga pala.</p> <p>4. Pagesa e tarifës bazuar në qëllimin e shfrytëzimit të certifikatës është paargumentueshme</p>	<p>1. Ndryshimi i Rregullores Nr.0112018 për Sistemin Qendror te Evidencës Penale te Kosovës për të mundësuar mekanizmin e bashkëpunimit në mes KGJK dhe ARC informatat e kërkuara në pikën 1 dhe 2 të sigurohen në mënyrë automatike duke ndërlidh sistemin elektronik të gjendjes civile me SQEPK.</p> <p>2. Të fshihet nga ëbfaqja e KGJK dhe mos të kërket informata në pikën 3.</p> <p>3. Aty kur sipas legjislacionit kërket certifikata fizike e gjendjes civile e njëjta të mund të shkarkohet nga sistemi pa pas nevojë që pala të shkojë ta marrë fizikisht (ngjashëm si tek certifikatat e gjendjes civile) përveç atyre certifikatave për qëllime jashtë Kosovës.</p> <p>4. Të fshihet pagesa sepse e njëjta është e pajusifikueshme dhe në kundërshtim me LPPA.</p>	<p>1. Ndryshimi i Rregullores Nr.0112018 për Sistemin Qendror te Evidencës Penale te Kosovës propozohet me qëllim që informatat dhe dokumentet që janë në dispozicion të organit/ve publike të sigurohen nga vet organi publik e jo pala (neni 86, par. 3 i LPPA) ku në rastin e certifikatës për kaluarën kriminale është shumë i mundshëm sepse nevojitet ndërlidhja e dy sistemeve elektronike.</p> <p>2. Informatat e përcaktuara pa bazë ligjore janë pa bazë ligjore dhe duhet të fshihen.</p> <p>3. Mundësimi i pajisjes me certifikatë në mënyrë elektronike është lehtësi të palët dhe kursen kohë dhe para.</p> <p>4. Logjika e përcaktimit të pagesës duke u bazuar në qëllimin e shfrytëzimit të certifikatës (për aplikim për punë falas ndërsa për</p>

¹ Rregullorja nr.01/2018 mbi sistemin qendror të evidencës penale, i referohet sistemit të ri të evidencës penale, i cili është duke u ngritur nga KGJK, ky sistem sa i përket lëshimit të certifikatave ende nuk ka filluar të implementohet dhe i njëjti pritet të fillojë së zbatuari në fund të vitit 2022. Me fillimin e zbatimit të SQEP-së, emri i shërbimit do të zëvendësohet me **Certifikatën e gjendjes penale**, e cila do të lëshohet në formë të unifikuar në gjykatat e vendit, nëpërmjet E-Kosova.

		e pagesave në gjykate.			qëllime tjera me pagesë) është e pajustificueshme dhe në kundërshtim me LPPA.
Leje e ndërtimit - kategoria I	<p>Baza Ligjore: <i>Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Neni 15, shtojca 3</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Kopja e planit dhe Çertifikata e pronësisë të pronarit/pronarëve të parcelës/ave (dëshmia mbi pronën jo më e vjetër se 6 muaj në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral [Pikë e vetme e kontaktit]. Vërtetimi i tatimit në pronë të pronarit/pronarëve të parcelës/ave dhe investitori [Pala]. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarit/pronarëve të parcelës/ave dhe investitorit [Pala]. Informata mbi planin. (nga planet rregulluese, PZHU, PZHK-opcionale [Pala]). Kushtet ndërtimore të miratuar [Pala]. Incizimi gjeodezik me ndërtesë të pozicionuar në sistemin koordinativ shtetëror Kosova Ref. 01. (Nga kompania e licensuar gjeodezike) [Pala]. Projekti Ideor në 3 kopje të forta dhe një kopje digjitale [Pala]. Pëlqimet nga kompanitë publike (KEDS, KUR"Prishtina", PTK,etj.) [Pala]. Nëse ndërtesa pozicionohet në dy e më shumë parcela kadastrale, paraprkisht të bëhet bashkimi i tyre [Pala]. Dëftesë pagesa e taksës komunal [Pala]. 	<p>Baza ligjore: <i>Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës, neni 4, paragrafi 1.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Taksa Administrative e cila caktohet nga secila komune me akt të saj. P.sh Komuna e Prishtinës taksën administrative për kategorinë e II-të e ka 6.50 €/m² ku 3.85€/m² janë për shqyrtim të aplikacionit ndërsa 2.65€/m² për mbikëqyrje 	<ol style="list-style-type: none"> Kërkesa për lejen e ndërtimit duhet të paraqitet nga pala në mënyrë fizike Dokumenti i kërkuar në pikën 1 në praktikë sigurohet nga pala Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë është kusht obligativ që duhet të plotësohet. Dokumentet nga pika 3 edhe pse janë në dispozicion të organeve publike kërkohej nga pala. Kushtet ndërtimore kërkohej nga pala ndërsa të njëjtat janë miratuar nga organi publik Pëlqimet në pikën 8 që lëshohen nga ndërmarrjet publike (KEDS, KUR, PTK etj) duhet të sigurohen nga pala (në praktikë këto i kushtëzojnë palët me pagesën e borxhit nëse pala ka borxh tek to) Pagesa e taksave shumë e lartë dhe e pajustificueshme dhe në kundërshtim me LPPA dhe LSSL. 	<p>Ndryshimi i Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve të ndryshohet si në vijim,</p> <p>Neni 15, shtojca 2 në këto pika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Informatat në pikën 1, 3, 4, 5 të sigurohen nga vet organi kompetent pa pas nevojë që të dëshmohen me dokumente. Pagesa e tatimit në pronë nuk duhet të jetë informatë e obligueshme dhe e njëjta duhet të fshihet. Pëlqimet nga ndërmarrjet publike të sigurohen nga vet organi publik <p>Neni 12 të ndryshohet dhe të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Parashikoj mundësinë e paraqitjes së kërkesës në mënyrë elektronike si dhe komunikimin elektronik në përgjithësi. <p>Të ndryshohen rregulloret komunale për taksat dhe tarifa nga komunat në pjesën që ka të bëjë me taksat administrative për leje ndërtimi dhe të njëjtat të përcaktohen në pajtim me LPPA dhe LSSL.</p> <p>Pagesat duhet të bëhen në fund të procesit dhe me një dokument të vetëm ndërsa forma dhe mënyrat mund të jenë: në mënyrë klasike,</p>	<ol style="list-style-type: none"> Ndryshimi i Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve duhet të bëhet me qëllim që informatat dhe dokumentet që janë në dispozicion të organit/ve publike të sigurohen nga vet organi publik e jo pala (neni 86, par. 3 i LPPA) më tutje ky udhëzim duhet të ndryshohet edhe për të mundësuar paraqitjen e kërkesës në mënyrë elektronike për të lehtësuar komunikimin e palës në përgjithësi. Kushtëzimi i pagesës së tatimit në pronë kufizon në mënyrë arbitrare një të drejtë themelore siç është drejta e ndërtimit. Inkasimi i tatimit pronë duhet të bëhet në mënyrë efektive sipas rregullave të LPPA dhe nuk ka nevojë që të vendosen kushtëzime të tilla. Rekomandimet për ndryshimin e rregulloreve komunale për caktimin e taksave administrative dhe tarifave justifikohen sepse

		<p>administrati ve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tarifa për ndikim nga rritja e densitetit të infrastrukturës (p.sh rasti i Prishtinë 4.30 €/m² për hapsirat deri 450 m². • Pagesat mund të bëhen edhe këste • Pagesat behën nga pala fizikisht ne banke 		<p>përmes e-banking, përmes POS. Pagesa me këste duhet të vazhdoj të ekzistoj.</p>	<p>disa nga to janë të pajustificueshme dhe në kundërshtim me nenin 12 të LPPA dhe LSSL.</p> <p>4. Propozimi që pagesë të bëhet në fund të procesit rekomandohet të bëhet me qëllim të zvogëlimit të frekuencës së lartë që e ka pala duke paguar veç e veç por edhe në mënyrë klasike pa pas mundësi pagese në mënyra tjera përmes e-banking, POS, etj.</p>
<p>Leje e ndërtimit - kategoria II</p>	<p>Baza Ligjore: Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Neni 15, shtojca 2</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopja e planit dhe Çertifikata e pronësisë të pronarit/pronarëve të parcelës/ave (dëshmia mbi pronën jo më e vjetër se 6 muaj në formatin origjinal ose të fotokopjuar dhe të vërtetuar nga noteri. Kopjet e planit të parcelave kadastrale duhet të jenë të harmonizuara me vektorët kadastral) [Pikë e vetme e kontaktit]. 2. Taksa për aplikim [Pala]. 3. Vërtetimi i tatimit në pronë të pronarit/bashkë-pronarëve të parcelës/ave dhe investitorit [Pala]. 4. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pronarit/bashkë-pronarëve të parcelës/ave dhe investitorit [Pala]. 	<p>Baza ligjore: Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës, neni 4, paragrafi 1.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Taksa Administrati ve e cila caktohet nga secila komune me akt të saj. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesa për lejen e ndërtimit duhet të paraqitet nga pala në mënyrë fizike 2. Dokumentet që sipas Udhëzimit Administrativ përcaktohet që ofrohen nga One Stop Shop të njëjtat në praktikë sigurohet nga pala 3. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë është kusht obligativ që duhet të plotësohet. 4. Dokumentet nga pika 4 edhe pse janë në dispozicion të organeve publike kërkohen nga pala. 5. Kushtet ndërtimore kërkohen nga pala ndërsa të njëjtat janë miratuar nga organi publik 6. Pëlqimet në pikën 10 që lëshohen nga ndërmarrjet publike (KEDS, KUR, PTK etj) duhet të sigurohen nga pala (në praktikë këto i kushtëzojnë palët me pagesën e borxhit nëse pala ka borxh tek to) 7. Pagesa e taksave shumë e lartë dhe e pajustificueshme dhe në kundërshtim me LPPA dhe LSSL 	<p>Ndryshimi i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve të ndryshohet si në vijim</p> <p>Neni 15, shtojca 3 në këto pika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Informatat në pikën 1, 4, 5, 10,11, 12 të sigurohen nga vet organi kompetent pa pas nevojë që të dëshmohen me dokumente. 2. Pagesa e tatimit në pronë nuk duhet të jetë informatë e obligueshme dhe e njëjta duhet të fshihet. 3. Pëlqimet nga ndërmarrjet publike të sigurohen nga vet organi publik. <p>Neni 12 të ndryshohet dhe të:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndryshimi i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve duhet të behet me qëllim që informatat dhe dokumentet që janë në dispozicion të organit/ve publike të sigurohen nga vet organi publik e jo pala (neni 86, par. 3 i LPPA) më tutje ky udhëzim duhet të ndryshohet edhe për të mundësuar paraqitjen e kërkesës në mënyrë elektronike për të lehtësuar komunikimin e palës në përgjithësi.

	<ol style="list-style-type: none"> 5. Kushtet Ndërtimore dhe informata mbi planin të leshuara paraprakisht nga DUNMM – kopje [Pikë e vetme e kontaktit]. 6. Kontrata /marrveshja e noterizuar e pronarëve me investitorin për bashkë-investim [Pala]. 7. Marrëveshja për zgjidhje urbane e vërtetuar tek noteri (kur ky dokument nuk posedohet te kushtet ndërtimore) [Pala]. 8. Incizimi gjeodezik me ndërtesë/ndërtesa të pozicionuar/a në sistemin koordinativ shtetëror Kosova Ref.01 (Nga kompania e licensuar gjeodezike) [Pala]. 9. Projekti kryesor me të gjitha fazat në 3 kopje, në harmoni me rregulloret relevante në fuqi për norma teknike [Pala]. 10. Pëlqimet nga kompanitë publike (KEDS, UR"Prishtina", Termokos, PTK, etj) [Pikë e vetme e kontaktit]. 11. Pëlqimin për vlerësimin e ndikimit në mjedis [Pikë e vetme e kontaktit]. 12. Elaboratin dhe pëlqimin e mbrojtjes kundër zjarrit (ky dokument lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme) [Pikë e vetme e kontaktit]. 13. Elaborati gjeomekanik i truallit dhe sigurimit të gropës - (projekt nga kompania e licensuar të dorëzohet në lidhje të fortë) [Pala]. 14. Elaborati i organizimit të punishtës (kompania e licensuar- opcional) [Pala]. 15. Plani Dinamik i Ndërtimit dhe i mbikqyrjes inspektuese (nga kompania e licensuar- opcional) [Pala]. 16. Elaborati i Fizikes së Ndërtimit dhe aplikimi i masave për Eficiencë të Energjise – (nga kompania e licensuar) [Pala]. 17. Pëlqimet e noterizuara nga fqinjët në rast se parashihet të ndërtohet ndërtesa në kufi të parcelës [Pala]. 18. Nëse ndonjë parcelë kadastrale është në hipoteke-peng, paraprakisht të sigurohet pëlqimi nga pengmarrësi [Pala]. 	<ul style="list-style-type: none"> • P.sh Komuna e Prishtinës taksën administrative për kategorinë e I-rë e ka 6.50 €/m² ku 3.85€/m² janë për shqyrtim të aplikacionit ndërsa 2.65€/m² për mbikëqyrje administrative. • Tarifa për ndikim nga rritja e densitetit të infrastrukturës (p.sh rasti i Prishtinës 10.70€/m² për. • Pagesat mund të behen edhe këste • Pagesat behen nga pala fizikisht ne banke 		<ol style="list-style-type: none"> 4. Parashikoj mundësinë e paraqitjes së kërkesës në mënyrë elektronike si dhe komunikimin elektronik në përgjithësi. <p>Të ndryshohen rregulloret komunale për taksat dhe tarifa nga komunat në pjesën që ka të bëjë me taksat administrative për leje ndërtimi dhe të njëjtat të përcaktohen në pajtim me LPPA dhe LSSL.</p> <p>Pagesat duhet të bëhen në fund të procesit dhe me një dokument të vetëm ndërsa forma dhe mënyrat mund të jenë: në mënyrë klasike, përmes e-banking, përmes POS. Pagesa me këste duhet të vazhdojë të ekzistoj.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 2. Kushtëzimi i pagesës së tatimit në pronë kufizon në mënyrë arbitrare një të drejtë themelore siç është drejta e ndërtimit. Inkasimi i tatimit pronë duhet të bëhet në mënyrë efektive sipas rregullave të LPPA dhe nuk është proporcionale të vendosen kushtëzime të tilla. 3. Rekomandimet për ndryshimin e rregulloreve komunale për caktimin e taksave administrative dhe tarifave justifikohen sepse disa nga to janë të pajustificueshme dhe në kundërshtim me nenin 12 të LPPA dhe LSSL. 4. Propozimi që pagesë të bëhet në fund të procesit rekomandohet të bëhet me qëllim të zvogëlimit të frekuencës së lartë që e ka pala duke paguar veç e veç por edhe në mënyrë klasike pa pas mundësi pagese në mënyra tjera përmes e-banking, POS, etj.
--	---	---	--	--	--

	<p>19. Gabaritet e ndërtesës dhe tabela e kalkulimeve të sipërfaqeve përmbajtëse për kalkulimin të taksave [Pala].</p> <p>20. Fotografi te lokacionit (duke përfshirë parcelën dhe ndërtesat përreth deri në diametër prej 50m) [Pala].</p> <p>21. Për ndërtesat në pronësi publike, shtetërore, universitare, komunale, fetare etj., të sigurohet pëlqimi nga organi kompetent [Pala].</p> <p>22. Në rastet e komplekseve të ndërtesave dhe realizimit me faza, duhet të prezentohen dokumentacionet e lejeve dhe aktvendimet e taksave dhe tarifave të densitetit për Ndërtesat e realizuara në fazat e mëhershme [Pala].</p> <p>23. Dëftesë pagesa e taksës komunale [Pala].</p>				
<p>Njohja e studimeve themelore (Bachelor)</p>	<p>Baza ligjore: <i>Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 12/2018: Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 6:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Një kërkesë me shkrim për njohje/barasvlerë të diplomës e cila merret në NARIC dhe protokollohet në arkivin e MASHT [Pala]. Formularin e plotësuar që merret në NARIC [Pala]. Fletëpagesën [Pala]. Një kopje të dokumentit të identifikimi [Pala] Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të diplomës [Pala]. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të transkriptit/certifikatës së notave [Pala]. Një përmbledhje të përkthyer të punimit-tezës (ndërmjet 3-5 faqe kur punimi është në gjuhë jozyrtare të Republikës së Kosovës [Pala]. Programin e studimeve për vitet kur janë kryer studime [Pala]. Shtojcën e diplomës (SHD) (me rastin e aplikimit) [Pala]. 	<p>Baza ligjore: <i>Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 12/2018: Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 12, pika 2.1:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 30 euro – Shkollat e larta profesionale dhe niveli Bachelor/studimet themelore 	<ol style="list-style-type: none"> Informatat nën 1 dhe 2 duhet të jenë një dokument dhe si kërkesë të bëhet online përmes faqes së NARIC Kosova; Informata/kërkesa 3 (taksa administrative) në vlerë 30 euro është më e lartë se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës dhe është në kundërshtim me LPPA (Neni 12 i LPPA); Informata 4 është po ashtu në kundërshtim me LPPA pasi kjo duhet të mbulohet përmes komunikimit të databazave të institucioneve publike, pra nuk ka nevojë të sigurohet nga pala; Informata/kërkesa 5 është i panevojshëm të noterizohet kur diploma në origjinal kërkohet të shikohet. Për më shumë, diploma vërtetohet edhe pas komunikimit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës; Informata/kërkesa 6 është po ashtu i panevojshëm të noterizohet, në këtë rast duhet dorëzuar origjinal i 	<p>Ndryshimi i Nenit 6, pika 1 sa i përket dokumenteve të nevojshme dhe Nenit 12, pika 2.1 sa i përket taksës administrative sipas sqarimeve në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> Dokumentet nën 1 dhe 2 duhet të integrohen në një dokument dhe të jetë online përmes faqes së NARIC Kosova; Dokumenti 3 duhet të jetë në përputhje me LPPA dhe të merret për bazë kosto mesatare e shërbimit/procedurës për caktimin e lartësisë së taksës; Dokumenti nën 4 duhet të fshihet si kërkesë sepse kjo duhet të merret nga ARC nga vet institucioni, në këtë rast NARIC Kosova; Dokumenti nën 5 duhet të fshihet si kërkesë pasi kjo mbulohet me faktin e dërgimit të diplomës për shikim dhe me faktin e komunikimit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës; Dokumenti nën 6 duhet të jetë kërkesë për transkriptin origjinal 	<ol style="list-style-type: none"> Rekomandimet e dhëna për ndryshimin e UA nr. 12/2018, përkatësisht Nenit 6, pika 1 dhe Nenit 12, pika 2.1 sa i përket koston administrative bëhen me qëllim të lehtësimit të procedurës për palën dhe reduktimin e barrës administrative. Shumica e dokumenteve të kërkuar mund të eliminohen në procedurë sepse në disa raste, ato mund a) të bëhen online (psh kërkesa dhe formulari), b) të integrohen (dokumenti 1 dhe 2), b) të fshihen për shkak se organet duhet t'i sigurojnë në mes veti përmes komunikimit të brendshëm dhe c) janë të panevojshme sepse nuk mbrojnë interes publik dhe sigurimi i tyre nga pala nuk shton vërtetësinë/saktësinë në dosjen e aplikantit.

	<p>10. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të diplomës origjinale të studimeve për nivelet e shkollimit paraprak [Pala].</p> <p>11. Në rast se dokumentet (apo ndonjëri prej tyre) të cekura më lartë, nuk janë në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës ato duhet të përkthehen në një nga gjuhët zyrtare nga një përkthyes i autorizuar në Republikën e Kosovës [Pala].</p> <p>12. Dokumentet e dorëzuara për njohje nuk i kthehen aplikuesit;</p> <p>13. Në rast se dokumentacioni i dorëzuar nga pala nuk është i kompletuar, për këtë NARIC duhet ta njoftojë palën me shkrim që brenda afatit prej 30 ditësh ta kompletoj dosjen, në të kundërtën nëse dokumentacioni nuk plotësohet sipas afatit të paraparë, dosja arkivohet si e pakompletuar dhe pala obligohet të riaplikojë për njohje/barasvlerë;</p> <p>14. KSHNJ mund të vendos t'ia kthejë dosjen qendrën NARIC, për plotësime të nevojshme në dokumentacionin sipas këtij UA. Në rast se kërkohen dokumente shtesë, pala është e obliguar të sjellë dokumentet e kërkuara;</p> <p>15. Në mungesë të ndonjë nga dokumentet e kërkuara sipas Nenit 6, pika 1, kërkesa për njohje nuk do të pranohet nga NARIC.</p> <p>16. Në rast se pala aplikon për njohje/barasvlerë të një kualifikimi më të lartë, paraprakisht duhet të aplikojë për njohje/barasvlerë të kualifikimeve, diplomave të studimeve paraprake të fituara jashtë Republikës së Kosovës, (Bachelor dhe Master). Në rast se palës i është njohur kualifikimi paraprak, duhet të sjellë dëshminë [Pala].</p>		<p>transkriptit të notave i cili lëshohet nga shkolla/Universiteti përkatës;</p> <p>6. Informata/kërkesa 7 është i panevojshëm sepse mjafton diploma dhe certifikata e notave. Po ashtu, përgatitja e punimit-tezës nuk është i aplikueshëm për studimet themelore (Bachelor);</p> <p>7. Informata/kërkesa 9 (shtojca e diplomës) dorëzohet me automatizëm në momentin kur dërgohet diploma për shikim, dhe dorëzohet një kopje e saj bashkë me shtojcën;</p> <p>8. Informata/kërkesa 10 është i panevojshëm për shkak se në këtë rast nuk janë me rëndësi studimet paraprake të aplikuesit. Kjo çështje është konsumuar me faktin e pranimit të aplikuesit në Universitetin ku ka ndjekur studimet themelore (Bachelor);</p> <p>9. Kërkesa nën 15 është e panevojshme ngase mbulohet nga kërkesa nën 13;</p> <p>10. Kërkesa nën 16 është e panevojshme sepse është çështje e aplikuesit cilin nivel të studimeve apo cilën diplomë dëshiron ta njohë në Kosovë. Po ashtu, kjo nuk duhet të aplikohet kur bëhet fjalë për njohje të studimeve themelore (Bachelor) sepse studimet paraprake janë ato të shkollës së mesme. Po ashtu, vërtetësia/saktësia e studimeve paraprake është mbuluar me vet faktin e pranimit të aplikuesit në studime themelore;</p>	<p>të notave të cilin zakonisht Universitetet i lëshojnë kandidatit deri në 3 kopje origjinale pas përfundimit, pikërisht për qëllim të aplikimit për studime tutje në Universitete tjera apo për njohje në vendin përkatës;</p> <p>6. Dokumenti nën 7 duhet të fshihet si kërkesë për shkak se mbulohet përmes dorëzimit të pjesës tjetër të dokumenteve apo dëshmime (si diploma dhe transkripta e notave) dhe për nivelin e studimeve themelore zakonisht nuk aplikohet shkrimi i tezës;</p> <p>7. Dokumenti nën 9 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi çdo aplikues që ka shtojcë të diplomës e dorëzon atë bashkë me diplomën;</p> <p>8. Dokumenti nën 10 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi është kushtëzim dhe nuk lidhet me subjektin; Aplikuesi mund të aplikojë për njohje të cilitdo nivel të studimeve pa paragjykuar nëse ka kryer studimet paraprake apo jo; Kjo është mbuluar me vet faktin e regjistrimit të personit në nivelin Bachelor, sikur mos të kishte studimet paraprake ose diçka të barasvlershme, Universiteti përkatës nuk do ta pranonte në studimet Bachelor;</p> <p>9. Kërkesa nën 15 duhet të fshihet pasi mbulohet nga pika 13;</p> <p>10. Kërkesa nën pikën 16 po ashtu duhet të fshihet ashtu sic është sqaruar për dokumentin/kërkesën nën 10 më lartë;</p>	<p>3. Po ashtu, procedura si e tillë bje në kundërshtim me parimin e “vetëm një herë”, pra pala duhet të frekuentojë disa herë administratën publike deri në kompletimin e dosjes.</p> <p>4. Pastaj, kërkesa për noterizim të diplomës dhe certifikatës së notave duhet të eliminohen si hapa në procedurë sepse të njëjtat vërtetohen me mjete tjera, p.sh. përmes kontaktit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës. Po ashtu, certifikata e notave posedohet origjinal dhe dorëzohet si e tillë sepse në origjinal ofrohet nga Universiteti ku pala ka përfunduar studimet.</p> <p>5. Pastaj, taksa administrative në vlerë 30 EUR është më e lartë se sa kosto mesatare për kryerje të procedurës të paraparë me LPPA.</p>
Njohja e diplomës Master	Baza ligjore: Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 12/2018: Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të	Baza ligjore: Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr.	1. Dokumentet nën 1 dhe 2 duhet të jenë një dokument dhe si kërkesë të bëhet online përmes faqes së NARIC Kosova;	Ndryshimi i Nenit 6, pika 1 sa i përket dokumenteve të nevojshme dhe Nenit 12, pika 2.2 sa i përket	1. Rekomandimet e dhëna për ndryshimin e UA nr. 12/2018, përkatësisht Nenit 6, pika 1 dhe Nenit

<p>shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 6</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Një kërkesë me shkrim për njohje/barasvlerë të diplomës e cila merret në NARIC dhe protokollohet në arkivin e MASHT [Pala]. 2. Formularin e plotësuar që merret në NARIC [Pala]. 3. Fletëpagesën [Pala]. 4. Një kopje të dokumentit të identifikimi [Pala] 5. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të diplomës [Pala]. 6. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të transkriptit/certifikatës së notave [Pala]. 7. Një përmbledhje të përkthyer të punimit-tezës (ndërmjet 3-5 faqe kur punimi është në gjuhë jozyrtare të Republikës së Kosovës [Pala]. 8. Programin e studimeve për vitet kur janë kryer studime [Pala]. 9. Shtojcën e diplomës (SHD) (me rastin e aplikimit) [Pala]. 10. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të diplomës origjinale të studimeve për nivelet e shkollimit paraprak [Pala]. 11. Në rast se dokumentet (apo ndonjëri prej tyre) të cekura më lartë, nuk janë në një të njërit nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës ato duhet të përkthehen në një nga gjuhët zyrtare nga një përkthyes i autorizuar në Republikën e Kosovës [Pala]. 12. Dokumentet e dorëzuara për njohje nuk i kthehen aplikuesit; 13. Në rast se dokumentacioni i dorëzuar nga pala nuk është i kompletuar, për këtë NARIC duhet ta njoftojë palën me shkrim që brenda afatit prej 30 ditësh ta kompletoj dosjen, në të kundërtën nëse dokumentacioni nuk plotësohet sipas afatit të paraparë, dosja arkivohet si e pakompletuar dhe pala obligohet të riaplikojë për njohje/barasvlerë; 14. KSHNJ mund të vendos t'ia kthejë dosjen qendrën NARIC, për plotësime të nevojshme në dokumentacionin sipas këtij 	<p>12/2018: Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 12, pika 2.2</p> <ul style="list-style-type: none"> • 50 euro – Master 	<ol style="list-style-type: none"> 2. Dokumenti 3 (taksa administrative) në vlerë 50 euro është më e lartë se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës (Neni 12 i LPPA); 3. Dokumenti 4 është në kundërshtim me LPPA pasi kjo duhet të mbulohet përmes komunikimit të databazave të institucioneve publike, pra nuk ka nevojë të sigurohet nga pala; 4. Dokumenti 5 është i panevojshëm të noterizohet kur diploma në origjinal kërkohej të shikohet. Për më shumë, diploma vërtetohet edhe pas komunikimit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës; 5. Dokumenti 6 është po ashtu i panevojshëm të noterizohet, në këtë rast duhet dorëzuar origjinal i transkriptit të notave i cili lëshohet nga shkolla/Universiteti përkatës; 6. Dokumenti 7 është i panevojshëm sepse mjafton diploma dhe certifikata e notave; 7. Dokumenti 8 është po ashtu i panevojshëm sepse diploma dhe certifikata e notave janë të mjaftueshme për të treguar programin; 8. Dokumenti 9 (shtojca e diplomës) dorëzohet me automatizëm në momentin kur dërgohet diploma për shikim, dhe dorëzohet një kopje e saj bashkë me shtojcën; 9. Dokumenti 10 është i panevojshëm për shkak se në këtë rast nuk janë me rëndësi studimet paraprake të aplikuesit. Kjo çështje është konsumuar me faktin e pranimit të aplikantit në Universitetin ku ka fituar gradën master; 10. Kërkesa nën 15 është e panevojshme ngase mbulohet nga kërkesa nën 13; 11. Kërkesa nën 16 është e panevojshme sepse është çështje e aplikuesit cilin nivel të studimeve apo cilën diplomë 	<p>taksës administrative sipas sqarimeve në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentet nën 1 dhe 2 duhet të integrohen në një dokument dhe të jetë online përmes faqes së NARIC Kosova; 2. Dokumenti 3 duhet të jetë në përputhje me LPPA dhe të merret për bazë kosto mesatare e shërbimit/procedurës për caktimin e lartësisë së taksës; 3. Dokumenti nën 4 duhet të fshihet si kërkesë sepse kjo duhet të merret nga ARC nga vet institucioni, në këtë rast NARIC Kosova; 4. Dokumenti nën 5 duhet të fshihet si kërkesë pasi kjo mbulohet me faktin e dërgimit të diplomës për shikim dhe me faktin e komunikimit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës; 5. Dokumenti nën 6 duhet të jetë kërkesë për transkriptin origjinal të notave të cilin zakonisht Universitetet i lëshojnë kandidatit deri në 3 kopje origjinale pas përfundimit, pikërisht për qëllim të aplikimit për studime tutje në Universitete tjera; 6. Dokumenti nën 7 duhet të fshihet si kërkesë për shkak se është i panevojshëm dhe mbulohet përmes dorëzimit të pjesës tjetër të dokumenteve/dëshmimeve (si diploma dhe transkripta e notave); 7. Dokumenti nën 8 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi mbulohet transkriptit të notave; 8. Dokumenti nën 9 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi çdo aplikues që ka shtojcë të 	<ol style="list-style-type: none"> 12, pika 2.2 sa i përket koston administrative bëhen me qëllim të lehtësimit të procedurës për palën dhe reduktimin e barrës administrative. 2. Shumica e dokumenteve të kërkuar mund të eliminohen në procedurë sepse në disa raste, ato mund a) të bëhen online (p.sh. kërkesa dhe formulari), b) të integrohen (dokumenti 1 dhe 2), b) të fshihen për shkak se organet duhet t'i sigurojnë në mes veti përmes komunikimit të brendshëm dhe c) janë të panevojshme sepse nuk mbrojnë interes publik dhe sigurimi i tyre nga pala nuk shton ndonjë vërtetësi më të madhe apo vlerë të shtuar në dosjen e aplikantit. 3. Po ashtu, procedura si e tillë bje në kundërshtim me parimin “vetëm një herë”, pra pala duhet të frekuentojë disa herë administratën publike deri në kompletimin e dosjes. 4. Pastaj, kërkesa për noterizim të diplomës dhe certifikatës së notave duhet të eliminohen si hapa në procedurë sepse të njëjtat vërtetohen me mjete tjera, p.sh. përmes kontaktit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës. Po ashtu, certifikata e notave posedohet origjinal dhe dorëzohet si e tillë
---	---	--	---	---

	<p>UA. Në rast se kërkohen dokumente shtesë, pala është e obliguar të sjellë dokumentet e kërkuara;</p> <p>15. Në mungesë të ndonjë nga dokumentet e kërkuara sipas Nenit 6, pika 1, kërkesa për njohje nuk do të pranohet nga NARIC.</p> <p>16. Në rast se pala aplikon për njohje/barasvlerë të një kualifikimi më të lartë, paraprakisht duhet të aplikojë për njohje/barasvlerë të kualifikimeve, diplomave të studimeve paraprake të fituara jashtë Republikës së Kosovës, (Bachelor dhe Master). Në rast se palës i është njohur kualifikimi paraprak, duhet të sjellë dëshminë [Pala].</p>		<p>dëshiron ta njohë në Kosovë. Nëse për qëllimin e aplikuesit mjafton njohja diplomës, master, nuk ka arsye që i njëjti të aplikojë paraprakisht për njohje të studimeve paraprake nëse ato janë kryer po ashtu jashtë vendit;</p>	<p>diplomës e dorëzon atë bashkë me diplomën;</p> <p>9. Dokumenti nën 10 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi është kushtëzim dhe nuk lidhet me subjektin; Aplikuesi mund të aplikojë për njohje të cilitdo nivel të studimeve pa paragjykuar nëse ka kryer studimet paraprake apo jo; Kjo është mbuluar me vet faktin e regjistrimit të personit në nivelin Master, sikur mos të kishte studimet themelore ose diçka të barasvlershme, Universiteti përkatës nuk do ta pranonte në studimet Master;</p> <p>10. Kërkesa nën 15 duhet të fshihet pasi mbulohet nga pika 13;</p> <p>11. Kërkesa nën pikën 16 po ashtu duhet të fshihet ashtu siç është sqaruar për dokumentin/kërkesën nën 10 më lartë;</p>	<p>sepse në original ofrohet nga Universiteti ku pala ka përfunduar studimet.</p> <p>5. Pastaj, taksa administrative në vlerë 50 EUR është më e lartë se sa kosto mesatare për kryerje të procedurës të paraparë me LPPA.</p>
<p>Njohja e diplomës së Doktorra tës</p>	<p>Baza ligjore: Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 12/2018: Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, Neni 6</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Një kërkesë me shkrim për njohje/barasvlerë të diplomës e cila merret në NARIC dhe protokollohet në arkivin e MASHT [Pala]. 2. Formularin e plotësuar që merret në NARIC [Pala]. 3. Fletëpagesën [Pala]. 4. Një kopje të dokumentit të identifikimi [Pala] 5. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të diplomës [Pala]. 6. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të transkriptit/certifikatës së notave [Pala]. 7. Një përmbledhje të përkthyer të punimit-tezës (ndërmjet 3-5 faqe kur punimi është në gjuhë jozyrtare të Republikës së Kosovës [Pala]. 	<p>Baza ligjore: Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr. 12/2018: Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, Neni 12, pika 2.3:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 70 euro – Doktoratë 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentet nën 1 dhe 2 mund të jenë një dokument dhe si kërkesë të bëhet online përmes faqes së NARIC Kosova; 2. Dokumenti 3 (taksa administrative) në vlerë 70 euro është më e lartë se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës (Neni 12 i LPPA); 3. Dokumenti 4 është në kundërshtim me LPPA pasi kjo duhet të mbulohet përmes komunikimit të databazave të institucioneve publike, pra nuk ka nevojë të sigurohet nga pala; 4. Dokumenti 5 është i panevojshëm të noterizohet kur diploma në origjinal kërkohet të shikohet. Për më shumë, vërtetësia e diplomës sigurohet edhe pas komunikimit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës; 5. Dokumenti 6 është po ashtu i panevojshëm të noterizohet, në këtë rast duhet dorëzuar origjinal i 	<p>Ndryshimi i Nenit 6, pika 1 sa i përket dokumenteve të nevojshme dhe Nenit 12, pika 2.2 sa i përket taksës administrative sipas sqarimeve në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dokumentet nën 1 dhe 2 duhet të integrohen në një dokument dhe të sigurohen e dorëzohen online përmes faqes së NARIC Kosova; 2. Dokumenti 3 duhet të jetë në përputhje me LPPA dhe të merret për bazë kosto mesatare e shërbimit/procedurës për caktimin e lartësisë së taksës; 3. Dokumenti nën 4 duhet të fshihet si kërkesë sepse kjo duhet të merret nga ARC nga vet institucioni, në këtë rast NARIC Kosova; 4. Dokumenti nën 5 duhet të fshihet si kërkesë pasi kjo mbulohet me faktin e dërgimit të diplomës për 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rekomandimet e dhëna për ndryshimin e UA nr. 12/2018, përkatësisht Neni 6, pika 1 dhe Neni 12, pika 2.3 sa i përket koston administrative bëhen me qëllim të lehtësimit të procedurës për palën dhe reduktimin e barrës administrative. 2. Shumica e dokumenteve të kërkuar mund të eliminohen në procedurë sepse në disa raste, ato mund a) të bëhen online (p.sh. kërkesa dhe formulari), b) të integrohen (dokumenti 1 dhe 2), b) të fshihen për shkak se organet duhet t'i sigurojnë në mes veti përmes komunikimit të brendshëm dhe c) janë të

<p>8. Programin e studimeve për vitet kur janë kryer studime [Pala].</p> <p>9. Shtojcen e diplomës (SHD) (me rastin e aplikimit) [Pala].</p> <p>10. Një kopje të vërtetuar ose noterizuar të diplomës origjinale të studimeve për nivelet e shkollimit paraprak [Pala].</p> <p>11. Në rast se dokumentet (apo ndonjëri prej tyre) të cekura më lartë, nuk janë në njërin nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës ato duhet të përkthehen në një nga gjuhët zyrtare nga një përkthyes i autorizuar në Republikën e Kosovës [Pala].</p> <p>12. Dokumentet e dorëzuara për njohje nuk i kthehen aplikuesit;</p> <p>13. Në rast se dokumentacioni i dorëzuar nga pala nuk është i kompletuar, për këtë NARIC duhet ta njoftojë palën me shkrim që brenda afatit prej 30 ditësh ta kompletoj dosjen, në të kundërtën nëse dokumentacioni nuk plotësohet sipas afatit të paraparë, dosja arkivohet si e pakompletuar dhe pala obligohet të riaplikojë për njohje/barasvlerë;</p> <p>14. KSHNJ mund të vendos t'ia kthejë dosjen qendrën NARIC, për plotësime të nevojshme në dokumentacionin sipas këtij UA. Në rast se kërkohen dokumente shtesë, pala është e obliguar të sjellë dokumentet e kërkuara;</p> <p>15. Në mungesë të ndonjë nga dokumentet e kërkuara sipas Nenit 6, pika 1, kërkesa për njohje nuk do të pranohet nga NARIC.</p> <p>16. Në rast se pala aplikon për njohje/barasvlerë të një kualifikimi më të lartë, paraprakisht duhet të aplikojë për njohje/barasvlerë të kualifikimeve, diplomave të studimeve paraprake të fituara jashtë Republikës së Kosovës, (Bachelor dhe Master). Në rast se palës i është njohur kualifikimi paraprak, duhet të sjellë dëshminë [Pala].</p>		<p>transkriptit të notave i cili lëshohet nga shkolla/Universiteti përkatës ku ka studiuar aplikuesi;</p> <p>6. Dokumenti 7 është i panevojshëm sepse mjafton diploma dhe certifikata e notave;</p> <p>7. Dokumenti 8 është po ashtu i panevojshëm sepse diploma dhe certifikata e notave janë të mjaftueshme për të treguar edhe programin;</p> <p>8. Dokumenti 9 (shtojca e diplomës) dorëzohet me automatizëm në momentin kur dërgohet diploma për shikim, dhe dorëzohet një kopje e saj bashkë me shtojcën;</p> <p>9. Dokumenti 10 është i panevojshëm për shkak se në këtë rast nuk janë me rëndësi studimet paraprake të aplikuesit. Kjo çështje është shterruar me faktin e pranimit të aplikuesit në Universitetin ku ka fituar gradën (dokorratën);</p> <p>10. Kërkesa nën 15 është e panevojshme ngase mbulohet nga kërkesa nën 13;</p> <p>11. Kërkesa nën 16 është e panevojshme sepse është çështje e aplikuesit cilin nivel të studimeve apo cilën diplomë dëshiron ta njohë në Kosovë. Nëse për qëllimin e aplikuesit mjafton njohja diplomës, së doktorratës, nuk ka arsye që i njëjti të aplikojë paraprakisht për njohje të studimeve Master;</p>	<p>shikim dhe me faktin e komunikimit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës;</p> <p>5. Dokumenti nën 6 duhet të jetë kërkesë për transkriptin origjinal të notave në rast se një i tillë ekziston pasi shumë Universitete/programe nuk kanë provime në studime të doktorratës. Po ashtu, në rastet kur është, kjo duhet të jetë certifikatë origjinale e notave sikurse në rastin e studimeve Master;</p> <p>6. Dokumenti nën 7 duhet të fshihet si kërkesë për shkak se është i panevojshëm dhe mbulohet përmes dorëzimit të pjesës tjetër të dokumenteve/dëshmimeve (si diploma dhe transkripta e notave – kur kjo e fundit ekziston në studime të doktorratës);</p> <p>7. Dokumenti nën 8 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi mbulohet transkriptit të notave;</p> <p>8. Dokumenti nën 9 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi çdo aplikues që ka shtojcë të diplomës e dorëzon atë bashkë me diplomën;</p> <p>9. Dokumenti nën 10 po ashtu duhet të fshihet si kërkesë pasi është kushtëzim dhe nuk lidhet me subjektin; Aplikuesi mund të aplikojë për njohje të cilitdo nivel të studimeve pa paragjykuar nëse ka kryer studimet paraprake apo jo; Kjo është mbuluar me vet faktin e regjistrimit të personit në doktoraturë, sikur mos të kishte studimet Master ose diçka të barasvlershme, Universiteti përkatës nuk do ta pranonte në studimet e doktorratës;</p>	<p>panevojshme sepse nuk mbrojnë interes publik dhe sigurimi i tyre nga pala nuk shton ndonjë vërtetësi më të madhe apo vlerë të shtuar në dosjen e aplikuesit.</p> <p>3. Po ashtu, procedura si e tillë bije në kundërshtim me parimin “vetëm një herë”, pra pala duhet të frekuentojë disa herë administratën publike deri në kompletimin e dosjes.</p> <p>4. Pastaj, kërkesa për noterizim të diplomës dhe certifikatës së notave duhet të eliminohen si hapa në procedurë sepse të njëjtat vërtetohen me mjete tjera, p.sh. përmes kontaktit të NARIC Kosova me NARIC të vendit përkatës. Po ashtu, certifikata e notave posedohet origjinal dhe dorëzohet si e tillë (në rastet kur e njëjta ekziston për studimet e doktorratës) sepse në origjinal ofrohet nga Universiteti ku pala ka përfunduar studimet.</p> <p>5. Pastaj, taksa administrative në vlerë 70 EUR është më e lartë se sa kosto mesatare për kryerje të procedurës të paraparë me LPPA.</p>
---	--	--	---	--

				<p>10. Kërkesa nën 15 duhet te fshihet pasi mbulohet nga pika 13;</p> <p>11. Kërkesa nën pikën 16 po ashtu duhet të fshihet ashtu sic është sqaruar për dokumentin/kërkesën nën 10 më lartë;</p>	
<p>Aplikimi për letërnjoftim (duke përfshirë rastin e humbjes/vjedhjes, konfiskimit apo dëmtimit të letërnjoftimit) - për personat nga mosha 16 deri 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç;</p>	<p>Baza ligjore: Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 05/2018 për Procedurat e Pajisjes me Letërnjoftim, neni 4, nga 16 deri në 18 vjeç:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ekstrakti i lindjes në origjinal për shikim, kurse të dorëzojë një kopje të tij; OSE Pasaportën dhe të dorëzojë një kopje të tij [Pala]. Në rast të humbjes, vjedhjes së letërnjoftimit, raportin/vërtetimin policor origjinal apo kopjen e noterizuar nga origjinali. Nëse raporti është në gjuhë të huaj, përkthehet në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës [Pala]. Në rast të konfiskimit të letërnjoftimit, brenda ose jashtë vendit, kërkohet raporti për konfiskim të letërnjoftimit. Nëse raporti është në gjuhë të huaj, duhet të jetë i përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare. Nëse nuk ka raport, duhet t'i merret një deklaratë plotësuese – sqaruese aplikuesit [Pala]. Letërnjoftimin ose pasaportën me anë të të cilës dëshmohet identiteti i prindit, origjinal për shikim, kurse të dorëzohet një kopje e tij [Pala]. Nëse aplikuesi ka lindur jashtë territorit të Kosovës, mirëpo ka fituar shtetësinë e Kosovës, duhet të paraqesë dëshminë e identitetit të prindërve dhe vendimin për fitimin e shtetësisë [Pala]. Në rast se ka mos përputhje të të dhënave në mes të ekstraktit që prezanton aplikuesi, dhe të dhënave që janë gjeneruar me futjen në sistem të numrit personal të aplikuesit në momentin e aplikimit, aplikuesi duhet të shkojë në Zyrën e Gjendjes Civile për të korrigjuar të dhënat [Pala]. Shtypet fletëpagesa me të cilën aplikuesi kryen pagesën, të cilën nuk është i detyruar 	<p>Taksa administrative nuk shkruan në UA</p>	<ol style="list-style-type: none"> Ekstrakti i lindjes kërkohet edhe pse vet ARC e lëshon atë. ARC mund të gjenerojë vet të dhënat e ekstraktit me paraqitjen e palës në administratë; Vërtetimi policor në rast të humbjes apo vjedhjes së letërnjoftimit, është i nevojshëm por këtë ARC duhet ta sigurojë përmes komunikimit të databazave në mes ARC-së dhe Policisë. Në momentin që pala e ka paraqitur rastin në polici, shënimet e dhënë në polici duhet të gjenerojnë raportin automatikisht në ARC; Ekstrakti i lindjes i gjeneruar sipas pikës 1 më lartë, tregon edhe të dhënat për prindërit e palës. Po ashtu, ARC mund të gjenerojë edhe të dhënat e prindit ose prindërve të palës në momentin e aplikimit të palës. Vendimi për fitimin e shtetësisë mund të sigurohet nga ARC përmes komunikimit të të dhënave brenda sistemit; Në rast se ka mospërputhje të të dhënave, vet ARC në komunikim me Zyrën e Gjendjes Civile duhet ta rregullojë atë, nuk ka nevojë pala të shkojnë në Zyrën e Gjendjes Civile të korrigjojë ato; Në momentin e tërheqjes së letërnjoftimit, nuk duhet të kërkohet prape raporti i policisë sepse ky hap është shterur më herët dhe duhet të sigurohet nga vet ARC; 	<p>Ndryshimi i Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 05/2018 për Procedurat e Pajisjes me Letërnjoftim sipas sqarimeve në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ekstrakti i lindjes nuk duhet të kërkohet kur vet ARC e lëshon këtë dokument; Vërtetimi policor nuk duhet të kërkohet nga pala, i njëjti duhet të gjenerohet nga ARC përmes komunikimit me databazën e Policisë. Dmth në momentin që vjedhja/humbja është lajmëruar në polici, shënimet nga policia duhet të gjenerohen në sistem dhe të merren nga ARC. Letërnjoftimi ose pasaporta për të dëshmuar identitetin e prindit nuk duhet kërkuar sepse ekstrakti i lindjes i gjeneruar më herët nga vet ARC përmban të dhëna edhe për identitetin e prindërve; Vendimi për fitimin e shtetësisë nuk duhet të kërkohet nga pala, sepse vet ARC mund të sigurojë këtë dokument përmes komunikimit të databazave në mes të institucioneve përkatëse; Në rast të mos përputhjes së të dhënave, po ashtu nuk duhet kërkuar nga pala që të shkojë në Zyrën e Gjendjes Civile për korrigjim të të dhënave. Të dhënat duhet të jenë të njëjta si në këtë zyrë ashtu edhe në ARC, prandaj ARC duhet të marrë përsipër këtë komunikim 	<ol style="list-style-type: none"> Rekomandimet e dhëna për ndryshimin e UA nr. 05/2018, përkatësisht Nenit 4 janë bërë me qëllim të lehtësimit të procedurës për palën dhe reduktimin e barrës administrative. Në këtë kuadër, rekomandimi për të mos kërkuar ekstraktin e lindjes lidhet me atë se vet ARC e lëshon këtë dokument dhe nuk duhet kërkuar nga pala një dokument që e lëshon vet institucioni. Rekomandimi për eliminimin e kërkesës për dorëzim fizikisht të raportit policor nga pala ka të bëjë me komunikimin e databazave në mes të dy institucioneve përmes platformës së interoperabilitetit. Po ashtu, qarkullimi i palës nëpër disa institucione për të kompletuar dokumentet është në kundërshtim me parimin “vetëm një herë” dhe me LPPA sipas të cilit institucioni nuk duhet të kërkojë nga pala informata të cilat në administratën publike dhe sigurohen përmes komunikimit të databazave të institucioneve.

<p>ta kthejë si dëshmi në QDP (me përjashtim të rasteve të procedurës së përshpejtuar apo rasteve mjekësore) [Pala].</p> <p>8. Aplikuesi merr dëshminë e aplikimit dhe njoftohet nga zyrtari i QDP-së mbi kohën dhe mënyrën e tërheqjes së letërnjoftimit [Pala].</p> <p>2. Tërheqja e letërnjoftimit bëhet nga vet aplikuesi duke prezantuar dy dokumente: 1) Letërnjoftimin paraprak (nëse e ka pasur) dhe 2) Raportin e policisë në rast të humbjes/vjedhjes së letërnjoftimit pas aplikimit [Pala].</p>			<p>(vërtetim i të dhënave) e mos të ngarkohet pala të qarkullojë nëpër institucione të ndryshme;</p> <p>6. Në momentin e tërheqjes së letërnjoftimit, nuk duhet kërkuar nga pala raportin e policisë nëse arsye e aplikimit për letërnjoftim ka qenë humbja/vjedhja e letërnjoftimit sepse kjo fazë tashmë është zëvendësuar me komunikim të shënimeve në mes të ARC dhe Policisë;</p>	<p>4. Po ashtu, rekomandimi që pala nuk duhet të shkojë në Zyrë të Gjendjes Civile dhe ARC për korrigjim të të dhënave lidhet me komunikimin në mes të dy organeve për të shkëmbyer të dhënat që raporti në mes të palës dhe administratës duhet të jetë në kuadër të parimit “vetëm një herë”.</p>
<p>Baza ligjore: Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 05/2018 për Procedurat e Pajisjes me Letërnjoftim, neni 5, mbi 18 vjeç:</p> <p>1. Ekstraktin e lindjes në origjinal për shikim, kurse të dorëzojë një kopje të tij; OSE Pasaportën dhe të dorëzojë një kopje të tij nëse nuk ka ndërrim të të dhënave [Pala].</p> <p>2. Në rast të humbjes, vjedhjes së letërnjoftimit, raportin/vërtetimin policor origjinal apo kopjen e noterizuar nga origjinali. Nëse raporti është në gjuhë të huaj, përkthehet në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës [Pala].</p> <p>3. Në rast të konfiskimit të letërnjoftimit, brenda ose jashtë vendit, kërkohet raporti për konfiskim të letërnjoftimit. Nëse raporti është në gjuhë të huaj, duhet të jetë i përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare. Nëse nuk ka raport, duhet t’i merret një deklaratë plotësuese – sqaruese aplikuesit [Pala].</p> <p>4. Në rast se ka mos përputhje të të dhënave në mes të ekstraktit që prezanton aplikuesi, dhe të dhënave që janë gjeneruar me futjen në sistem të numrit personal të aplikuesit në momentin e aplikimit, aplikuesi duhet të shkojë në Zyrën e Gjendjes Civile për të korrigjuar të dhënat [Pala].</p> <p>5. Shtypet fletëpagesa me të cilën aplikuesi kryen pagesën, të cilën nuk është i detyruar ta kthejë si dëshmi në QDP (me përjashtim të rasteve të procedurës së përshpejtuar apo rasteve mjekësore) [Pala].</p>	<p>Taksa administrative nuk shkruan në UA;</p>	<p>1. Ekstrakti i lindjes kërkohet edhe pse vet ARC e lëshon atë. ARC mund të gjenerojë vet të dhënat e ekstraktit me paraqitjen e palës në administratë;</p> <p>2. Vërtetimi policor në rast të humbjes apo vjedhjes së letërnjoftimit, është i nevojshëm por këtë ARC duhet ta sigurojë përmes komunikimit të databazave në mes ARC-së dhe Policisë. Në momentin që pala e ka paraqitur rastin në polici, shënimet e dhënë në polici duhet të gjenerojnë raportin automatikisht në ARC;</p> <p>3. Ekstrakti i lindjes i gjeneruar sipas pikës 1 më lartë, tregon edhe të dhënat për prindërit e palës. Po ashtu, ARC mund të gjenerojë edhe të dhënat e prindit ose prindërve të palës në momentin e aplikimit të palës.</p> <p>4. Vendimi për fitimin e shtetësisë mund të sigurohet nga ARC përmes komunikimit të të dhënave brenda sistemit;</p> <p>5. Në rast se ka mospërputhje të të dhënave, vet ARC në komunikim me Zyrën e Gjendjes Civile duhet ta rregullojë atë, nuk ka nevojë pala të shkojnë në Zyrën e Gjendjes Civile të korrigjojë ato;</p> <p>6. Në momentin e tërheqjes së letërnjoftimit, nuk duhet të kërkohet</p>	<p>Ndryshimi i Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 05/2018 për Procedurat e Pajisjes me Letërnjoftim sipas sqarimeve në vijim:</p> <p>1. Ekstrakti i lindjes nuk duhet të kërkohet kur vet ARC e lëshon këtë dokument;</p> <p>2. Vërtetimi policor nuk duhet të kërkohet nga pala, i njëjti duhet të gjenerohet nga ARC përmes komunikimit me databazën e Policisë. Dmth në momentin që vjedhja/humbja është lajmëruar në polici, shënimet nga policia duhet të gjenerohen në sistem dhe të merren nga ARC.</p> <p>3. Letërnjoftimi ose pasaporta për të dëshmuar identitetin e prindit nuk duhet kërkuar sepse ekstrakti i lindjes i gjeneruar më herët nga vet ARC përmban të dhëna edhe për identitetin e prindërve;</p> <p>4. Vendimi për fitimin e shtetësisë nuk duhet të kërkohet nga pala, sepse vet ARC mund të sigurojë këtë dokument përmes komunikimit të databazave në mes të institucioneve përkatëse;</p> <p>5. Në rast të mos përputhjes së të dhënave, po ashtu nuk duhet</p>	<p>1. Rekomandimet e dhëna për ndryshimin e UA nr. 05/2018, përkatësisht Neni 5 janë bërë me qëllim të lehtësimit të procedurës për palën dhe reduktimin e barrës administrative.</p> <p>2. Në këtë kuadër, rekomandimi për të mos kërkuar ekstraktin e lindjes lidhet me atë se vet ARC e lëshon këtë dokument dhe nuk duhet kërkuar nga pala një dokument që e lëshon vet institucioni.</p> <p>3. Rekomandimi për eliminimin e kërkesës për dorëzim fizikisht të raportit policor nga pala ka të bëjë me komunikimin e databazave në mes të dy institucioneve përmes platformës së interoperabilitetit. Po ashtu, qarkullimi i palës nëpër disa institucione për të kompletuar dokumentet është në kundërshtim me parimin “vetëm një herë” dhe me LPPA sipas të cilit institucioni nuk duhet të kërkojë nga pala informata</p>

	<p>6. Aplikuesi merr dëshminë e aplikimit dhe njoftohet nga zyrtari i QDP-së mbi kohën dhe mënyrën e tërheqjes së letërnjoftimit [Pala].</p> <p>7. Tërheqja e letërnjoftimit bëhet nga vet aplikuesi duke prezantuar dy dokumente: 1) Letërnjoftimin paraprak (nëse e ka pasur) dhe 2) Raportin e policisë në rast të humbjes/vjedhjes së letërnjoftimit pas aplikimit [Pala].</p>		<p>prape raporti i policisë sepse ky hap është shterur më herët dhe duhet të sigurohet nga vet ARC;</p>	<p>kërkuar nga pala që të shkojë në Zyrën e Gjendjes Civile për korrigjim të të dhënave. Të dhënat duhet të jenë të njëjta si në këtë zyrë ashtu edhe në ARC, prandaj ARC duhet të marrë përsipër këtë komunikim (vërtetim i të dhënave) e mos të ngarkohet pala të qarkullojë nëpër institucione të ndryshme;</p> <p>6. Në momentin e tërheqjes së letërnjoftimit, nuk duhet kërkuar nga pala raportin e policisë nëse arsye e aplikimit për letërnjoftim ka qenë humbja/vjedhja e letërnjoftimit sepse kjo fazë tashmë është zëvendësuar me komunikim të shënimeve në mes të ARC dhe Policisë;</p>	<p>të cilat në administratën publike dhe sigurohen përmes komunikimit të databazave të institucioneve.</p> <p>4. Po ashtu, rekomandimi që pala nuk duhet të shkojë në Zyrë të Gjendjes Civile dhe ARC për korrigjim të të dhënave lidhet me komunikimin në mes të dy organeve për të shkëmbyer të dhënat që raporti në mes të palës dhe administratës duhet të jetë në kuadër të parimit “vetëm një herë”.</p>
<p>Certifikata e rezidencës tatimore</p>	<p><i>Baza ligjore: Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) me vendet përkatëse</i></p> <p><i>Dokumentet e nevojshme dhe procedura për aplikim:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikacioni – Kërkesë për Certifikatë të Rezidencës Tatimore (CRT) [Pala]. 2. Ekstrakti i lindjes [Pala]. 3. Kopje e pasaportës, ose kopje e letërnjoftimit [Pala]. 4. Kontrata [Pala]. 5. Tërheqja e CRT [Pala]. 	<p>Nuk ka</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikacioni – kërkesa për Certifikatë të Rezidencës Tatimore (CRT) është online në faqe të ATK-së, plotësohet online, mirëpo shënimet nuk ruhen dhe duhet printuar për t’u dorëzuar fizikisht në Arkivin ATK-së në Drejtorinë Qendrore; 2. Ekstrakti i lindjes është i panevojshëm të dorëzohet sepse në kërkesën për CRT, pala kërkohet të shënojë numrin personal dhe atë fiskal. Këto janë të dhëna të mjaftueshme për të gjeneruar të dhënat tjera që janë në ekstrakt të lindjes, por që në këtë rast edhe janë të panevojshme; 3. Kopje pasaportës ose letërnjoftimit prape është i panevojshëm sepse të dhënat e nevojshme vetëm se janë ofruar përmes kërkesës për CRT. Po ashtu, kopja e pasaportës apo letërnjoftimit nuk duhet të kërkohet nga institucioni i administratës shtetërore ndaj palës, mirëpo vet ATK duhet të sigurojë (nëse është e nevojshme) atë nga databaza e ARC-së përmes komunikimit të të dhënave 	<ol style="list-style-type: none"> 1. METD-të nuk ka nevojë të ndryshohen sepse kërkesat eksplicite (procedura e aplikimit për CRT) nuk është e përshkruar në METD. Kjo e fundit shërben vetëm si bazë në frymën e neneve të së cilës kërkohet nga ATK pajisja me CRT. 2. Aplikacioni (kërkesa) për CRT duhet të jetë i mundshëm të dërgohet online. Pra, të digjitalizohet shërbimi përmes faqes së ATK-së (pjesa e shërbimeve elektronike). Gjatë plotësimit të aplikacionit, në fund të tij duhet të jetë mundësia e ngarkimit (upload) të kontratës – e cila është subjekt i kërkesës së CRT-së; 3. Dokumentet tjerë (nën 2 dhe 3) janë të panevojshëm sepse janë të dhënë tashmë në ATK dhe po ashtu AK mund të marrë ato nga regjistri civil (të shërbehet me të dhëna të ARC-së). 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rekomandimet janë dhënë në kuadër të eliminimit të hapave të panevojshëm në procedurë, pra me qëllim reduktimin e barrës administrative për qytetarët. Po ashtu, në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve si objektivë e Qeverisë në kuadër të ofrimit të shërbimeve administrative me cilësi të lartë. 2. Kontakti me administratën disa herë nga pala, është në kundërshtim me parimin e ofrimit të shërbimeve “vetëm një herë” (once only principle). Po ashtu, kërkesa për të dorëzuar dokumente që mund të sigurohen brenda administratës shtetërore përmes komunikimit të databazave në mes të

			<p>në mes të institucioneve. Po ashtu, kërkesa që një dokument të dorëzohet nga pala, të cilin e ka administrata shtetërore, është në kundërshtim me LPPA;</p> <p>4. Kontrata është në rregull të kërkohe, mirëpo kjo duhet të dorëzohet duke u “ngarkuar” online në aplikacionin që plotësohet si kërkesë për CRT. Pra, kërkesa për CRT (aplikacioni) duhet të dorëzohet online dhe pjesë e aplikacionit duhet të ekzistojë mundësia që kontrata të “ngarkohet” (upload) në të njëjtin vend.</p> <p>5. CRT tërhiqet (pranohet) fizikisht nga pala në një ditë dhe kohë të caktuar në të njëjtin vend ku është dorëzuar kërkesa, mirëpo pala duhet të marrë atë online – sipas mënyrës së njëjtë – siç është aplikuar;</p>	<p>4. Tërheqja po ashtu duhet të eliminohet si hap në procedurë sepse CRT duhet të pranohet online nga pala – ashtu siç edhe është aplikuar.</p>	<p>institucioneve, është në kundërshtim me LPPA;</p>
<p>Certifikata (vula) apostile</p>	<p>Baza Ligjore: Rregullore (QRK) – nr. 19/2016 për lëshimin e certifikatës apostile:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Caktimi i terminit online (emri, mbiemri, numri personal) – [Pala]. 2. Kërkesa/formulari për certifikatë (vulë) apostile – plotësohet nga zyrtari që lëshon vulën apostile, nënshkruhet nga Pala; 3. PAGESA sipas fletëpagesës dhënë nga zyrtari që lëshon vulën apostile (tarifa apostile) 10 euro – [Pala]. 4. Dorëzimi i dëshmisë së pagesës [Pala]. 5. Shqyrtimi i kërkesës sa më shpejtë që është e mundur, jo më gjatë se tre (3) ditë nga momenti i dorëzimit të kërkesës; 6. Tërheqja e certifikatës (vulës) apostile – [Pala] (mund të dërgohet edhe me postë, mbulimi i shpenzimeve bëhet nga pranuesi). 	<p>Baza Ligjore: Rregullore (QRK) – nr. 19/2016 për lëshimin e certifikatës apostile, Neni 14 (Tarifat për shërbimet e apostilës)</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullorja 19/2016 nuk përcakton mënyrën e caktimit të terminit për parashtrimin e kërkesës për certifikatë (vulë) apostile, mirëpo në ueb faqe të MPJD ekziston mënyra e caktimit online të terminit për vulë apostile duke dhënë emrin, mbiemrin dhe numrin personal. 2. Formulari unik dhe i standardizuar i kërkesës për vulë apostile nuk është online. Sipas Nenit 7, pika 2.8 e Rregullores 19/2016, formulari plotësohet nga zyrtari përgjegjës për lëshimin e vulës apostile dhe nënshkruhet nga pala. Formulari kërkon plotësimin e të dhënave në shtatë (7) vende që zyrtari i merr nga pala që aplikon. 3. Pala merr fletëpagesën në shumën 10 euro të cilën e paguan në një nga institucionet e licencuara për pagesa, në llogari të BRK-së, të cilën si dëshmi, pala duhet ta kthejë në vendin e aplikimit për vulë apostile; 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Formulari (kërkesa) për certifikatë (vulë) apostile duhet të jetë online, pra formulari unik standard duhet të digjitalizohet dhe palët t’a plotësojnë atë online, njëjtë sikurse që bëhet paraprakisht caktimi i terminit për dorëzimin e kërkesës. Opsion është edhe shkrimi e dy fazave në një, caktimi i terminit dhe plotësimi i kërkesës/formularit të jenë një proces. 2. Kjo do të reduktonte procedurën edhe nga ana e palës edhe e zyrtarit përgjegjës për lëshimin e vulës. Ky i fundit nuk do të kishte nevojë të plotësojë formularin për palën në momentin që pala aplikon, kjo kursen kohë dhe eliminon radhët për aplikim; 3. PAGESA duhet të jetë e mundur po ashtu online, menjëherë pas përfundimit të plotësimit të formularit standard, duhet të vijë faza e pagesës online. PAGESA nuk 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Formulari nuk ka arsye të mos jetë online. Kjo është në përputhje me LPPA, Neni 73 – Forma dhe përmbajtja e kërkesës; 2. Tarifa apostile prej 10 euro është në kundërshtim me LPPA, parimin e mospagimit të procedurës i cili përcakton se për palën, procedura administrative është pa pagesë përveç rasteve kur parashihet ndryshe me ligj të veçantë (LPPA, Neni 12). Tarifa apostile nuk është e përcaktuar me ligj të veçantë. 3. Njoftimi për lëshimin (eventualisht refuzimin e vulës) duhet të kryhet me mjete të përshtatshme, në përputhje me LPPA (Rregullat e përgjithshme 	

			<p>4. Zyrtari përgjegjës për lëshimin e vulës apostile fillon shqyrtimin e procesit i cili duhet të kryhet sa më shpejtë, por jo më gjatë se tre (3) ditë.</p> <p>5. Rregullorja nuk përcakton se si njoftohet pala se kur duhet të paraqitet për tërheqje të vulës apostile;</p> <p>6. Tërheqja e certifikatës (vulës) apostile nga pala, një i afërm i tij, apo nga një person i autorizuar (nëse pala nuk ka kërkuar që ta pranojë atë përmes postës).</p>	<p>duhet të jetë 10 euro sepse është shumë mbi mesataren e kostos së shërbimit, një vule apostile dhe procedura për lëshimin e saj nuk kanë kosto prej 10 euro. Kjo e eviton nevojën për lëshim të fletëpagesë, kryerje të pagesës në një vend tjetër dhe nevojën për sjellje të dëshmisë së pagesës. Kjo nënkupton reduktim të procedurave për palën dhe zyrtarin përgjegjës për lëshimin e vulës apostile;</p> <p>4. Tërheqja e certifikatës mund të bëhet nga pala, i afërm i tij/saj apo nga një person i autorizuar. D.m.th. vetëm ky hap në procedurë mund të bëhet fizikisht, mirëpo kjo nuk shkakton radhë (pritje) sepse pala kontakton administratën vetëm sa për ta tërhequr certifikatën (vulën) apostile. Megjithatë, në një fazë më vonë duhet të ekzistojë mundësia e lëshimit të E-apostilës (Neni 3, pika 1.10) e cila mundësohet përmes Programit Elektronik për Apostile (e-APP). Me këtë i tërë procesi do të ishte online, si aplikimi ashtu edhe tërheqja e vulës apostile në formën online.</p>	<p>të të njoftuarit) dhe pala duhet të paraqitet vetëm një herë në administratë për tërheqjen e vulës apostile. Kjo është në përputhje me parimin e “vetëm një herë” që aplikohet me rastin e tërheqjes së vulës apostile nga pala. Megjithatë, në një fazë të mëvonshme, MPJD duhet të krijojë sistemin e-APP (sistemi elektronik për apostile) dhe vula apostile të jetë e online (e-apostile) që nënkupton se vula apostile është lëshuar në format elektronik e shoqëruar me nënshkrim elektronik.</p>
--	--	--	---	--	--

PASAPORTA E TREGUESVE

Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027

Qëllimi i përgjithshëm: Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative

Treguesi 1	Kursimet kumulative të qytetarëve dhe bizneseve pas zvogëlimit të barrës administrative	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi jep vlerën e kursimeve pas thjeshtimit administrativ, por edhe pas digjitalizimit. Arritja e këtij treguesi matet me Modelin e Kostimit Standard, duke marrë për bazë elementet e theksuara në pjesën narrative të Programit.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor për zbatimin e Programit dhe matjet pas hyrjes në fuqi të akteve juridike cak i thjeshtimit apo pas digjitalizimit të shërbimeve përkatëse (të cilat do të jenë pjesë e raportit).	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet pas hyrjes në fuqi të akteve juridike të cilat janë cak i thjeshtimit administrativ. Pra, përcaktohet vlera bazë në formën e vjetër të shërbimit, pastaj pas ndryshimeve të bëra në aktet juridike, maten rezultatet. Siç janë theksuar në Program, elementet për thjeshtim janë dokumentet, informatat, pagesat, kushtëzimet administrative, vlefshmëria, etj., të cilat pas thjeshtimit kalkuloohen dhe nxjerret kosto e kursyer. Duhet theksuar se në këtë matje të përgjithshme, do të hyjnë kursimet nga zbatimi i të gjitha masave të Planit të Veprimit të Programit. Po ashtu, për shkak të evidentimit të zvogëlimit të buxhetit si pasojë e uljes së pagesave për marrjen e shërbimeve administrative, do të kalkulohet ndaras me anë të Modelit të Kostimit Standard.	
Vlera bazë dhe viti	Vlera bazë e këtij treguesi është vendosur si 0, përkundër faktit që disa prej masave sipas Shtojcës 1 të Programit janë zbatuar nga Zyra Ligjore e ZKM me mbështetjen e IFC-së gjatë përgatitjes së Programit, në vitin 2022, që ka rezultuar me kursime për qytetarët dhe bizneset. Mirëpo, në raportin e parë vjetor të zbatimit të këtij PV, do të merren parasysh edhe ato rezultate.	Viti 2021
Caqet dhe vitet	> 1 mil. €	Viti 2023
	> 6 mil. €	Viti 2024
Treguesi 2	Licencat dhe lejet për biznese	

Përshkrimi i treguesit	Treguesi mbulon vetëm një pjesë të shërbimeve publike administrative, si pjesë e Planit të Veprimit, konkretisht vetëm lejimet, duke treguar perceptimin për mjedisin e biznesit në vend. Treguesi vlerën më të lartë e ka 5, që nënkupton se bizneset mendojnë se nuk ka barrë fare, ndërsa vlerën më të ulët e ka 1, që nënkupton se ka shumë barrë.	
Burimi i të dhënave	Barometri i Ballkanit – Opinioni i bizneseve	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Treguesi matet duke marrë intervista të rëndomta në bizneset e Kosovës. Pyetjet kanë të bëjnë për pengesa të shumta si numri i procedurave, të dhënave, letrave, shpenzimeve, qasshmëria në dokument, kompleksiteti ligjor, ryshfeti, mungesa e digjitalizimit, etj.	
Vlera bazë dhe viti	2.7	Viti 2022
	3	Viti 2023
Caqet dhe vitet	>3	Viti 2024

Masa 1: Thjeshtimi dhe digjitalizimi shërbimeve administrative në nivel qendror

Treguesi 1	Numri i shërbimeve administrative, të thjeshtuara	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mbulon shërbimet administrative apo lejimet të mbuluara nga shtojca 1 dhe 2 e Programit. Po ashtu, ky treguesi mbulon edhe shërbimet të cilat priten të analizohen dhe të jenë shtojca të këtij Programi. Pas përfundimit të tyre, analizat do të mbulojnë rreth 450 shërbime administrative, respektivisht lejime të cilat ofrohen nga niveli qendror.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor për zbatimin e Programit	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet pas hyrjes në fuqi të akteve juridike cak i thjeshtimit administrativ, në shtojcë 1 dhe 2 të këtij Programi, si dhe shtojcave tjera të ngjashme në ardhje. Pra, treguesi mat performancën institucionale – apo kalkulimin i shërbimeve të thjeshtuara. Ndërsa, kursimet në kohë dhe para, do të kalkuloohen për matjen e treguesit 1 të qëllimit të përgjithshëm. Siç janë theksuar në Program, elementet për thjeshtim janë dokumentet, informatat, pagesat, kushtëzimet administrative, vlefshmëria, etj. Po ashtu, duhet theksuar se thjeshtim nënkupton edhe eliminim i tërësishëm i një informate të obligueshme dhe bashkim me një tjetër. Pra, cilado nga elementet që identifikohet si e nevojshme për thjeshtimin e shërbimit, përfaqëson thjeshtim. 44 është vlera bazë për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 synohet që kjo vlerë të ngritet në 150, ndërsa në vitin 2024 në 250.	
Vlera bazë dhe viti	44	Viti 2022
	150	Viti 2023
Caqet dhe vitet	250	Viti 2024

Treguesi 2	Numri i shërbimeve administrative, të digjitalizuara	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mbulon shërbimet administrative apo lejimet të mbuluara nga shtojcat 1 dhe 2 e këtij. Po ashtu, ky treguesi mbulon edhe shërbimet të cilat priten të analizohen dhe të jenë shtojca të këtij Programi. Pas përfundimit të tyre, analizat do të mbulojnë rreth 450 shërbime administrative, respektivisht lejime të cilat ofrohen nga niveli qendror, digjitalizimi i të cilave do të jetë pjesë e matjes së arritjes së këtij treguesi.	
Burimi i të dhënave	Platforma E-Kosova apo platformat tjera elektronike dhe Raporti vjetor për zbatimin e Programit	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet me anë të publikimit të shërbimeve të digjitalizuara në platformën E-Kosova apo në ndonjë platformë tjetër elektronike të institucioneve në nivel qendror. Duhet theksuar se digjitalizimi i një shërbimi nënkupton nga aplikimi deri në pritje të përgjigjes nga ana e administratës publike. Në vitin 2023 synohet që E-Kosova të pasurohet me mbi 50 shërbime të tilla, ndërsa në vitin 2024, ky numër të rritet në mbi 150 sosh.	
Vlera bazë dhe viti	0	Viti 2022
Caqet dhe vitet	>50	Viti 2023
	>150	Viti 2024
Treguesi 3	Skemat sociale në MFPT, të digjitalizuara	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi përfshinë digjitalizimin e të gjitha skemave sociale në kuadër të MFPT.	
Burimi i të dhënave	Platforma E-Kosova dhe Raporti i zbatimit të Programit	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet me anë të publikimit të skemave sociale të digjitalizuara në platformën E-Kosova.	
Vlera bazë dhe viti	2	Viti 2022
Caqet dhe vitet	12	Viti 2023
	28	Viti 2024
Treguesi 4	Përqindja e bizneseve që përdorin faturën elektronike në raport me bizneset që kanë për obligim ligjor.	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi dëshmon gjithëpërfshirjen bizneseve në lëshimin e faturave elektronik. Nëpërmjet sistemit të faturës elektronike sigurohen mjetet dhe ndërfaqet për tatimpaguesit që të dërgojnë, marrin dhe miratojnë faturat online, të nënshkruajnë faturat në mënyrë digjitale brenda sistemit tatimor dhe nga sistemet e jashtme të kontabilitetit, duke i lejuar zyrtarët e ATK-së (dhe institucionet tjera relevante) që t'i shikojnë këto fatura dhe t'i përdorin ato për operacione dhe analiza të mëtejshme.	
Burimi i të dhënave	Raportet vjetore të punës së ATK-se!	
Shpeshtësia	Tremujori i parë i vitit 2024 dhe 2025.	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet duke shpalosur informata të gatshme në sistemin informativ të ATK-së.	
Vlera bazë dhe viti	0	Viti 2022

Caqet dhe vitet	30%	Viti 2023
	90%	Viti 2024
Treguesi 5	Numri i bizneseve të fiskalizuara nëpërmjet platformës softuerike për menaxhim të parasë se gatshme ne krahasim me vitet paraprake	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi dëshmon gjithëpërfshirjen bizneseve në përdorimin e pajisjeve me sisteme softuerike për menaxhimin e shitjeve me para të gatshme. Nëpërmjet kësaj platforme do të bëhet e mundur që fiskalizimi të bëhet pjesë përbërëse e qasjes efektive të Menaxhimit të Riskut të Përbushjes në ATK. Përveç kësaj, pritjet janë që do të ndikojë në ngritjen e të hyrave dhe përmirësimin e sjelljes së tatimpaguesve ndaj përbushjes.	
Burimi i të dhënave	Raportet vjetore të punës së ATK-së.	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet duke shpalosur informata të gatshme në sistemin informativ të ATK-së.	
Vlera bazë dhe viti	0	Viti 2022
Caqet dhe vitet	>8000	Viti 2023
	>15000	Viti 2024
Treguesi 6	Numri i shërbimeve administrative të ATK të integruara në E-Kosova, në krahasim me vitet paraprake	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi numëron shërbimet administrative të ATK-së të cilat ridrejtohen në platformën E-Kosova, duke kursyer kohën e tatimpaguesve për marrjen e shërbimeve përkatëse.	
Burimi i të dhënave	Platforma E-Kosova, Raportet e ATK dhe Raporti për zbatimin e Programit.	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesi behet ne baze te numrit te shërbimeve plotësisht te digjitalizuar dhe ridrejtuar ne portalin e shërbimeve e-Kosova	
Vlera bazë dhe viti	0	Viti 2022
Caqet dhe vitet	5	Viti 2023
	15	Viti 2024

Masa 2: Thjeshtimi i shërbimeve administrative të përzgjedhura duke u bazuar në ngjarje reale

Treguesi 1	Ulja e kohës së kërkuar për kompletimin e procedurës së aplikimit për shërbimet e përzgjedhura veç-e-veç	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mbulon shërbimet administrative apo shërbimet e përzgjedhura në shtojcën 3 të Programit. Treguesi tregon kohën e kursyer për kompletimin e procedurës pas thjeshtimit dhe digjitalizimit të shërbimit administrativ.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor për zbatimin e Programit për vitin 2023 dhe Platforma E-Kosova.	
Shpeshtësia	Fundi i vitit 2023 (apo tremujori i parë i vitit 2024).	

Metodologjia	Matja e treguesit bëhet pas hyrjes në fuqi të akteve juridike cak i thjeshtimit administrativ (për cakun 2023) dhe digjitalizimit të shërbimeve administrative (caku 2024). Nga eliminimi i informatave, dokumenteve dhe pagesave të panevojshme dhe në kundërshtim me ligjin, do të maten kursimi i kohës së procedurës pas zbatimit të rekomandimeve ligjore të dhëna në shtojcën 3. Matjet do të bëhen me Modelin e Kostimit Standard.	
Vlera bazë dhe viti	Vlera bazë e këtij treguesi do të përcaktohet gjatë gjashtëmujorit të parë të Planit të Veprimit, gjatë vitit 2022.	Viti 2022
Caqet dhe vitet	20%	Viti 2023
	40%	Viti 2024

Masa 3: Rritja e koordinimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative

Treguesi 1	Numri i zyrtarëve publikë të trajnuar për barrë administrative	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi dëshmon ngritjen e kapaciteteve për barrë administrative në nivel qendror dhe lokal.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor i zbatimit të Programit dhe Raporti vjetor i IKAP	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet me pjesëmarrës në trajnime në IKAP, me modulën e ri të barrës administrative.	
Vlera bazë dhe viti	0	Viti 2022
Caqet dhe vitet	>200	Viti 2023
	>400	Viti 2024
Treguesi 2	Të gjitha ministrinë e linjës, agjencitë ekzekutive relevante dhe komunat, e kanë caktuar personin përgjegjës për barrë administrative	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi dëshmon koordinimin dhe përkushtimin për koordinimin e procesit të barrës administrative në nivel qendror dhe lokal.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor i zbatimit të Programit (lista e personave përgjegjës si shtojcë)	
Shpeshtësia	Gjashtëmujori i parë	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet me pjesëmarrës në takime të përbashkëta për koordinimin e procesit të barrës administrative.	
Vlera bazë dhe viti	JO (TM2 2022)	Viti 2022
Caqet dhe vitet	PO (TM3 2022)	Viti 2022
	/	

Masa 4: Thjeshtimi i shërbimeve administrative në nivelin lokal

Treguesi 1	Numri i komunave shërbimet e të cilave janë thjeshtuar
-------------------	--

Përshkrimi i treguesit	Treguesi dëshmon gjithëpërfshirjen e komunave në procesin e barrës administrative. Deri në fund të vitit 2022 në proces janë të përfshira katër komuna, ndërsa në vitin 2023 parashihet që ky numër të rritet edhe për pesë të tjera.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor i zbatimit të Programit.	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet me anë të analizave të kryera për secilën komunë dhe miratimin e tyre nga Kuvendet Komunale. Ndërsa rezultatet e zbatimit të tyre, hyjnë në treguesin e parë të qëllimit të përgjithshëm.	
Vlera bazë dhe viti	2	Viti 2022
Caqet dhe vitet	6	Viti 2023
	10	Viti 2024

Masa 5: Rritja e komunikimit dhe ngritja e vetëdijes për barrë administrative

Treguesi 1	% e të anketuarve nga qytetarët dhe bizneset që kanë njohuri dhe janë të kënaqur me mbarëvajtjen e procesit të zvogëlimit të barrës administrative	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi dëshmon gjithëpërfshirjen e bizneseve dhe qytetarëve në procesin e barrës administrative, nëpërmjet konsultimit të reformës dhe në komunikimin e rezultateve.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor i zbatimit të Programit.	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet nëpërmjet anketës për biznese dhe qytetarë, e cila do të realizohet me anë të mënyrave të ndryshme, qoftë elektronike nëpërmjet platformës E-Kosova dhe plotësimit të anketës gjatë aplikimit, qoftë fizikisht nëpërmjet takimeve dhe mbledhjeve të mbajtura me qytetarë, shoqëri civile dhe përfaqësues të biznesit. Për këtë, do të pyeten rëndom së paku 100 qytetarë dhe së paku 100 biznese (apo përfaqësuesit e tyre).	
Vlera bazë dhe viti	Vlera bazë e këtij treguesi do të përcaktohet gjatë gjashtëmujorit të parë të Planit të Veprimit, gjatë vitit 2022.	Viti 2022
Caqet dhe vitet	>30%	Viti 2023
	>50%	Viti 2024
Treguesi 2	% e të anketuarve në administratën publike që kanë njohuri për barrën administrative dhe efektet e saj	
Përshkrimi i treguesit	Treguesi dëshmon gjithëpërfshirjen dhe ngritjen e vetëdijes të zyrtarëve publikë në procesin e barrës administrative.	
Burimi i të dhënave	Raporti vjetor i zbatimit të Programit.	
Shpeshtësia	Çdo vit	
Metodologjia	Matja e treguesit bëhet nëpërmjet mënyrave të ndryshme, duke veçuar anketën elektronike të dërguar nëpërmjet ASHI. Po ashtu, siç është theksuar edhe në pjesën narrative të trajnimit, të gjithë zyrtarët që do të	

	trajnohen për barrë administrative, do t'i nënshtrohen anketës, pas përfundimit të trajnimit.	
Vlera bazë dhe viti	Vlera bazë e këtij treguesi do të përcaktohet gjatë gjashtëmujorit të parë të Planit të Veprimit, gjatë vitit 2022.	Viti 2022
Caqet dhe vitet	>50%	Viti 2023
	>70%	Viti 2024

Vlerësimi i Rrezikut

Sistemi i propozuar i analizës së rrezikut fokusohet ekskluzivisht në ato veprime ose grup veprimesh, të planifikuara në kuadër të Masave në kuadër të PPZBA, me pasoja negative në ndikimin e përgjithshëm të zvogëlimit të barrës administrative.

	Masa	Rreziku	Ndikimi	Modaliteti për tejkalimin e rrezikut
1.	Thjeshtimi dhe digjitalizimi i shërbimeve administrative në nivel qendror	Mungesa e kapaciteteve në institucionet koordinuese	Rrezik mesëm duke shkuar kah rreziku i lartë	Fuqizimi i kapaciteteve në Zyrën për Planifikim Strategjik, Zyrën Ligjore dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit.
		Koordinim jo i mirë dhe kapacitete të dobëta për Planifikim në institucionet e linjës		Rritja e vetëdijes te niveli vendimmarrës nëpërmjet Komisionit për Planifikim Strategjik
2.	Thjeshtimi i shërbimeve administrative të përzgjedhura duke u bazuar në ngjarje reale	Përfshirja e pamjaftueshme e institucioneve të linjës	I ulët	Trajnimet specifike për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative
		Mungesa e njohurive për qasjen e ngjarjeve reale		Rritja e vetëdijes te niveli vendimmarrës nëpërmjet Komisionit për Planifikim Strategjik
3.	Rritja e koordinimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative	Kapacitetet e dobëta në institucionet e linjës për aplikimin e metodologjisë për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative	Rrezik i ulët duke shkuar kah rreziku i lartë	Trajnimet specifike për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, duke përfshirë metodologjinë si dhe hartimi i udhëzuesve specifik për zbatimin e metodologjisë
		Mungesa e kapaciteteve në institucionet e linjës për përdorimin e Modelit të Kostimit Standard		Trajnimet specifike për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative, duke përfshirë Modelin e Kostimit Standard dhe zhvillimi i udhëzimeve për përdorimin e MKS
4.	Thjeshtimi i shërbimeve administrative në nivelin lokal	Mungesa e kapaciteteve nëpër komuna për planifikimi dhe koordinimi jo i mirë me nivelin qendror	I lartë	Trajnimet specifike për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative për zyrtarët e komunave
		Rezistenca administrative për ndryshim të sjelljes praktike dhe në harmoni me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative		Ngritja e vetëdijes të zyrtarëve të komunës për barrën administrative ndaj qytetarëve dhe bizneseve
				Ngritja e vetëdijes në nivelin e vendimmarrësve (Kryetarëve të Komunave) nëpërmjet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
5.	Rritja e komunikimit dhe ngritja e vetëdijes për barrë administrative	Mungesa e vullnetit të palëve për përfshirje në zbatimin e veprimeve për komunikim dhe ngritje të vetëdijes të Programit	I ulët	Koordinimi më i mirë administrative i konsultimit dhe komunikimit me të gjitha palët e interesit